


Tashko Lako

Kur bëjnë dasmë arinjtë

BIBLIOTEKA
SHTETIT

83H-7
X19.



8SH-2

219.

TASHKO LAKO

KUR BËJNË DASMË ARINJTË



Skica e tregime humoristike

20368

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

I. — *Nga periudha e sundimit
të satrapit A. Zogu*

VAGABONDËT E QYTETIT...

Pasdite, kryetari i bashkisë i ngjiti me rrëmbim shkallët që e shpinin në zyrën e vet dhe shkoi e u shemb mbi divanin që ishte vendosur në këndin e zyrrës, pranë dollapit të madh, ku bashkë me shishen e rakisë mbante edhe poçen që përdorte për t'u larë sa herë merrte avdes.

— Mua, ë?, — turfulloj si ndonjë derr i egër, i plagosur. — Mua të më flasë ashtu, me atë gjuhë, si të mos kishte përparrë kryetarin e bashkisë por një rru-gaç? Do marr hak! Veç mos më ardhtë në shteg, pa di unë...

... Dhe iu kujtuan të gjithë...

E kishte thirrur prefekti. As dorën nuk i kishte dhënë, as kutinë e duhanit nuk ia pat zgjatur, as për shëndetin nuk e kishte pyetur, por i kishte rënë fjalës përmes e kishte dalë atje ku donte.

«C'është kështu me ju, zoti kryetar, — i kishte thënë me një ton të rreptë, ku ndihej shkoqur zemë-rata e papërbajtur, — c'është kështu me ju? Nuk e shihni që në qytet enden një mori vagabondësh, pijanecësh, kumarxhinjsh, sherrxhinjsh, që na sjellin

ngatërresa e u prishin qetësinë njerëzve të ndershëm? Ç'bëni ju, sehir? — dhe pastaj, pa pritur përgjigje, ia kishte prerë copë: — Të urdhëroj të marrësh masa të menjëhershme, urgjente, dhe të vendosësh rregull në qytet! Ndryshe, do të njoftoj Musa efendinë që t'i presë ujët mullirit. Kaq. Tani mund të shkonit.».

Dhe i kishte treguar derën.

Kaq. Tani i mbetej atij të bënte atë që kërkonte i nderuari prefekt i cili, për shkak të lidhjeve të tij të ngushta me Musa efendinë dhe oborrin mbretëror, kishte në dorë gurin dhe arrën.

Si e mblohdhi veten, filloi të mendohej: «Ç'tha prefekti? Qytetin po e shqetësojnë vagabondët, pijanecët, kumarxhijntë e sherrxhijntë... Hëm! Atyre u duhet dhënë një mësim i mirë, që ta mbajnë mend tërë jetën. Ka apo nuk ka kryetar bashkie këtu?», — thirri me zë të lartë e atë çast ndjeu një zë të qetë që iu përgjigj aty për aty: — Ka, si nuk ka, zoti kryetar. Ka, dhe e kemi sa për shtatë male bashkë.

Kryetari ngriti sytë dhe vuri re se përpara tij qëndronte tellalli i bashkisë, që kishte marrë qëndrim gatitu dhe lëpinte me majën e gjuhës cepin e mustaqeve.

— Po ty, more, — e pyeti kryetari, — kush dreqi të thirri këtu?

— Zotrote, — u përgjigj tellalli, pa ditur ç'qëndrim të mbante e nëse duhej të vazhdonte të nderonte ashtu allazogçe, apo të mbrohej nga një mizë që e guduliste në majën e hundës.

— Ah, po, po, po..., — kryetarit iu kujtua që, kur kishte hyrë në bashki, kishte dhënë urdhër të gjenin tellallin dhe policin dhe ishte ngjitur me rrëmbim shkallëve. — Unë të kërkova. Po Piloja, ku është?

— Pazarit, zoti kryetar.

— Pazarit, è?, — kryetari filloi të kruante kokën, pastaj u ngrit nga divani, i erdhi një herë rrëth e qark zyrës, qëndroi në krye të tavolinës dhe iu drejtua tellallit duke tundur gishtin:

— Kozma! Në qytet ka shumë vagabondë, pijanecë, kumarxhinj e sherrxhinj.

— Ka, zoti kryetar, ka plot. Shpirtin në majë të hundës na e kanë sjellë, — u përgjigj tellalli.

— A i njeh ata?, — pyeti kryetari.

— Të gjithë, kokë pér kokë, — u përgjigj qetësisht tellalli.

Kryetari i bashkisë iu afrua pranë, mblodhi buzët në shenjë pakënaqësie, trashi zërin dhe tha repte:

— I njeh dhe nuk më ke thënë asnjë gjysmë fjale, ore edepsëz? Hajde Kozma, hajde. Ti bën sehir, kurse unë ha dru frashëri me gdhënë nga prefekti, se ai, si përfaqësues i Lartmadhërisë së tij mbretit, nuk do të dijë fare pér kryetar e pér tellall, more vesh?

— Si urdhëron, mora vesh, — u përgjigj tellalli, pa e prishur gjakun.

Ky qëndrim sikur e solli në vete kryetarin, dhe iu drejtua me ton pak më të përbajtur:

— Dëgjo këtu, Kozma. Ec e merr Pilon dhe të dy bashkë dilni nëpër pazar, gjejini të gjithë ata zullumqarë e m'i sillni këtu, dëgjon?

— Dëgjoj, zoti kryetar, — tha tellalli.

— Veç kujdes mos harroni e lini ndonjërin, se pastaj, ta dini me të ditur. Do t'ju rras ju në vend të tyre në birucë, more vesh?

— Mora, — tha përsëri tellalli.

— Dhe në kundërshtoftë ndonjëri, i hidhni pra-

ngat. Duhet ta marrin vesh të gjithë se këtu jam unë kryetar dhe, sa të jem gjallë, këtej e tutje ujë të zi do të nxjerr. Nuk vete më te prefekti pér ata horra e bij horrash. Hajde, shko tani!

Tellalli bëri një gjysmë rrotullimi po, kur arri-
ti te dera, u kthyte e pyeti:

— Zoti kryetar! T'i sjellim këtu, apo t'i fusim
drejt e në birucë? Si t'i them Pilos?

Kryetari i bashkisë u përgjigj me nxitim:

— Ç'birucë, more teveqel!? Sillini këtu, sillini
more, se, dua të shoh ç'syfete kanë. Pastaj e di
unë...

— Peqe!

Tellalli tërhoqi derën dhe shkoi drejt e te Pi-
loja, polici i bashkisë, që po pinte një gllënjkë te
kafeneja e Qazimit.

— Urdhri i kryetarit, — i tha, — do vish me
mua të zëmë gjithë horrat dhe t'ia çojmë kryetarit
në zyrë, se ka punë me ta.

Polici nuk e bëri të gjatë. Ktheu gotën e u
rregullua shpejt e shpejt. Të dy u gjendën në udhë
dhe e morën drejtimin andej nga kazinoja e Sot-
rit, se atje ishin edhe dy çingitë e dëgjuara, Difja
me Bihanen.

Mendonte tellalli duke ecur: «Në fillim do të
vëmë përrpara ata që kapardisen në kazino. Pastaj u
kthehem i kafeneve të tjera dhe së fundi e mbajmë
frymën atje në kuplara, se janë sojsëzër ata, shkojnë
edhe andej dhe harakopen me kurvat. Hëm! Të
paudhët! Na hëngrën shpirtin...»

Kështu, fol e mblidh e mblidh e fol, tellalli
dhe polici i mblodhën të gjithë vagabondët e. qy-
tetit nga qenë e nga s'qenë.

— Ka urdhëruar kryetari i bashkisë, — u thoshte

tellalli pér t'i qetësuar. — Ai e di përse ju thërret. Ne na ka urdhëruar kryetari, kryetarin e ka urdhëruar prefekti, prefektin e ka urdhëruar Lartmadhërija e tij mbreti, Lartmadhërinë e tij mbretin e ka urdhëruar..., — tellalli e mblidhë mendjen dhe përpiquej të rregullonte ligjëratën. — E ç'më pyesni mua?, — u thoshte. — Ne, ç'na thonë, themi, ç'na urdhërojnë, bëjmë. Kryetari i di të gjitha.

Kur arritën në bashki, kryetari ishte akoma në zyrë. Polici trokiti dhe kapërceu pragun. Pas i qëndronte tellalli.

— I sollëm, zoti kryetar, — tha. — T'i fusim brenda apo t'i lëmë atje në sallonin e madh?

Kryetarit iu çel ftyra. Sytë i shkëlqyen nga gëzimi. Të gjithë ata që i kishin sjellë shqetësime prefektit, i kishte tanë në dorë. O, e dinte vetë se ç'do t'u punonte. Ky polic e ky tellall që kishte bashkia, vlenin dy herë sa aq. Burra të zotë, jo shaka.

Buzëqeshi.

— Sillini, sillini firaunët, të paudhët, pushtërit... Sillini që t'ua sjell njëherë festen vërdallë dhe pastaj të shkoj e të fle i qetë.

Polici doli, shkoi në sallën e madhe, i mori të gjithë ata që kishin sjellë, i futi brenda në zyrën e kryetarit dhe raportoi me plot gojën:

— Zoti kryetar! Urdhri juaj u zbatua!

Kryetari i bashkisë nuk po u besonte syve dhe veshëve të tij. Ç'thoshte kështu ky matuf? Kujt ia bënte me sy ai tellall, që kishte nxjerrë kryet mbi shpatullat e policit dhe buzëqeshtë gjithë djalëzi? Këta ishin vagabondët e qytetit?

Përpara tij qëndronin të qetë tre tregtarë të mëdhenj, dy agallarë, dy qehallarë, myftiu, dhjaku,

kryesekretari i bashkisë dhe Rënxa, padronia e kuperlarasë. Ata e vështronin kryetarin dhe i buzë-qeshnin sikur donin ta pyesnin:

«E kryetar? Bjeri shkurt. C'kérkon nga ne?»

Kryetari i bashkisë nuk u përbajt dot dhe ulériu:

— Kozma! Pilo! C'janë këta që keni sjellë këtu, o të paudhë?

Tellalli doli përpara.

— Këta janë, zoti kryetar, ata që urdhërove zotrote, — tha qetë-qetë tellalli, po nuk e mbaroi dot fjalën, se kryetari e kishte mbërthyer nga supet dhe e shkundte me sa fuqi kishte.

— Të thashë të më gjeje vagabondët, o firaun, të më gjeje pijanecët, kumarkhinjtë e sherrxhinjtë, more tersëz, e jo parinë e qytetit, njerëzit tanë më të nderuar!

Por tellalli u përgjigj:


— Këta janë, zoti kryetar, këta janë vagabondët më të mëdhenj të qytetit tonë. I njoh mirë unë. Edhe populli i njeh mirë... E dini ku i kemi gjetur!? Te Difja, Te Bihania...

Po kryetari nuk e dëgjonte më. Ai qe bërë si i tërbuar dhe ulérinte:

— Përjashta, gjidi i paudhë!... Këput qafën e mos u duk më!...

Dhe duke u kthyer nga ata që ishin në zyrën e tij, zuri t'u lutej:

— Një keqkuptim, zotërinj... një keqkuptim... Unë i kërkova zullumqarët dhe jo tregtarët e agallarët... Një keqkuptim... Do të na ndjeni, zonja dhe zotërinj...



XHAMBAZËT

Sheshi i fshatit gumëzhinte si zgjua bletësh. Kishte ardhur aty një xhambaz i vjetër dhe i bënte reklamë gomarit të tij, zbukuruar me tri palë rrathë rruazash, po me dhëmbë të rrafshuar. Xhambazi rropatej ta shiste ose ta bënte tram me një tjetër, po duke i marrë edhe yst.

— Shikojeni, more ju marrsha të keqen, — thërriste xhambazi plak, që ishte i rrahur me vaj e me uthull, — magjari është i fortë. Vështrojani vihet! Më të shëndosha se të arixhofkës sime i ka. E kam ushqyer me tagji, more xhan. Mos u bëj pishman, — i drejtohej ai një fshatari që i vinte anës gomarit. — Mban një kuintal në kurriz dhe zotërinë tënde përsipër. Mos e nxirr nga dora këtë flori mall, more xhan.

Përbri xhambazit, një zotëri i veshur mirë, me kapele borsalinë në kokë, me kravatë e me syze, i rrethuar nga tre xhandarë, që vështronin të nxirrosur e të hutuar sa andej-këndej duke pasur menjen që të «siguronin rendin», zuri të fliste me zë të lartë dhe mezi e mbante veten:

— Mbathja, more ti, me gjithë atë gomar që ke sjellë këtu e na ke çoroditur fshatin. Kemi halle të tjera sot. Kemi hallet e deputetëve sot. E dini ju, more, c'janë deputetët? Deputetët janë ba-



ballarët e kombit dhe shpirti i Lartmadhërisë së tij, mbretit tonë august dhe ju duhet t'ia jepni votat Selam agait, që nga ana e tij do të votojë pér Mazllum beun, që nga ana e tij voton pér Lartmadhërinë e tij, që zoti e ruajtë e ia shtoftë ymrin. Hë, hiç mos u mendoni. Votat që do të jepni pér Selam aganë janë njëlloj sikur do t'ia jepnit Lartmadhërisë së tij mbretit, se Mazllum beu, njeriu i mbretit është.

Fshatarët heshtnin. Me sa dukej nuk po u pëlqente «pazari».

Kështu edhe një copë herë sheshi vazhdoi të ziente. Xhambazi çirrej e shkulte faqet nga ndershmëria, derisa fshatari ta hante sapunin pér dja-thë, ndërsa zotëria e tij me borsalinë i bënte reklamë zotërisë së tij, që e kishte dërguar këtu pér të siguruar votat si «baba i kombit» që ishte dhe si njeri që gjithë jetën e kishte «shkrirë» pér të mirën e këtij populli fukara e të këtij vatani të përvëluar.

Ndërkhënë, te sheshi u duk një djalosh. U afroa e po dëgjonte ata që mundoheshin të zotëronin she-shin me thirrjet e tyre. Të dyve balli u ishte mbushur me bulëza djerse. Të dy flisnin me bulci të fryra.

— Mos u bëj pishman, t'u bëfsha, — lutej xhambazi i gomarëve. — Magjar më të mirë se ky s'ke ku gjen.

— Mos ngurroni more, — lutej zotëria me borsalinë. — Deputet si Mazllum beu s'ke ku gjen. Nuk është budalla Selam agai që do të votojë pér të. Mos na sillni telashe, pér kokën tuaj.

Djaloshi pyeti:

— Po ku është ky Mazllum beu, more zo-

tëri, se nuk e kemi parë të vijë ndonjëherë këtyre anëve tona.

Zotëria me borsalinë e vështroi vëngër. Xhendarët lëvizën mustaqet. Fshatarët i shkelën syrin djaloshit. Zotëria foli:

— Ai është njeri i madh, ku i bie ngeja të vijë këtej. Vetë Lartmadhëria e tij, mbreti, e do, e nderon dhe e mban pranë vetes në pallat. Ai nuk ka pse të vijë këtu. Ai rri në Tiranë, në kryeqytet, në pallat dhe bën kuvend me Lartmadhërinë e tij mbretin, me zotërinjtë ministra e me gjithë zotërinjtë e tjerë të pallatit mbretëror, dhe natën nuk e zë gjumi për hallet tuaja, sepse mendon për ju. A e shihni pra? Këtu te ju rri Selam agai. Sipas sërsës që ka, dhe ai e njeh mirë Mazllum beun, prandaj do të votojë për të. Kështu që edhe ju duhet të votoni patjetër për Selam aganë, se kështu e kanë këto punë.

Djaloshi pyeti përsëri:
— Po ku i di hallet tona Mazllum beu, more zotëri i nderuar?

Zotëria e tij u vrenjt dhe foli buzëvarur:
— Hallet e mexhlisit i di vetë Lartmadhëria e tij, mbreti. Kurse ti, — iu kthyesh me djaloshit me zë të ulët e duke u ngërdheshur, — këput qafën që këtu, se ndryshe, — dhe u bëri shenjë xhandarëve, të cilët për «dashamirësi» hodhën duart mbi kamxhikët që mbanin varur në brez. — Këpuse qafën, po të them!

Dhe pa e vështruar më atë djalosh, që i prishi terezinë, zotëria e tij u kthyesh përsëri nga fshatarët.

— Dëgjuat more?, — u tha dhe sytë tërë rremba të kuq gjaku i kërcyen përpjetë si sy lepuri. — Juve po ju them. Votoni për Selam aganë, që ai pastaj

të votojë për Mazlum beun. Ai është juaji. Tërë mbretërisë po t'i bini pash më pash, nuk do t'ia gjeni dot shokun.

Mirëpo zëri i tij nuk u dëgjua edhe aq qartë, sepse pak më tej xhambazi i gomarëve zuri të cirrej me sa zë kishte në kokë.

— More vëllezër... More vëlla, — dhe i kthehej atij fshatarit që nuk ia shqiste sytë gomarit, — merre magjarin, po të them, merre, se s'ke për ta gjetur më. Është gomar për kokë të gomarit. Tërë mbretërisë po t'i biesh pash më pash, nuk do t'ia gjesh dot shokun!

DEFTERI MAGJIK

Tri ditë dhe tri net me radhë mendohej Kozi Dorëgjati si ta kapërcente shtegun e madh, që i kishte hapur Sali agai, dhe s'ia dilte dot në krye, se puna kishte marrë të krisur keq. Sali agai ia kishte thënë copë, tek ndodheshin në lëmë, ku dëgjonin edhe goxha burra të tjerë:

— Me ty s'kam punë. «Në gjyq», thoni ju; mirë, në gjyq. Por duhet ta dish në gjyq jam unë që do të t'i ngrer patavrat.


Kozi Dorëgjati qe munduar t'i mbushte mendjen Sali agait se ai nuk kishte të drejtë, se Kozi e kishte paguar një herë qiranë e tokës së dyqanit që kishte ngritur, po ku priste fjalë Sali agai.

— Në gjyq, në gjyq, — thoshte. — Atje do të zgjidhet puna dhe ti ke për të parë se ç'është një aga dhe ç'është një copë tregtar si ti, që kërkon të këndosh si kaposhi mbi pleh, pa të zënë mulla aq dhjamë, sa të mbrehesh në sërë e në soj.

Kozi e kuptonte mirë këtë që thoshte agai. Ai e dinte se Sali agai i kishte më shumë pas vetes gjykatësin, xhandarët, dhe në gjyq atij do t'i jepnin të drejtë e jo një tregtar që sa po dilte, si zogu

nga veza, dhe nuk ia njihnin ende zërin, po përsëri
nuk e jepte verenë.

— Sa të jem gjallë, nuk i ndez qiri lugatit, —
u thoshte disa tregtarëve të rinj si ai, që kishin ar-



dhur për ta këshilluar menjëherë sa po kishin marrë
vesh ngjarjen. — Ylli ynë tanë ka filluar të shkël-
qeje, ndërsa ylli i tij është në të perënduar.

Të tretën ditë e pa të udhës të merrte edhe me-
ndimin e Pilo Çakërrit, tregtarit të madh të qytetit,
tek i cili blinte mallrat dhe ishte myshteri i për-

hershëm, «se domosdo, — thoshte, — Pilua e ka parë dynjallëkun me kohë dhe di shumë e më shumë nga unë».

— Dëgjo, — i tha usta Piloja, pasi e dëgjoi mirë e mirë dhe e rrahu fjalën mbarë e prapë, — paraja është më eëmbël se mjalti, dhe kryetari i gjykatës ëmbëlsirën e mjaltit të parasë e njeh më mirë se Sali agai. Zërja grykën kryetarit të gjykatës dhe ai i kall ferrën kur të duash Sali agait.

Kozit i pëlqeu këshilla e ustait të vet dhe ditën e gjyqit, u paraqit në gjykatë me një defter të madh nën sjetull.

Kryetari i gjykatës, një burrë fytyrëngrysur, i veshur me një mantel të zi e me mjekër të zezë skrrrop, erdhi e u ul në krye të tavolinës, i shoqëruar nga dy anëtarët e vet, të cilët kapën dosjet dhe u bënë gati për të filluar nga puna.

Fjalën e mori kryetari i gjykatës.

— I pandehur Kozi Dorëgjati, akuzohesh se nuk i ke paguar qiranë e tokës së dyqanit Sali agait, pronarit të ligjshëm të asaj toke dhe se, përveç kësaj, i ke kundërshtuar, je grindur dhe e ke sharë rëndë përpara burrave të fshatit, duke i ndyrë mustaqet, shenjën e shenjtë të burrërisë së tij. A e pranon akuzën që të bëhet?

— Jo, — ia ktheu Kozi aty për aty dhe kjo i dha shkak Sali agait të hidhej përpjetë nga karrigia ku qe ulur, tamam si ta kishin përcëlluar me degë hidhri e të fliste me zë aq të lartë, saqë e gjithë salsa e gjyqit buçiti.

— Ai gënjen, zoti kryetar. Ai më shau, më po-shtëroi përpara fshatit, më ndyu mustaqet!, — dhe shkoi dorën te mustaqet e veta, krehur me kujdes.

— Më hodhi poshtë burrërinë, zoti kryetar, se burri pér një pëllëmbë mustaqe i vë zjarrin fshatit!

Kryetari i gjyqit e miratoi me një pohim të kokës. Sekretarët shkruan shpejt e shpejt fjalët e agait, ndërsa Kozi sillte nëpër duar defterin e tij me shumë fletë të bardha e me nga një dollar ngjitur në çdo fletë.

— Fol, i pandehur, — gjëmoi kryetari. — Përgjigju!

Kozi hodhi një çap pérpara.

— Qiranë e tokës së dyqanit e kam paguar një herë, zoti kryetar i gjykatës dhe dy herë nuk paguaj, sikur dhëmbin një bërçik të gjatë ta bëjë Sali agai. Ndërsa pér mustaqet, ashtu është, vërtet, ia kam përsëndyrë, por këtë të drejtë unë e kam me ligj, zoti kryetar i gjykatës. Ligji im, ky që kam këtu, thotë se unë kam të drejtë të përsëndyj mustaqet e agait, kur ai kërkon të marrë dy herë qira.


Gjykatësi e vështroi ngultas.

— Çfarë, çfarë?, — pyeti. — Ligji? Për çfarë ligji flet ti?

— Ligji im, zoti gjykatës, — u përgjigj qetë-qetë tregtari — qëndron më lart se ligjet me të cilat gjykon zotëria juaj.

— Ashtu?, — gjykatësi shqeu sytë nga zemërimi, që një palo tregtar fshati, i cili sapo kishte filluar të ngrente kokë, ia kthente fjalën ashtu serbes fare, pa e peshuar. — Pa sillma këtu atë ligjin tënd, që ta shohim!

Kozi Dorëgjati ia dha defterin gjykatësit. Ky, hapi fletën e parë dhe pa në të një dollar të palosur me kujdes. I ngriti sytë dhe e nguli vështrimin



e tij mbi Kozin e pastaj mbi Sali aganë. Pastaj ktheu fletën e dytë dhe përsëri pa aty një dollar tjetër. Një i tretë ishte vendosur në faqen e tretë. Gjykatesi e kuptoi. E mbylli defterin dhe pyeti rëndë-rëndë tregtarin:

— More, ky ligji yt, kështu, bydevi demek, njësoj këndon tej e përtej?

— Tej e përtej, bydevi, — u përgjigj tregtarin dhe pastaj shtoi si pa të keq: — E, zoti kryetar i gjyqit, kam apo s'kam të drejtë?

Sali agai nuk priti përgjigjen e gjykatësit, por sokëlliu:

— Të drejtë... Një palo tregtar kërkon të drejtë dhe ku, në gjyq! Ha, ha, ha... !

Po gjykatësi ia ndaloi të qeshurën me një lëvizje të shpejtë të dorës.

— Sali aga, — i tha. — Me këtë ligj që ka ky, le mustaqet e tua, por edhe mjekrën time e përsëndyn, si pa të keq fare, prandaj më mirë le t'i japidim fund këtij gjyqi, — dhe, si u ngrit në këmbë, dha vendimin me një ton solemn:

— I pandehuri Kozi Dorëgjati deklarohet i pafajshëm.

Sali agai nuk u përbajt më:

— Do të ankohem më lart! — u corr. Do të ankohem në gjykatën e lartë. Atje do të më japidim të drejtë!

Por kryetari i gjyqit, me sytë që i shkëlqenin nga gëzimi i parasë, iu përgjigj duke rrudhur buzët:

— Shkoni, shkoni, aga, po këtu, në këtë ligj, ka nene edhe për ata të gjykatës së lartë, në e dash-të puna. — Dhe i shkeli syrin Kozi Dorëgjatit, i

cili nga ana e tij ia shkeli të dy sytë radhazi dhe doli nga salla e gjyqit kryelartë.

Kur sosi në fshat, njerëzit e rrethuan. Xha Miti, një nga pleqtë e fshatit e pyeti: «E, o zoti Kozi, si shkoi davaja me aganë?»

— U fitua nga paraja, — ia ktheu tregtari, që i queshte e tërë fytyra. — Eh bir, eh bir! Paraja shet edhe babanë!

Dhe mori udhën drejt dyqanit.

E DI PREFEKTI

Atë mëngjes, në zyrën e prefektit trokitën më herët se ç'e kishte bërë zakon të priste njerëz. Trokitja ishte e ndryshme nga ajo e Selfo Qazimit, që ia sillte kafenë në zyrë dhe e shënonte raushin në kanatin e derës.

Dera u hap një bërçik dhe prefekti pa kokën e thinjur të portierit që u fut pakëz rrëshqanthi.

— Zo... zo... zoti pre... pre... prefekt..., — foli portieri, të cilit i mbahej goja, — e... e... erdh... erdhën ata të dy... dy... dy... që... kër... kër... kër...

— Hë, mor kërkellimë, — buçiti zëri i prefektit, — nxirre të shkretën, se ma nxore shpirtin! Cilët erdhën?

— Ata të dy, që kër... kër... kër... kërkove zotëria jote, po... po... po...:

— Popla të rënshin!

— Jo. Po presin te de... de... de....

— E, derdimen, hape gojën!

— Te dera. Si... si... si... si urdhëron!

— Lëri të hyjnë, — urdhëroi prefekti dhe portieri e tërroqi kokën e tij thinjoshe që t'u linte udhë të lirë dy punëtorëve të kapërcenin pragun e të që-

ndronin përpara prefektit, me kapelet nëpër duar, pa ditur ç'të bënин me to.

Prefekti u hodhi një vështrim nga koka gjer te këmbët, si për t'i peshuar se sa u vlente lëkura e pastaj, si rrëzoi vetulla e buzë bashkë, u shtri në kolltuk e, duke e anuar kokën paksa nga e dja-thta, foli rëndë-rëndë:

— E, more, erdhët, ë?

— Erdhëm, zoti prefekt. — u përgjigj njëri nga punëtorët, ai më plaku një i thatimitë e me sy të lëvizshëm, — Na thanë se na kërkon zo-tëria juaj dhe...

— Po, — e ndërpree prefekti, duke i dhënë seriozitet tonit të tij. — Ju kam thirrur. Ju kam thirrur se ju kanë rrjedhur trutë, dhe mua më kanë vënë këtu që t'ju sjell trutë në vend.

Vetvetiu punëtori plak çoi dorën në kokë e pyeti si padashur:

— Trutë?, — përsëri fërkoi kokën me pëllëmbën e dorës së rreshkur e gjithë kallo. — Bah... e keni jangllësh, zoti prefekt. Do të jenë të tjerrë, se ne ja ku i kemi trutë, këtu në kokë, — dhe rrahu tëmthat me gisht, — këtu i kemi e nuk na kanë rrjedhur, se nuk kemi lënë asnje vrimë.

Prefekti brofi nga kolltuku.

— E di!, — dhe zëri i tij buçiti fort. — E di që nuk keni lënë asnje vrimë, e megjithatë, ju kanë rrjedhur! Jua them që është kështu dhe këtë nuk e luan as topi i nemces. Se po t'i kishit në vend ato të shkreta, nuk do të merreshit me propagandë bollshevike. Dhe kush? Ju... punëtoria!... rrugaçëri hesapi!... njerëz që nuk ju ka njeri në hesap!..

Këtë radhë, nga punëtorët, foli ai më i riu.

— E keni gabim, zoti prefekt dhe, ju lutemi shumë, mos na ngatërroni me këto punë, se jemi njerëz hallexhinj...

Prefekti shtrëmbëroi buzët dhe u zgërdhi.

— Hallexhinj, hallexhinj, po me politikë dini të merreni, ama. — E, si u ngrit në këmbë dhe bëri dy-tre hapa nëpër zyrë, erdhi u ul në krye të tavolinës e, pasi mbështeti duart mbi një dosje që kishte përpara, vazhdoi me ashpërsi: — Ç'është ajo shoqëria që keni bërë, more!? S'ka shoqërirë këtu efendëm! Secili për vete! Posi, bullshevizmën kërkonit të na sillni, more të mjerë!? Shkoni more, shkoni këputni zverkun e mos u merrni me marrëzira, se do gjeni belanë me qeverinë!

Të dy punëtorët kafshonin cepat e buzëve, për të mbajtur të qeshurën. Prefekti kishte marrë pamjen e një karagjozi. I kërcënonte e mundohej t'i frikësonte, por dukej sheshit se i kishte pjellë belaja për vete dhe s'dinte si të vërtitej. Teksa ishte duke u shprehur kështu, punëtori më i vjetër i shkeli syrin të riut dhe tha:

— Ju kanë gënjer, zoti prefekt, është bërë jangllësh, se mblidhemi nganjëherë ashtu, sa për një dorë muhabet e për të vrarë kokën, pa sa për politikë a për atë bullshevizmën që thua zotrote, as që e marrim vesh fare!

Prefekti heshti për një çast, sikur deshi t'i vinte në kandar mirë e mirë fjalët që dëgjoi, pastaj uli kryet e filloj të rrihte me majën e lapsit një copëz letër që kishte përpara.

— Ashtu, ë? Nuk diki nga politika, ë?, — fliste i kredhur i téri në mendimet e veta, por befas

u inatos prapë e ndryshoi ton: — Dini, dini politikë ju, dhe që q'ke me të! Këtë po jua them unë dhe është kështu si them unë! Jeni ca ju, që pa, pa... Nuk ju zihet besë ju punëtorëve, prandaj dëgjoni këtu, — dhe ai u ngrit e u afrua pranë tyre, për t'u hequr si më i shtruar, më populor, siç kishte qejf të thoshtë për vetveten. — Vëruni veshin mirë fjalëve që po ju them. Mos u merrni me politikë, se nga ju lapangjozët mbretëria rron njëqind vjet. Ohua! Ne s'kemi as dy vjet mbretëri, more firaunër, që ta shijojmë tërë lezitin e mbretërisë. Ajo që kërkoni ju, more derdimenë, ajo bolshevizma, domethënë, do shumë kohë që të vijë, e nuk vjen kështu, tak-fak, siç e kërkoni ju, morët vesh?, — tha prefekti, duke nënqeshur me mençurinë që po tregonte, e cila do t'i fuste në thes të dy punëtorët.

— Si urdhëron, derisa e sillni ju vetë, vjen posa, — tha punëtori më plak me urtësi dhe prefekti, duke e pandehur këtë pohim si bindje e betim ndaj fjalëve të veta, vazhdoi tërë qejf, meqë po i fuste ca më thellë në thes këta punëtorë kokëtrashë: — Ja kështu si ju them unë është, prandaj mos u mundoni kot së koti, duke prishur edhe rehatinë tonë edhe duke i bërë keq vetes suaj. Ata që ju thonë për komunizëm, nuk janë në gjendje të lidhin ushkurët e tyre, e jo të sjellin bolshevizëm. Hajde, shkoni tani dhe mblidheni mendjen. Po dëgjova edhe një herë tjetër se merreni me politikë, do t'ju kalb në burg. S'keni punë me bolshevizmën ju. Ajo ka punën e saj, ju keni punën tuaj. Do njëqind e ca vjet bolshevizma të vijë këtu, e jo sot, ashtu siç është kërkoni ju.

— A thua tē jetē me tē vërtetē kështu, zoti prefekt?, — pyeti ai më i riu.

Prefekti ia ktheu aty pér aty:

— Ta merr mendja që éshtë pikërisht kështu. Pérderisa po jua them unë, domethënë se éshtë si them unë:

— Tamam. Derisa u thoni ju, éshtë siç thoni ju, — tha më i vjetri dhe ky qëndrim i pëlqeu ca më shumë prefektit, që e gjykoj me vete se me këta njerëz kishte mbaruar punë lehtë.

— Mirë atëherë, — u tha, — shkoni dhe mos u djersitni kot. Kur tē vijë bollshevizma këtu e pér njëqind vjet, këtu jemi. Shohim e bëjmë atëherë.

Ata tē dy buzëqeshën dhe pas pak u gjendën në rrugë. Ai më plaku, i ra me bërryl shokut tē vet.

— E dëgjove qerrata? Prefekti e tha qartë. Komunizmi do tē vijë, jo sot, por pas njëqind vjetësh. Siç duket duhet t'ua lëmë porosi nipërvë, që tē dalin e ta presin, — dhe ia dha tē qeshurit.

— E, more zoti prefekt!, — tha më i riu, duke kthyer fytyrën nga dritaret e tij, — mos ki merak, se nuk e hamë kollaj sapunin pér djathë ne! Do ta sjellim vetë atë «gogol» që e trembo që shumë zotërinë tënde!

Dhe tē dy morën rrugën drejt punishteve.

«PATRIOTIZMI» I KRYETARIT TË BASHKISE

Atë mëngjes prilli, që erdhi me re të ngarkuara gjithë rrebesch e stuhi, Osman efendiu, kryetari i bashkisë së qytetit të vogël L. u ngrit më shpejt se herët e tjera dhe doli pa e zgjuar hanëmin, që gërhiste si ndonjë derrkuc i vogël.

Pasi rrufiti veresie një kafe, te kafeneja e Qazimit, i ngau çapet andej nga nënprefektura për të takuar nënprefektin, Nexhmedin beun, si njeri më i ditur që ishte, meqë të djeshmen kish te dëgjuar ca fjalë që nuk po u jepte dot dum.

Edhe Nexhmedin beu atë mëngjes ishte ngritur më herët se ditët e tjera dhe kishte dalë në zyrë pa feksur mirë dita. Sytë i kishte të enjtur dhe dukej sheshit që rakia e darkës ende nuk i kishte dalë.

Osman efendiu e përshëndeti me përzemërsi të madhe.

— Si m'u gdhive, bej?

— Mirë, efendi, — u përgjigj nënprefekti. — Unë mirë u gdhiva, po mbretëria. është gdhirë keq. Ka ardhur kohë e keqe për mbretërinë dhe Lartmadhérinë e tij mbretin, — dhe Nexhmedin beu, duke shpënë dorën në zemër, nderoi alla-

zogçe. Vëtvetiu, nderoi me zell të madh edhe Osman efendiu, të cilit i erdhi fjala në shteg.

— Mirë që e zure në gojë, Nexhmedin bej, — i tha, — se kam dëgjuar ca llafe, efendëm, që më vjen rëndë t'i them, se... efendëm, poshtërohet si shumë mbretëria dhe sovrani ynë august, që allahu ia shtoftë ymrin e i dhëntë kuvet!, — dhe duke i rënë drejtpërdrejt, Osman efendiu shtoi: — Thoma tellalli i bashkisë, efendëm, më zuri në gojë Italinë, Italinë deh, që e kemi motër aty përtej detit. Si është puna, efendëm?

Nexhmedin beu ia nguli vështrimin thellë e u përgjigj me zë të mekur:

— Ka të drejtë Thoma tellalli, efendi. Italia ka dhënë ultimatum. Fashizmi po rrezikon atdheun. Do na pushtojnë vendin, efendi.


— Fashizmi?, — Osman efendiu ngriti vetullat përpjetë, pa mundur të kuptonte asgjë nga ato fjalë, — ç'është ky fashizëm, efendëm? Burrë, a grua është?

— Fashizmi, efendi, fashizmi, — u mundua ta sqaronte shkurt Nexhmedin beu, duke e ditur që kryetari i bashkisë nuk kishte fare haber nga politika dhe se më tej firmës së tij, asnje kërrabëz nuk shënon. — Fashizmi, efendi, është Italia, përtë cilën të ka folur tellalli. Ja pra, kjo Itali që do të na pushtojë vendin, kjo Itali është fashizmi.

Osman efendiu kërceu përpjetë nga karrigia. Dukej shumë i shqetësuar.

— Mos e fol atë fjalë, efendëm, se as fashizmi dhe as i ati e i biri, nuk e prekin dot këtë mbretëri, sa kohë që qëndron hipur në fron të Skënderbeut, Lartmadhëria e tij mbreti, Ahmet Zogu i Parë, — dhe nderoi duke u kthyer drejt

portretit të Lartmadhërisë, që ishte vendosur në krye të zyrës, — se i thonë kobure kësaj, efendëm, — dhe e çoi dorën te koburja, një nagantë me do-



rez fildishi, ku ishin shënuar dy inicialet AZ. — Ma ka falur vetë Lartmadhëria e tij, mbreti i shqiptarëve, efendëm, — vazhdoi, — dhe, për nur të allahut, atij fashizmit, atij bir bushtre a bir kuplaraje, ç'dreqin éshtë, zorrët tej e përtej ia kam për të shpuar, po e hodhi një çap përkëtej detin se, efendëm, jemi burra e nuk i ndyjmë lehtë këto mustaqe.

Nexhmedin beu u mundua ta qetësonte kryetarin e bashkisë dhe së fundi arriti ta ulte në karrige e të shpjegonte:

— Italia, Osman efendi, ose fashizmi, si i thonë, zëre si ta zësh, sot ose nesër éshtë këtu. Dotë zbarkojë me daname e me ballona dhe ec e mbaje, në ta mban! Mbretëri e madhe, Osman, të merr nepër këmbë!

— Heu! Po mbreti, efendëm, Lartmadhëria e tij, dua të them, çfarë do të bëjë, sehir? Po ministrat, ushtria, xhandarmëria...

— Nuk e kanë të gjatë, efendi, nuk e kanë të gjatë. Gjer nesër në të ngrysur, nuk ngryset as mbretëria, as mbreti dhe as...

— As ne, efendëm?

— O burra t'i bëjmë derman kokës, efendi. T'i bëjmë derman kokës që të mos na fluturojë. Kështu e kanë këto punë. Iku një mbret, vjen një tjetër, ç'na ha malli? Vetë të jemi në krye. E di si thanë njëherë moti në Francë? Ra mbreti, rroftë mbreti.

— Po..., — Osman efendiu u çorodit. — Nuk do ta shkrehim fare, efendëm? Nuk do ta bëjmë bam? Po këto kobure, përsë i kemi atëherë, efendëm?

— Çfarë të shkrehësh, more? Ku koburja e ku topi e danamet e Italisë, që po zapton dynjanë.

Osman efendiu u ngrit. «Barometri» i tij filloj të tregonte përsëri kohë të keqe.

— Të dija burrë, Nexhmedin bej, — i tha, — po më qenke grua zotrote, që kurse na u trembke nga një palo fashizëm, që nuk di se ku e ka t'ëmën, pale pastaj të gjejë t'anë. Ke pér të parë, ç'do t'u punoj, në ardhshin këtu. Ke pér të parë, po të them. Më thonë Osmën efendi mua dhe jam unë kryetar bashkie këtu e, pér pejgamber, mbreti dhe mbretëresha le të bëjnë qejf, le të flenë rehat, se unë zorrët do t'u ha atyre kopilëve të fashizmit që duan të shtrohen në sofrën tonë.

Teksa Osman efendiu dhe Nexhmedin beu jepnin e merrnin me patriotizmin e tyre, jashtë populli demonstronte përpara nënprefekturës. Osman efendiu hapi dritaren.

— O burra, — thirri me sa fuqi pati, — hall-vën kemi pér t'i ngrënë fashizmit. Hajt, hajt... O burra!, — dhe iu drejtua përsëri Nexhmedin beut që shqyente sytë dhe nuk besonte në kishte përpara tij kryetarin e bashkisë apo ndonjë tjeter. — Mblidh mendjen, bej, — i tha. — Sa të jetë gjallë mbreti, asgjë nuk e gjen mbretërinë.

Dhe doli jashtë duke marrë udhën pér në bashki. Me të kapërcyer pragun e zyrës së vet, i thirri tellallit me sa zë pati:

— Thoma!

— Urdhëro, efendi, — tellalli u duk në prag.

Osman efendiu urdhëroi me ton të rreptë:

— Nisu, efendëm, drejt e te kazinoja e Sotirit dhe thirr sa të mundësh: poshtë fashizmi, efendëm, more vesh? Thirr edhe një herë andej nga

agjencia e makinave, që ta dëgjojnë mirë e mirë edhe shoferët dhe pastaj le të vijë fashizmi, në ia mban, se hallvën kemi pér t'i ngrënë, more vesh?

— Peqe efendi!, — u përgjigj Thoma tellalli dhe u largua menjëherë. Zbriti shkallët e bashkisë e u gjend përpara kafenesë së Qazimit. Aty brenda, njëra nga çingitë, Bihania, ia kishte marrë shtruar një këngë sevdaje e përreth i qenë mbledhur ca sarahoshë, që e ndiqnin zvarë-zvarë këngën e saj.

— E, Thoma, — e pyetën ata, — c'kemi nga bashkia?

— Osman efendiu ka urdhëruar të thérres «pc-shtë fashizmi».

Çingia ia dha të qeshurit me të madhe.

— Epo thirr, atëherë, c'pret?

Thoma tellalli thirri sa mundi. Pastaj e mbajti frymën edhe andej nga agjencia e makinave, ku thirri edhe një herë sa i hante zëri dhe pastaj u dha sërishmi në derë të kryetarit të bashkisë, të cilin e gjeti shtrirë në divan, me sytë e mbërthyer te portreti i mbretit e me cigare në dorë. Ky e pyeti:

— E, Thoma, thirre fort?

— Thirra, Osman efendi, thirra siç më porosite zotrote.

— Hajt, pra, në të s'ëmës le të vejë edhe fashizmi! Na e mori të keqen, — e mbylli fjalën Osman efendiu, duke i bërë shenjë me dorë Thomait që të largohej, sepse i kishte ardhur ora të falte sabahun.

Jashtë, turbullirat sa vinin e shtoheshin. Populli demonstronte, kërkonte armë, ndërsa Osman

efendi, i ulur në kolltuk, përballe Lartmadhërisë së tij mbretit, kuvendonte me të.

— Mirë ia punova fashizmit, efendëm, ë? Sa të jem unë këtu, hiç mos e prish terezinë, po vazhdo të na qeverisësh me mend në kokë, ashtu siç na ke qeverisur gjer më sot, efendëm, se këtej, vetëm unë e mbaj frontin, efendëm dhe bëj dur një mbretëri të tërë e jo një farë fashizmi, efendëm, që nuk ia kam dëgjuar zërin fare. Unë kam vënë në zap druvarët, efendëm, e jo një palo fashizëm. Hapt, hapt ti, kalë i pashait, pa ia ndreq unë kurrizin fashizmit dhe atij kryeplakut të tyre, atij Duçes, a si dreqin ia thonë emrin, efendëm, që thonë se ma paska kokën më të madhe se një breshkë Myzeqeje.

Të nesërmen e asaj dite që kryetari i bashkisë i shprehte Lartmadhërisë së tij mbretit patriotizmin e tij të kulluar dhe përbetohej për besnikëri gjer në vdekje, mbi kodrat e qytetit u dëgjuan të shtëna pushkësh, që sa vinin e shtoheshin. Kolonat e pushtuesve u gozhduan. Djemtë e popullit, që kishin zënë vend në ullishte, e pritën me armë në dorë fashizmin. Nëxhmedin beu i dëgjonte këto krisma, i struktur atje në shtëpinë e vet dhe belbëzonte.

— Edhe kjo na duhej. Lufton harbutëria, luftojnë, që të na djegë fashizmi, që të na vrasë. Palo vegjeli. Këta do ta mbajnë fashizmin? Posi! Telashe do të na sjellin dhe asgjë tjetër. Hajde dhe ndreqe me Italinë, të kam rixha. Ndryshe e siguruam ne paria konsullin italian dhe ndryshe po na del.

Edhe Osman efendi nuk ishte i qetë.

— Efendëm, — pyeste hanëmin, — a thua se

erdhi me të vërtetë Italia, efendëm? Po këta që luftojnë, xhanëm? Tyt hallabimbelaniversën!

Lufta vlooi e rreptë aty në ullishte, po djemtë pa armë e municion, të tradhtuar gjithandej nuk kishin ç'të bënin më shumë. Kolonat e trupave italiane hynë në qytetin e vogël.

Nexhmedin beu, më t'i parë, kapërceu rrugën dhe u gjend në pragun e shtëpisë së Osman efendiut.

— Të thashë, Osman efendi, të thashë, — i tha.
— Ja edhe fashizmi, e sheh? Na erdhi!

Osman efendiu e pushtoi me të dy krahët e tij të fuqishëm dhe gati sa nuk e puthi në ballë.

— Nexhmedin bej, Nexhmedin bej, — i tha me ngashërim. — Qenke mendjendritur zotrote. Qenke i madh, për allah. Po hallit? Si do t'i vejë hallit tonë tanë?

— Halli, siç bën bakalli, efendi. Nuk ka rrugë tjetër.

— Efendëm?

— Mbreti iku, efendi. Ta ndreqim me mbretin e ri:

— Efendëm?, — pyeti përsëri Osman efendiu.

— Si bakalli, efendi, si bakalli. Je i mençur vetë zotrote.

Osman efendiu e kuptoi dhe foli tërë solemnitet.

— Fjala jote në vesh të allahut, bej.

Pas dy ditësh, ata të dy ndodheshin në krye të një banketi të madh që tyxharët vendas organizuan për nder të rendit të ri fashist. Osman efendiu ishte veshur me rrobat e tij më të mira dhe hanëmi, në thilenë e xhaketës, i kishte mbërthyer

një trëndafil të madh të bardhë, prej letër thithëseje.

— Vëre, — i kishte thënë, — vëre, se një trëndafil i tillë, ndjell mbarësi. Dukesh tamam si aristokrat, tamam si fashist!

Osman efendiu nuk kishte kundërshtuar.

Në banket, fjalën e mori një oficer madhor i trupave pushtuese.

— Ne, — tha ai, — kemi ardhur këtu si miq, sepse jemi miq për kokë të Shqipërisë. Duçja ynë i madh ka thënë se Shqipëria, nën suazën e Perandorisë Romake, do të lulëzojë e do të begatohet.

Tyxharët shpërthyen në duartrokitje të nxehta. Klerikët lëshuan bekimet. Nëxhmedin beut i rrodhën lotët çurg prej mallëngjimit, ndërsa Osman efendiu, i entuziazmuar në kulm nga dashuria e fashistëve, nuk u përbajt dot por u ngrit vrik përpjetë e në këmbë dhe iu drejtua përkthyesit:

— Dëgjo këtu, more terxhuman. I thuaj bimbash efendiu se ne, Italinë dhe fashizmin, efendëm, i kemi pasur denbabaden në zemër, po ai qerrata mbret, që theu qafën, na e bënte me hile, efendëm, dhe nuk donte të na lidhët me miq të tillë. Shyqyr që shpëtuam nga ai, efendëm, dhe tani, që u veshëm edhe një herë nuse, dimë ne si të nusërojmë, veç... pyete bimbash efendiun, a jemi ne në listë, efendëm?

— Në çfarë liste?, — pyeti përkthyesi, i habitur dhe pa kuptuar se ku e kishte fjalën kryetari i nderuar i bashkisë.

Osman efendiu shpjegoi:

— A jemi ne në krye të bashkisë dhe të nën-prefekturës efendëm? Demek, jam unë përsëri krye-

tar i bashkisë së këtij qyteti dhe Nexhmedin beu a është përsëri nënprefekt i kësaj nënprefekturë?

Përkthyesi foli. Komandanti pushtues buzëqeshi dhe tërë dashamirësi i hodhi dorën në sup Osman efendiut, i cili nuk përmbahet dot nga gjëzimi

— Pa dyshim, pa dyshim, — tha. — Kush tjetër veç shkëlqesive tuaja mund ta qeverisë aq mirë këtë vend?

Vonë, kur dolën nga banketi, të dëndur përmrekulli, Nexhmedin beu i tha Osman efendiu:

— Fole bukur, efendi. Hallall e paç bukën e mbretit.

— E the mirë zotrote, efendëm, e the mirë.
Si bakalli, efendëm, si bakalli. Kështu e dashka
puna...

Dhe Osman efendiu qeshte i téri, duke férkuar trëndafilin prej letre që hanëmi ia kishte mbërthyer pér t'i ndjellë fat të mirë.

PRITJA

Mbi qytet fluturonin aeroplanët fashistë, që lëshonin fletushka, me anë të të cilave lajmëronin pushtimin e vendit. Populli u ngrit në këmbë. Nga fundi i sënduqeve, nga hatullat e shtëpive, nga vendet e fshehta dolën dyfEQET dHE shumë vetë, të armatosur me ç'kishin gjetur, kishin marrë udhën për në breg të detit, për ta pritur armikun me plumb ballit, ashtu siç e kishin lënë amanet të parët.

Diku, në një kënd të errët të një pallati, në njérën prej lagjeve të qytetit, tregtarët dhe përfaqësuesit e autoriteteve të klerit, të mbledhur kokë më kokë, jepnin e merrnin duke rrahur të gjenin formën më të përshtatshme për të thirrur: «Rroftë perandori!». Njëri prej tyre, një tregtar me ftyrrë të dhjamosur, të kuqërrreme e të qullur gjithë djersë, si kërmill gollash, u ngrit e propozoi mjaft i ngazëlluar prej mendjemprehtësisë së vet:

— Zotërinj të nderuar! Të dalim të gjithë me një flamur të bardhë në krye e t'i presim siç na e do nderi ynë!

— Nuk vete, nuk vete, — e kundërshtoi shpejt prifti. — Po sikur të na shohë populli? Gjakrat janë nxehur keq. Mos e harroni këtë, zotërinj. Populli është ngritur në këmbë, ka vërshuar si rrjedhë dhe, kush i bie rrjedhës kundra...



— Populli aq di e aq bën, — mbajti anën e kërmillit gollash një tregtar, barku i të cilit tregonte për të «zitë e ullirit që kishte hequr nën mbretërimin e Ahmet Zogut», duke bërë monopol tregtimin e gomarëve dhe të zhukave. — Populli është një tufë që kërkon një bari. Kaq dhe mbaroi. Tufa, nga ta shtysh, andej shkon. Na takon neve ta shtyjmë këtë tufë, në atë anë që na intereson.

— Urata ka të drejtë, — e përkrahu kolegun e tij myftiu, — populli nuk duhet të na shohë, se pastaj nuk dihet në e shtyjmë ne a na shtyn ai.

Dëgjomëni mua. I di mirë unë këto punët e popullit fukura.

— Kollaj, — e mori fjalën kryetari i komunës së qendrës, një bej, pinjoll i një dere të madhe feudalësh. — Hipim në makinë gjer në të dalë të qytetit dhe që andej nisemi më këmbë gjer në qafë e kthehemë pastaj së bashku me trupat italiane. Kështu, i shmangemi popullit dhe e kryejmë siç duhet misionin tonë përpara atdheut dhe historisë.

— E drejtë, — tha një dhaskal, që ato vite ishte kthyer nga Italia, ku kishte vazhduar studimet. Për të thoshin të gjithë se ishte filoitalian i tèrbuar, ndërsa shoferët, ngulnin këmbë se ai ishte thjesht një hafije, siç u thërrisin atëherë spiunëve.

— Bir tamam, — e mbështeti myftiu, — siç na mëson edhe kurani, duhet të rrojmë në paqe me ata që qeverisin, sepse, ai që ngrihet kundra qeverisë, ngrihet edhe kundra perëndisë. Unë, si përfaqësues i allahut në tokë, nuk kam ndër mend të dal kundra të fuqishmit, — tha ai. — Dhe vërtet, qmund të bënte tjetër myftiu? Po sikur allahu, nëpërmjet pushtuesve të urdhëronte t'i hiqnin sarrëkun, ku të mbytej ai? Zanat më të mirë s'kishte ku të gjente. Barku plot. Shtëpia plot. Kështu janë këto punët e perëndisë.

— U vendos! Do të dalim t'i presim me makinë!, — tha beu që kryesonte mbledhjen. — Nësër në mëngjes të jenë të gjithë këtu.

Atë natë e gdhinë si e gdhinë. Thoshin se nuk vunë gjumë në sy dhe të nesërmen, veshur me rrobat më të mira, hipën në dy makina dhe u nisën. Si kapërcyen varrezat, aty ku fillonte e përpjeta e

qafës, u zbritën makinave dhe u nisën më këmbë, vargosur njëri pas tjetrit si dhitë kur kapërcejnë shtegun.

Njëri nga tregtarët, ai barkmadhi, që hera-herës fshinte djersët me një shami mëndafshi lagur me parfum, i ndali.

— Ku shkojmë kështu, more zotërinj?, — u tër-hoqi vërejtjen të tjerëve. — Ç'jemi ne, bashibozukë? Jemi përfaqësuesit e parisë së qytetit, zotërinj të nderuar, jemi ajka e ajkës, prandaj në paraqitjen tonë duhet të zotërojë rregulli i plotë.

— Aferim, — i tha myftiu, — aferim të qoftë, efendëm.

— Kallà, — tha prifti. — Poli kallà, qiries!

— Bravo!, — tha dhaskali. — Bravo sinjore.

— Të vihemët në radhë, zotërinj të nderuar, — foli përsëri tregtari barkmadh. — Të vihemët në radhë si ushtarë të disiplinuar. Miqtë tanë fashistë duhet të na gjejnë në rregull të plotë. Ja, kështu.

Dhe ata u vunët në radhë. Në krye u vunët prifti me myftiun, si njerëz të perëndisë, që predikonin paqen mbi tokë. Meqenëse ishin me perëndinë dhe me paqen, atyre u takonte të mbanin në duar edhe flamurin e bardhë, i cili ishte pranuar të mbrëmshmen si shenjë paqeje. Pas klerikëve vinin tregtarët, barkmadhi dhe kërmilli gollash dhe në fund vinte dhaskali, që në jakën e xhaketës kishte qepur shpatën e Liktorit dhe kryetari i komunës, që kishte rrasur fort kapeLEN me strehë, pasi kishte hedhur tej festen e zezë. Dhaskali dhe kryetari i komunës vinin të fundit, me shpresën e sigurtë se në kohën e duhur, kur të nevojitej terxhumani, do të dilnin vetvetiu të parët.

Kolona e përfaqësuesve të parësisë u vu në

lëvizje. Ecnin më kujdes e ngadalë, duke i bërë syltë katër. Rruga ishte thikë përpjjetë. Kjo i lodhë ca, po kush pyeste pér lodhje në atë ditë aq të madhe pér fatet e atdheut dhe pér fatet e tyre.

Ata ecnin dhe secili bluante mendimet sipas midesë së vet.

Mendonte prifti: «Fundja, katolikë janë vërtet, po besën si ne e kanë. Ç'bëri patriku e ç'bëri papa. Të dy njëlloj janë. Krishtit i shërbejnë që të dy. Dhe meqë Krishti ka qenë një, si pér ortodokset ashtu dhe pér katolikët, edhe ne njësh duhet të bëhem me italianët».

Mendonte myftiu: «Besë tjetër, vërtet, po ç'rëndësi ka? Allahun besojnë ata, allahun besojmë edhe ne. Sa pér profitët, atje lart në qiell ata e kanë gjetur fjalën, pérderisa rrojnë të dy palët në xhehnet. Atëherë, kur qenka kështu, përsë të mos e gjejmë fjalën edhe ne këtu në tokë? Pastaj, këta kaurët e modernizuar, kam dëgjuar se nuk i prishin por i shtojnë xhamitë dhe teqetë. Kur qenka kështu, unë nuk kam ç'të humbas, veç në fitofsha, dhe fitimin vetëm budallenjtë nuk e lakmojnë».

Mendonte barkmadhi :«Do më vejë mbarë tregtia. Le gomarët dhe zhukat, po do t'i përvishem edhe tregtisë së lëndës së drurit. Pse, mbarohen pyjet tonë? Do blej edhe një gjemi. Do hap edhe dy dyqane të tjera. Do të blej edhe një hotel. Me Italinë, paraja do të rrjedhë si lumë».

Mendonte kërmilli gollash: «Do të hedh në dorë gjithë tregtinë me shumicë të manifaturës. Do shkoj vetë në Itali e do lidhem me fabrikantët. Do ngrë edhe vetë një fabrikë. Erdhi dita e parasë. Rroftë paraja!»

Mendonte dhaskali: «Evviva l'impero Romano!

Do ta shtojmë intelijencën me bijtë e tregtarëve. Ata do të bëhen akademistë. Ata do të jenë njerëzit me kulturë që do të qeverisin vendin. Pa fasizmin s'ka kulturë dhe unë, siguramente, do të bëj lart e më lart. Janë të mitë dhe jam i tyre».

Mendonte kryetari i komunës: «Në djall të vejë mbreti me gjithë mbretërinë e tij, se mbeta tërë jetën kryetar komune, dhe kush? Unë! Bej denbabaden dhe i nderuar nga të gjithë. Tani, di unë si t'i rregulloj telat me italianët. Unë jam për nën-prefekt dhe për prefekt e në mos për ca më lart».

Secili ecte me mendimet e veta, po të gjithë hidhnin të njëjtin hap. Kur arriten në majë të qafës, dielli ishte ngritur lart. Poshtë, drejt tyre, vinte një turmë njerëzish.

Pyeti prifti:

— C'të jenë ata njerëz atje? Ushtarë apo fshatarë?

Myftiu përqëndroi vështrimin.

— Fshatarë më duken,
— Janë ushtarë, — kundërshtoi barkmadhi.
— Janë ushtarët e Duçes, — férkoi duart gjithë gëzim kërmilli gollash dhe sytë i shkreptinë si të maçokut në errësirë.

— Lart flamurin e bardhë!, — urdhëroi dhas-kali.
— Më lart, më lart, — ngulmoi kryetari i komunës.

Prifti e ngriti lart flamurin e bardhë. Myftiu i dha një dorë dhe flamuri i bardhë bëri edhe ca më lart. Të dy tyxharët e ngritën më tej, po dhas-kali me kryetarin e komunës ishin të pakënaqur.

— Më lart, më lart, — ngulmoi përsëri kryetari

i komunës dhe së bashku me dhaskalin dhanë nga një dorë dhe e ngritën edhe ca.

Të gjashtë ishin bërë një, të mbuluar me hijen e flamurit të bardhë.

— Rroftë fashizmi!, — thirri dhaskali.

— Rroftë Duçja!, — e pasoi kryetari i komunës.

— Rroftë, rroftë!, — thirrën të gjithë njëzëri. Poshtë, turma e njerëzve që ngjiteshin drejt qafës, qëndroi.

— C'janë ata?, — pyeti ai më i pari i tyre, një burrë flokëthinjur, që kishte hedhur krahëve një dyfek lidhur me gjalmë. — C'janë ata që shoh atje, more bir?

Djaloshi, të cilit ai iu drejtua, hodhi vështrimin lart. Gjaku i vërshoi në fytyrë dhe një ngjyrë e kuqe e mbuloi. Shtrëngoi dhëmbët.

— Paska dalë parësia e qytetit, — tha, duke e përqëndruar thellë vështrimin në atë pikë, që sa vinte e zmadhohej. — Po pret ciraku ustanë.

Burri me flokë të thinjur qëndroi. Pas tij, qëndruan edhe të tjerët.

— Kanë dalë të presin fashistët, të poshtrit!, — shfryu ai dhe, duke zënë një mezhdë, thirri, duke mos e përmbajtur dot veten: — Bjeruni qenave, zjarr mbi tradhtarët!

Gryka gjëmoi nga krismat. Kësaj radhe, bijtë e popullit, që kishin luftuar gjithë natën kundra fashistëve, atje tek ullishtet, në breg të detit, i kthyen armët nga ata që tradhtuan intereset e atdheut.

Kamillafin e priftit e shpoi tej e përtej një plumb. Myftiut i ra sarrëku nga koka dhe i mori rrrokullimën.

— Na vranë, more, — thirri barkmadhi. — Na vranë për krisht.

— Paterimon, — filloi të lutej prifti. — Kaq e patëm më duket!

— Allah!, — buçiti zëri i myftiut.

— Këmbët në krahë, o burra, se na vrau populli!, — ulériu kryetari i komunës. — Hidhe tej atë flamur të bardhë, se i lamë kockat rehem dhe mallin rehem s'e zë njeri me dorë.

Flamuri i bardhë u hodh poshtë si një rreckë e shqyer. Përfaqësuesit e parisë së qytetit morën vrapin teposhtë qafës, pa e parë i pari të dytin. Askush nuk vinte re ku shkelte, në shkorretë, ferra apo driza. Kur sosën në qytet, nuk e njihnin më veten dhe shoqi-shoqin.

Lart, në majë të qafës, populli zinte pozicione të reja.

II. — Nga periudha e Luftës

Nacionalçlirimtarie

KAPLLAN BEJ TRIMI

Ai ia kishte marrë vrapiet aq, sa nuk i zinin këmbët dhé. Ferrat, drizat, kaçubet e murrizit, fushë i dukeshin. Koka i qe rënduar e tëmthat ia rrihte vetëm një mendim: «Po hë more... lëviz more... lëviz, që mos të të lëvizin në katër drurë. Këmbët përsot duhen e jo për t'u kapardisur majë karriges. Më shpejt... më shpejt, se të zunë, o i zi. O burra shalë, se u...»

Nuk shihte ku shkelte. Donte vetëm të vraponte, të ikte sa më larg e sa më shpejt, që të mos i dëgjonte më ato të thirrura, që i ngjethnin mishin: «Kapini, more... kapini, more, qenat... Me dorë, me dorë. Përpara partizanë!»

«Ah partizanë, partizanë...! Në ju zënshtat, të gjallë, mishin në kupë do t'ju ha, përshest fare do t'ju bëj, lëmsh do t'ju mbledh e do t'ju lëshoj udhëve që t'ju shqyejnë qentë e fshatit!...», — kurcenin mendimet në kokë.

Në një çast mendimi iu ndërpri. Iu duk sikur fluturoi. Pastaj ndjeu një zhurmë të llahtarshme. Veshët nisen t'i buçisnin dhe një mijë gjilpëra filuan t'i nguleshin në të gjitha pjesët e trupit. Pra-

në tij diç lëvizi, një send i errët, i gjallë. «Kukudhi!, — mendoi vetëtimthi, — dhe atë çast ndjeu një të therur në zemër, pështyma iu mblodh lëmsh e i zuri grykën. — Kukudhi qenka, për ç'besën!... Bobo!», — po sendi i gjallë u rrotullua paksa dhe Kapllan beu sikur dalloj siluetën e një njeriu. Trupi iu ftoh përnjëherësh. «Partizani!, — gati sa nuk klithi me tmerr. — Partizani vallahi, partizani!»..., — dhe zuri të dridhej e u bë gati të lutej me zë të çjerrë prej qaramani.

— Aman, zoti partizan, aman, në ke perëndi. Unë nuk kam faj. Më qafë më paçin, për besë, më qafë më paçin ata, më të mëdhenjtë, më të diturit, ata të kalemit... Mos më dëmtoni, zoti partizan, mos!...

Blaca e ferrës lëvizi e téra.

— Bej, — u dëgjua një zë i mekur, — jam unë, bej... Ai heshti për një çast. Ç'qe ai që foli ashtu? Njeri ishte... apo...? Kush e kishte njojur e i kishte folur me atë zë? Mornicat nuk i iknin. I njihet mirë grackat, se kishte ngritur vetë kushedi sa të tilla. Edhe shakatë i njihet, se në «shtab» atë e mbanin si shakaxhiun më të madh, po ky zë... ah, ky zë! Eh, ç'janë ata partizanët, ç'janë! Edhe si gra i veshin burrat dhe fap, kur i sheh aty ku s'e pandeh dhe ta nxjerrin përballë grykën e kobures, që të duket si grykë topi. Iu kujtua një këshillë e gjyshit. «Me të mirë, birçe, me të mirë ia ha kokën tjetrit. Urtë e butë e plot tiganin, në do ta ngrysësh rehat-rehat këtë jetë. Hasmit, po s'ia kafshove dorën, puthja, që t'i hash kokën pa u ndier, puthja, se nga të puthurit s'të gjen gjë. Në fitofsh, se për të humbur s'ke ç'humbet. Puthja e hedh më lehtë helmin se

kafshuara, se puthja është e ëmbël, birçe...». Pa u menduar më tej, zuri të lutej më zë të dredhur:

— Të puth këmbë e dorë, zoti partizan, mos më bëj dëm, se dynjallëk i thonë. Sot ti, nesër unë... Kështu e ka kjo jallane. Po më pe sot me një sy, nesër unë të shoh me të dy!

Përsëri blaca e ferrës lëvizi e tëra dhe përsëri u dëgjuai njëjtë zë i mekur, sikur dilte nga fundi i dheut:

— Bej... jam unë, bej!

Kapllan beu u mundua të përqëndrohej. Ktheu kokën ngadalë andej nga vinte zëri dhe vështrimi i ra mbi atë që kishte pranë. E pa dhe e njozu. Ishte Sulo Zgérbonja, «trimi» i tij, përpara të cilit «dridhej» një dynja e tërë. Që të dy ishin atje, në fund të blacës, rrëthuar nga ferrat dy bojë njeriu të larta.

— Bej, — përsëriste Sulo Zgérbonja, — jam unë, bej, nuk më njeh? Jam unë Sulua, që mos qofsha! Unë Sulua, që nuk të ndahem sa të jem gjallë, se të dua me gjithë gjongël, bej...

Kapllan beu, komandanti i çetës së «Ballit Kom-bëtar», që ishte nisur këtyre anëve me një mision special, sipas porosisë që kishin dhënë gjermanët, për «spastrimin» e zonës nga forcat partizane, u ngrit me mundim të madh. Rënkonte. Ishte shqyer, gjakosur dhe shembur në ije. Njëra dorë i dridhej ndërsa ngofjen e majtë mezi e lëvizte.

— More, — dhe hodhi vështrimin rrëth e qark, për të parë në ishin vërtet vetëm apo mbante garchi vesh. — More, — foli sërishmi, dhe, si u siguruai se s'kishte njeri tjeter veç tyre, e ngriti zérin:

— Ty po të them, more Sulo, më dëgjon? Me ty e kam!

— Urdhëro bej, — dhe Suloja brofi, ngarkuar me rrodhe e gjemba, duke u munduar të hapte një copë vend rrëth vetes e Kapllan beut. — Në hyqmin e zotërisë sate jam. Një fjalë ju, dhe unë...

Kapllan beu i erdhi pranë, u sigurua edhe një herë se nuk i përgjonte njeri pas blacës e iu shkreh si njëqind rrufe të rëna së bashku.

— Ç'më rri kështu, more firaun! Nuk e sheh që jemi në luftë? Përpara, se për shpirt të pejgamberit...

Suloja është pa lëvizur qerpikët, duke mbajtur me një dorë ushkurët e potureve e duke nderuar me tjetrin allahitlerçë.

— Ata mbetën pas, bej. — u përgjigj. — Mbetën pas. Më plaçin të dy sytë, në të gënjej.

— Pas?, — beu i hodhi dorën në sup. — Cilët mbetën pas, more?

— Partizanët, bej — Suloja i ngriti edhe ca më lart poturet që i binin, — partizanët...

— Partizanët? — Kapllan beu picërrroi sytë dhe kroi kokën, si për të nxjerrë së bashku me zbrookthin edhe ndonjë mendim të artë. — Ta merr mendja që do të mbeteshin pas. Përpara mund të ecim vetëm ne!

— Vetëm ne, Kapllan bej, vetëm ne, — përsëriti Sulo Zgérbonja dhe u dha një të lëpirë me majë të gjuhës mustaqeve të holla, që i vareshin poshtë, si bisht miu. — E di perëndia. Atë paçim shahit.

Kapllan ubeu lëvizi me mundim të madh dhe, i ndihmuar nga trimi i tij, u dha një bërryl ferrave e doli nga blaca, i çjerrë, sikur kishte bërë luftë me treqind maçokë. U ul mbi një gur për të mble-dhur veten. Shembullin e tij e ndoqi edhe Suloja. Të dy vështronin njëri-tjetrin në heshtje. Kapllan

beu mendonte: «Besnik qerratai. Ja, tē tillë t'i kesh trimat e nuk tē gjen asnje e keqe. Nuk m'u nda këmba-këmbës, rrrodhe nëpër rrrodhet m'u bë. Këtij i thonë trim. Do ta shpall për gradim. Hallall e pastë një llatkë!».



Suloja, nga ana e tij, mendonte: «Të mos ia kishte marrë vrapit Kapllan beu, vallahi, që na zunë të gjallë. Vrap si ky i beat tonë, zor ta ketë njeri. Ky ia kalon edhe pelës kërre».

Kapllan beu e theu heshtjen.

— Hëm...! E ndezim nga një duhan, more Sulo? Sikur kemi kohë pa e hequr një, si thua?

— Kemi, bej, — pohoi Suloja, që po i çuhej hunda dhe e nxori trakaçin e duhanit. — E ndezim, pos. Duhani të mbledh mendjen, bej.

Beu e pyeti:

— More Sulo. Po... po si ndodhi kështu, more? Pe gjë ti, apo...

Suloja ia nguli vështrimin thellë.

— Oj, pashë, thotë! Pashë, bej. Pashë dhe dëgjova, për ç'besoj. Nuk të gënjen Suloja, ty.

Kapllan beu iu afrua edhe ca.

— Po ç'pe, more Sulo? Po fol de, fol!

Suloja i dha një të shkrepur të fortë strallit me masat dhe e afroi eshkën pranë cigares.

— Eh, more bej, ta dish ti se ç'pashë!..., — dhe hoqi thellë tymin e duhanit, — atë që më panë sytë e më dëgjuan veshët, more bej, vetëm varrit do t'ia tregoj.

— Ashtu, ë? — Kapllan beu e vështronte dhe hiqte tymin e cigares. — Ashtu, ë? Po ç'pe e ç'dëgjove, o ditëzi?

— Na hipën sipër e gjeç na zunë të gjallë, bej. Ja këtë pashë, po...

— Po çfarë?

— Po të mos ishe zotrote, që na udhëhoqe me zgjuarësi, aq do e kishim..., — ia ktheu Suloja dhe e vështronte me djallëzi, duke menduar këshillat e gjyshit: «Mos i dil përpara derrit të plagosur,

nipçë, mos i dil, se të shqyen dhe, po e pe keq, ndizi një qiri lugatit. Thuaj siç thotë ai, në do që të shpëtosh lëkurën tënde».

Pas një çasti, beu e ngriti vështrimin e tij. Diç e brente në zemër.

— Po fshati, Sulo, a pa gjë fshati se ç'u bë?

Suloja nxitoi ta qetësonte.

— Jo bej. Ku e kishte mendjen tek ne fshati.

Fshatit iu bë vrima e miut pesëqind groshë.

Kapllan beu u ngrit. Ishte e tepërt të qëndronte aty. Tani ishte bërë plotësisht zot i vetvetes. Ai ishte sërishmi komandant Kapllani, ai Kapllan beu i tmerrshëm që, kur e kthente me një grykë rakinë në kazinon e Thomait, dhe kur tundte këmbët në mes të kazinos, mblidheshin të gjithë një grusht.

— Sulo, — foli e vetullat iu mblohdhën gérth, — ne e bëmë detyrën. Aq sa ne, le ta bëjnë edhe të tjerët, në janë burra. I kemi hallall nga dy rroga, ë?

— Siç bën emër zotrote, bej, — u përgjigj shpejt e shpejt Suloja. — Fjala e zotërisë sate në vesh të qeverisë.

Ata u nisën. Dy orë më vonë, hynin triumfalishët në qytet e, në selinë e «Ballit» u bënë një pritje madhështore.

Zyhra hanëmi, kur mori vesh ngjarjen, u pregatit për një drekë tërë dhjamë, ndërsa në kazino, për të festuar kthimin me fitore të Kapllan beut, filluan të pregatiteshin për një aheng. Ndërkohë, në lagjet e varfra të qytetit buçiste kënga:

Bejlerët teste-teste,

Janë mbledhur, bëjnë kuwend;


Ca me kapele e ca me feste,

Që të gjithë për të ngrënë lëng.

KAPTERI, ZEVENDËSI DHE XHANDAR XHAFFERI

Postblloku qe vendosur në të hyrë të fshatit, aty ku lumi i vjetër formonte një bërryl të gjerë. Pak më tej, ndodhej një pyll i madh me vidha. Tërë ditën xhandarët, herë hedhur pushkën mbi supe e herë me nga një kamxhik në dorë thurur me fije liri, endeshin lart e poshtë nëpër fshat e vinin deri buzë pyllit. (Më larg e kishin ca si të përpjete për të vajtur, sepse qenë hapur ca fjalë sikur gjoja në atë pyll vinin herë pas here partizanët ata nuk para kishin dëshirë ta linin lëkurën gjékundi. Këto vajtje-ardhje bëheshin për të «mbajtur rregullin dhe rendin». Në mbrëmje, kur dielli thyhej gjer një hosten përmbi det, ata ktheheshin në postbllok, mbylleshin brenda mureve prej çimentoje dhe nuk dilnin që andej pa u ngritur prapë dielli një litar samari lart. E kishin trimërinë diell më diell...)

Në këto «shëtitje» të përditshme, vendet më të preferuara ishin pijetorja, e vëtmja e fshatit, ku xha Llazi e shiste marenë e zier dy herë për raki rrushi 18-gradëshe e ku luhej kollçinë tërë ditën me nga katër suxhukë loja, konakët e beut, ndër-



tuar në qendër të fshatit, pak më tej pijetores, ku zonja jepte hera-herës ndonjë «suare» për miqtë e saj të nderuar dhe mulliri i xha Agushit, një mulli i vjetër me ujë ku gatuheshin fjalët dhe mbarseshin mendimet që rridhnin bashkë me ujërat e remës dhe merrnin pastaj fshatrat anembanë.

Xhandarët, që ishin tërë sy e veshë, i shihnin të gjitha, sepse duhej t'i shihnin, si «syri i qeverisë» që ishin dhe, për çdo gjë që vërenin, mbanin shënimë, se kështu ishte urdhri nga lart; i dëgjonin të gjitha, se ata duhej të dëgjonin, si «veshi i qeverisë» që ishin dhe prapë të mbanin shënimë, se kështu ishte urdhri nga lart, dhe të dërgonin më lart sa më shumë shënimë, sepse, thoshin, lëkura e një xhandari që nuk dërgon shënimë, nuk vlen asnjë grosh. Ata edhe flisnin, sepse duhej të flisnin, si «gjuhë e qeverisë» që ishin dhe, për sa flisnin, duhej të mbanin shënimë, sepse kështu ishte urdhri nga lart, mirëpo fshatit as që i bëhej vonë nëse shihnin, nëse dëgjonin dhe nëse flisnin xhandarët. Fshati kishte sytë e vet, veshët e vet dhe gjuhën e vet. Dhe qëkurse malet ishin mbushur plot me partizanë, fshati shihte më shumë, dëgjonte më shumë dhe fliste më shumë.

Po xhandarët ishin aty për të «mbrojtur e mbajtur rendin» dhe, si njerëz të ligjit, ata kishin edhe fjalën edhe verenë, edhe kërbaçin. Dhe të tria këto «virtute» ata dinin ku t'i tregonin. Fjalën, fjala vjen, e kishin për zonjën e Selfo beut, e cila preferonte më shumë zotin kapter, si komandant i postës që ishte. Verenë e ruanin për ta lënë rehem te xha Llazi, sa herë që i rrëkëllenin lyftit nga një «duçe» mbushur me raki mareje dhe kërbaçin e mbanin gati për popullin fukara, ose për

harbuterinë, siç shpreheshin vetë, sa herë që ndokush guxonte të ngríhej kundra rendit, domethënë kundra qeverisë së regjencës, se xhandari s'ishte gjë tjetër veçse i plotfuqishmi i saj.

Një ditë, kapteri gjeti mbi tavolinë një letër. Ishte një letër një pëllëmbë e gjatë, e hollë e me ngjyrë të kuqe, e shkruar në të dy krahët. U çudit. C'të ishte ajo letër vallë? E mori dhe e lezoi. Mornica i shkuar në trup dhe e flaku tej, sikur i kishte rënë në dorë një thëngjill i ndezur që e përvëloj. U shemb në karrige, i zverdhur e i bëre dyllë. Dridhej i téri. Ajo që kishte gjetur mbi tavolinë, ishte një komunikatë, një komunikatë komuniste, tamam si ato që, siç i kishin treguar shokët e tij xhandarë, hidheshin dendur në qytet. Tamam për ato zoti kapiten u kishte folur kaq herë dhe u kishte tërhequr veshin që t'i bënin katër sy e veshë bashkë.

Në karakoll u bë zhurmë e madhe.

— Në zyrën e komandantit të postës u gjend një letër e kuqe, — tha një xendar.

— Aha, po qe letër e kuqe, është komunikatë komuniste. Ata e kanë hedhur sepse janë të kuq, — shtoi një tjetër me bindje.

— Edepsëzët!, — cirrej kapteri. — Në hell do t'i shkojmë dhe në hell do t'i pjekim. Kush guxoi bre, kush guxoi bre, të na hapë këtë telash kaq të madh me qeverinë?

Kapteri ishte bëre si i xhindosur. Urgjentisht têrhoqi një tel në selinë e rrëthkomandës: «Në zyrën e komandantit të postës, komunikatë komuniste, stop. Njoftoni për veprime të mëtejshme, stop».

Dhe po priste. Nuk e mbante vendi. «C'do të thonë në rrëthkomandë, — mendonte. — Kush do të më dalë zot?»

Po atë ditë, rrighthkomanda e xhandarmërisë urdhëronte: «Të zhdukni komunistët, stop. Presim njoftime, stop».

Kapteri u ul në karrige, aty në krye të tavolinës, dhe nisi të vriste mendjen. Thirri në një këshillë «xhenerale»: xhandarët, beun, kryeplakun, qehajanë dhe aty afër mbrëmjes, pasi e rrahën çështjen mbarë e prapë, i dhanë karar: «Të thérresim xha Agushin, mullixhiun. Sado-kudo, ai e ka ca në dorë fshatin. Le t'ia shtrëngojmë rripat. Ai do t'ia shtrëngojë fshatit dhe fshati komunistëve. Kështu janë këto punë. Mblidh të mbledhim i thonë. Pastaj, komunistët, kanë për të parë se cilët jemi ne **dhe cilët janë ata**. Le të guxojnë edhe një herë tjetër të hedhin komunikata e të shqetësojnë xhandarmërinë dhe qeverinë e regjencës së nderuar».

Dhe ata thirrën xha Agushin, po ai mblodhi supet.

— Ku ta di unë, — tha, — ku ta di unë se ç'bëhet në fshat? Mua në mulli më gjen ditë e natë. Keni ankesa përmullirin? Ja tek jam unë. Nuk e bluaj mirë drithin? Ja tek jam unë.

Kapterin nuk e mbante vendi.

— Mblidh fshatin, po të them! Mblidhja fshatit që fshati t'ua mbledhë komunistëve, pastaj.

Xha Agushi u përgjigj:

— Unë jam mullixhi, zoti kapter, nuk jam kryeplak. Ja tek është kryeplaku. Ai le t'ia mbledhë fshatit. Ama, po s'ia mblodhi dot, le t'ia zgjidhë, mua aq më bën.

Dhanë e morën xhandarët për ta bindur xha Agushin, po ai as që tundej nga e tija. Atëherë ata thirrën xha Llazin, pijeshitësin, dhe ia mblodhën atij.

— Ty tē themi, — i thanë, — po pamë tē hidhen nē fshat komunikata komuniste me letra tē kuqe, ta mbyllëm pijetoren. Edhe Agushit do t'ia mbyllim mullirin dhe fshati le tē bluajë nē mokra pastaj, se nuk e gjen gjë, kuptuat? Hajde, mbushuni!

Xha Agushi u largua i qetë. Pas tij vinte xha Llazi, duke hequr zvarë-zvarë këmbën e majtë, që shpesh i mpihej nga përdhesi; ndërsa xhendarët, beu, kryeplaku dhe qehajai, pas këtij vendimi kaq tē mençur ia shtruan me tē pirë, duke bërë nga një dorë bakara.

— Na marrshin tē keqen komunistët, — trimërohej kapteri, — jemi ne këtu, jemi gjallë e, pérderisa jemi ne, ata nuk shohin nga sytë.

Po, një javë më vonë, përsëri nē zyrën e komandantit tē postës u gjend një letër e kuqe. Përsëri nē postbllok u bë zhurmë dhe pati lëvizje tē madhe.

— Në zyrën e komandantit u gjend përsëri një letër e kuqe.

— Heu! Komunikatë do tē jetë! Vallahi, bilahi, komunikatë komuniste është. E kanë hedhur komunistët. Tutje dreq! Nuk po na ndahanen.

— Edepsëzët! A nuk dëgjuan kur thamë se do t'i shkojmë nē hell? C'presin më? Përse nuk e thyejnë qafën e nuk na lënë rehat?, — cirrej kapteri.

Përsëri xhendarët u mblohdhën kokë më kokë dhe përsëri dërguan një telegram urgjent nē rrëthkomandë. Përsëri nga rrëthkomanda dërguan telegram urgjent me pak fjalë: «Komunistët tē asgjësohen, stop. Presim njoftime, stop».

Përsëri këshillë «xhenerale» me xhendarët,

beun, kryeplakun e qehajanë dhe pas konsultës, një vendim i formës së prerë: «T'i asgjësojmë komunistët kudo që të jenë». Po si?

Kapteri ra në hall. Në hall ranë edhe xhendarët. Në hall kishin rënë edhe beu me zonjën, që u kishin ngjitur një komunikatë në dyert e konakëve. Në hall ishte kredhur edhe xha Llazi, që mbahej fort pas defterëve të veresieve.

Po halli nxjerr hallin, thonë. Dhe kapterit, dikush i tha në veshin e djathtë: (sepse nga i majti nuk dëgjonte mirë qëkurse e kishte pickuar një grerëz, që i kishte lënë thumbin brenda).

— Partizanët kanë vendosur të sulmojnë karkollin. Me të dëgjuar e kam, po ti vëru veshin fjalëve se nuk dalin kot!

— Partizanët? Je në vete?!, — kapteri e hodhi vështrimin përreth se mos e dëgjonte njeri dhe vuri gishtin në majë të buzës. — Shëëë! Ka edhe gardhi veshë. Mbylle! Mos ta marrë vesh zëvendësi im. Nuk eshtë mirë të përhapet panik.

Zëvendësit të kapterit i zuri veshi një fjalë.

— Partizanët kanë vendosur të sulmojnë karkollin. E kam marrë vesh mirë. Sonte i ke këtu!

— Partizanët?, — zëvendësi i kapterit çorri sytë dhe hapi veshët. — Shëëët! Mbylle, mos të të dëgjojë njeri. Mos ta marrë vesh zëvendësi im, aq do ai.

Zëvendësit të zëvendësit të kapterit, i tha miku i mikut:

— Partizanët kanë vendosur të sulmojnë karkollin. Sapo më njoftuan dhe unë të kam mik e, si mik, dua të të shpëtoj.

— Partizanët?!, — dhe ai u mblodh si iriq. — Mbylle, për kokën tënde. Mbylle aman, e mos fol

më. Mos ta marrë vesh xhandari, se na piu e zeza.
Aq do ai dhe...

Po edhe pér xhandarin u gjend një «zemërmirë».

— Kam dëgjuar, — i tha, — sikur partizanët kanë vendosur që sonte të sulmojnë karakollin.

— Partizanët?, — xhandari zgurdulloi sytë i tmerruar. — Shëeët! Mbylle, t'u bëftë vëllai, se mos e merr vesh kapteri e atëherë mjerë unë dhe ti bashkë me mua. Na preu koromanen. Ai është i madhi dhe i vogli këtu. Ç'thotë ai, është e bërë.

Në mbrëmje, shumë më parë sesa dielli të hynte në xhepin e detit, xhandarët u kthyen në karakoll. Kapterin e gjetën shumë të sëkëlldisur. Ishte ulur në tavolinë dhe kishte kapur kokën me të dyja duart.

— Ç'të paska gjetur kështu?, — e pyetën.

— Mora një letër nga shtëpia, dhe më është ngritur mendja, — u tha ai pa e ngritur vështrimin lart. — Kam Validenë sëmurë. Po nisem. Po më kërkoi njeri, i thoni se do të kthehem nesër që pa kënduar kaposhi i parë.

— Po ikën?

— Po. Nuk më mban më vendi...

Dhe si u bëri një temena shokëve, kapteri doli. Të tjeterët vështruan njëri-tjetrin në sy, pa e dhënë veten.

Më cazë, zevendësi i kapterit u ngrit vrangthi si i lebetitur.

— Oj! Më preu barku, vellezër. Ku ta dish? Po sikur të më jetë shpuar plënci? Po qe me të vërtetë kështu, mjerë unë dhe regjenca. Ika, vellezër, ika gjer te heqimi se nuk po duroj dot më.

Pa dalë mirë ai, zëvendësi i zëvendësit, i hodi një vështrim xhandarit.

— O Xhaferri mavria, — i tha dhe sytë i perëndoi si i vilanosur. — Më ka marrë malli përkasabanë, o i vrarë. A më jep lejë të bëj një vrap gjer në qytet dhe të kthehem nesër pa nxjerrë sy dielli dhe pa e marrë vesh kapteri?

Xhaferri ia ktheu flakë për flakë:

— Dreq. Kaq të paska shkuar? Ik ore. Bëji selam ndonjë të njohuri edhe nga ana ime.

— Mos u bëj merak. I them unë.

Dhe zëvendësi i zëvendësit u zhduk në mugëtirën e mbrëmjes.

Xhandar Xhaferri mbeti vetëm.

«Të poshrit!, — mendoi dhe filloi të qeshte.

— Kujtuan se ma hodhën, po na, na..., — dhe rrahu fort bërrylin. — Tani i vë edhe unë pishën karakollit dhe...»

Po nuk arriti ta conte më tej mendimin e tij se në fshat u dëgjuan ca krisma. Ai mbajti vesh. Krismat sa vinin dhe shtoheshin.

«Djall, jo! A thua të jenë më të vërtetë partizanët?!»

Xhandar Xhaferri bëri të dilte jashtë, me pushkë në dorë. Nata dukej e errët. Krismat pushuan, aq sa ai dyshoi: Krisma ishin ato që dëgjoi më parë apo jo? Sidoqoftë në karakoll nuk rrihej më. Gjer dje ishte vendi më i sigurtë, mirëpo sonte ishte bërë beterr, pa vlerë. Xhandar Xhaferri arriti te sheshi. Pa së largu ca njerëz dhe tri hije që kishin ngritur duart lart. Pa dhe nga rrugicat rrëth e rrotull, ku s'kishte njeri. Po kush ia mbushte mendjen xhandar Xhaferrit se nëpër to s'kishte njeri?

— Ore! Mos qëlloni, për perëndi! Ja, erdha edhe unë!, — tha Xhaferri dhe eci me duart lart.

SHPËRNDARËSI I KOMUNIKATAVE

Ishte ditë pazari, tregu gumëzhinte nga njerëzit. Fshatarë nga të katër anët e krahinës kishin zbritur për të shitur prodhimet e tyre të pakta: kush një pulë, një tjetër pesë kokrra vezë lidhur në cep të peshqirit, ca të tjerë shportat me zarzavat apo fruta, por shumica kishte zbritur me thes në krah për të blerë një brokë misër.

Ishin vite kur drithi shitej okë e flori dhe tregtarët, që kishin pritur kohëra të tilla, i kishin ngritur çmimet sa s'bëhej më.

Certexhinjtë, xhokaxhinjtë, shtrëmbarët, tene-qexhinjtë, kallajxhinjtë, aty edhe kafexhinjtë, që kishin ngritur nga një tezgë në mes të tregut apo gjer edhe vetë xha Dauti plak që shiste qofte e kukurec, thërrisin e sikush përpinqej të reklamonte mallin e vet. Herë pas here dëgjoheshin zërat e atyre që shisnin penj e takije, por nuk mbeteshin pas edhe ata që shisnin letra cigare ose mashqe letre, ata që shisnin borë me pekmez dhe ujë me akull, vendosur në ca ibrikë të mëdhenj të bakërtë.

Shitej çdo gjë, sepse gjithçka mungonte, dhe njerëzia shfrytëzonin tregun e zi për të plotësuar nevojat e tyre më të ngutshme.

Midis njerëzve që mbushnin pazarin, një fëmijë i vogël, rrëth të trembëdhjetave, ecte herë du ka çarë me bërryla e herë duke i bërë udhë vetes me atë trupin e tij të thatimtë. Në qafë kishte hedhur një rrip, me të cilin kishte lidhur një tezgë që i varej në gjoks. Pasi hidhte tri-katër çape, lëshonte thirrjen e tij të zakonshme:

— Brisqe maqine, brisqe maqine. Mashqe letre, mashqe letre. Të mira dhe të lira, të mira dhe të lira!

Pazari oshëtinte. Dëgjohej zëri prej basi i një xhokaxhiu:

— Erdhi ustai nga Berati, erdhi. Shallvare të mira dhe të lira. Kemi edhe feste!

Pranë tij, një shtëmbaxhi përplaste me njëratjetren dy poçe.

— Poçe nga Kavaja, poçe nga Kavaja, i merrni te daja. Kemi edhe tava, edhe shtëmba, edhe qypa. Erdhi daja nga Kavaja, erdhi!

— Penj e takije, penj e takije për çdo nahi!

— Kastraveca! Ohoho...! Edhe një kosh mbeti, edhe një. Kastraveca të freskët!

Xha Dauti e ngrinte zérin fort,

— Kukurec! Kukurec me spec. Dhe vocërraku:

— Brisqe maqine, brisqe mäqine! Mashqe letre, mashqe letre. Të mira dhe të lira, të mira dhe të lira. Erdhi ustai, erdhi...

Mizéri njerëzish, gjithçka në lëvizje.

Lëviznin edhe spiunët, që ishin lëshuar nga të katër anët si qentë pas gjahut. Fashistët ishin lemerisur. Traktet komuniste po shpërndaheshin në të katër anët dhe nuk po kapeshin dot ata që

i shpérndanin. Fraza që shkruhej në fund të traktit: «Lexoje, shpérndaje, armikut mos ia dorëzo» i tèrbonte fare. Si ishte e mundur që ata, aq të fuqishëm, të mos ishin të zotët të binin në gjurmë të komunistëve e të mos i arrestonin dot?

Midis spiunëve, një njeri me borsalinë e menjë bastun në dorë e cte i tendosur, i téri sy e veshë.

— Dëgjo këtu, — i kishte thënë një ditë më parë kuestori, — ose do t'i zbuloni ata që shpérndajnë këto trakte, ose me kaq merr fund dhe karriera juaj!

Spiuni qe përkulur, pa guxuar t'i hidhte vështrimin eprorit të vet qe zmbrapsur e, kur ishte gjendur në rrugë, ishte munduar të mblidhte veten.

— Unë do t'i gjej, — qe përbetuar, — unë do t'i gjej domosdo!

Dhe tani, ai çante midis njerëzve, i gatshëm për t'u hedhur mbi cilindo që do t'i dukej si i dyshimtë! Nga pas e ndiqnin si hije dy nga bashkëpunëtorët e tij.

Dita-ditës po u nxirrin telashe të mëdha komunistët. Para ca ditësh kishin hedhur një trakt edhe në shtëpinë e kuestorit. Ai qe shqetësuar mjaft, mirëpo kur kishte ardhur në zyrë, qe tèrbuar fare. Një komunikatë të tillë ia kishin hedhur edhe aty. Kjo i kishte vënë në gjendje alarmi të gjithë spiunët. Po ditët shkonin e ata nuk binin dot në asnje gjurmë.

— Kjo është e tmerrshme, — pëshpëriste spiuni me borsalinë, — i ke përreth e s'di nga cili të ruhesh, s'di kë të kapësh!

Pranë tij u duk vogëlushi me tezgën në qafë.
Ai thirri më fort se herët e tjera:

— Brisqe maqine, brisqe maqine. Mashqe letre, mashqe letre. Të mira dhe të lira, të mira dhe të lira. Erdhi ustai, erdhi!

Spiuni qëndroi. Ky vocërrak e kujtoi të pinte një cigare, që të qetësohej pakëz. Futi dorën në xhep dhe nxori kutinë e duhanit. Nuk kishte më fije letre dhe thirri:

— Ej, çun!

Vogëlushi qëndroi në çast.

— Urdhéroni zotni, — dhe iu afrua. — Kérkuat gjë, zotni? Kemi brisqe maqine dhe mashqe letre.

Spiuni foli me vetullat ngrysur:

— Nuk ke ndonjë tefter letër?

Vogëlushi i shkeli syrin me djallëzi.

— Kam zotni, po, edhe sikur mos të kisha, për ju do ta gjeja një copë. — Dhe me një lëvizje të shpejtë, nxori nga xhepi një defter letra.

— Urdhéroni zotni!

Spiuni pagoi dhe po ndiqte me vështrim këtë djalë që, pasi hodhi në xhep paratë, u largua me shpejtësi, duke përsëritur të njëjtën thirrje:

— Brisqe maqine, brisqe maqine. Mashqe letre, mashqe letre. Erdhi ustai, erdhi!

— Ç'firaun, — pëshpëriti, — aq i vogël dhe di ta nxjerrë vetë bukën e tij.

Mori defterin e letrave, e grisi mbulesën e saj dhe u bë gati të merrte një fije, kur në kuti i ra një letër e palosur, që kishte qenë fshehur brenda defterit të letrave të cigares. Ndjeu një të rrëqethur. Ç'ishte ajo letër ashtu?! E mori. Gishterinjtë filluan t'i dridheshin. E çeli dhe mbeti

si i shtangur. Në duar mbante një komunikatë. Një komunikatë që komunistët ia kishin lëshuar në dorë pa e kuptuar fare. Dhe kush ia kishte punuar këtë rrëng? Një fëmijë, një rreckaman!

E mblodhi veten. Me një lëvizje të shpejtë nxori bilbilin, i fryu fort dhe filloi të thërriste si i marrë:

— Kapeni, kapeni komunistin! — **“TAMIRAT”**

Dy të tjerët, që i qëndronin pas si hije, u lëshuan në drejtimin që u jepte ustai i tyre, por tani që tepër vonë. Vogëlushi që zhdukur mes turmës.

— **“TAMIRAT”**

— **“TAMIRAT”**

— **“TAMIRAT”**

«TRIMAT» E DUÇES DHE ATENTATORËT


Dielli kishte kohë që ishte varur përtej detit, kurse hëna akoma nuk e kishte nxjerrë vetullën e saj. Mbrëmje të tilla, kur napa e errët pushton te gjithë hapësirën dhe nuk linte asnjë sy drite, nuk ishin fort të këndshme për fashistët, ndaj dhe i shtonin patrullat e tyre, që përshkonin rrugët e heshtura të qytetit, duke lënë pas jehonën e mbytur të trokitjeve të gozhdëve mbi gur.

Asgjë s'pipëtinte dhe kjo heshtje kaq e thellë herë pas here i shqetësonte rojet. Ku ta dish? Në çdo çap, pas çdo lëvizjeje, nga heshtja tinzare mund të dilte ndonjë njeri dhe në një sekondë të bëhej hataja, sikundër qe bëre kushedi sa herë. Ecnin tërë sy e veshë, me pushkët gati për zjarr, sepse kishin disa kohë që lufta kishte ardhur e ashpër dhe pa mëshirë deri në periferi të qytetit dhe në rrugët e tij binin të vrarë goxha burra kombi. Këta partizanët ishin me të vërtetë të çuditshëm. E vinin kokën në torbë dhe nuk e peshonin fare rrezikun.

Njëra prej patrullave kishte depërtuar thellë në rrugët e lagjes së varfanjakëve, siç e quanin

njérën prej lagjeve të qytetit, duke u munduar të shquante diçka në errësirën e mbrëmjes e mos gjëlliste ndonjë lëvizje të dyshimtë.

Ishin tre vetë: dy karabinierë dhe një rrështer. Njëri prej tyre, trupgjatë, me ftyrë të rrëshkur si eshkë e thatë, e ndiente veten më keq se të tjerët.



Megjithëse e rrihte freskia e natës, fytyra i qe lagur nga djersa sikur ta kishin lëpirë kërmijtë. Kapteri, pak më i shkurtër se ai, me fytyrë bojë pjepri bulldavec e me ca sy të vegjël si të kundhesh, e vuri re shqetësimin e shokut të vet, që herë mbështetej pas tij dhe herë pengohej me këmbët e veta duke kthyer kryet sa andej-këndej si ndonjë mi ugari.

— Ma..., — foli në dialektin e vet, — ç'dreqin ke kështu, që sillesh sikur të ka hyrë lepuri, në bark?

Tjetri, pa kthyer kokën, duke mos ia vënë veshin qortimit të eprorit, u përgjigj me gjysmë zëri:

— Hai ragione, amico mio,¹⁾ s'ke shumë kohë këtu dhe nuk i di të papriturat e këtij qyteti, që shpërthen atëherë kur pandeh se ai ka rënë në gjumi. Është një djall qytet ky, që nuk ia gjen shokun. Tkurret dhe shtrihet, disa i nxjerr nëpër rrugë dhe disa i fsheh. Gjithçka është e dyshimtë dhe duhet parë me dyshim.

— Oj!, — tjetri shprehu shenjë habie. — Për herë të parë po e dëgjoj!

— Kështu si të them. Këtu partizanët janë shumë aktivë. Mbijnë aty ku s'ta pret mendja dhe bëjnë atë që s'ta merr mendja.

— I partigiani?²⁾

— Po, pikërisht ata. Dalin atje ku nuk i pret dhe zhduken kur kujton se i ke në dorë. Rrëshqesin si ngjalë dhe ec e kapi në je burrë. Janë të

1) Ke të drejtë, miku im.

2) Partizanët?

papérmbajtshëm. Sono terribili,¹⁾). Nuk te dëgjove? Pardje shtrinë përtokë, në mes të pijetores, atë togerin me mustaqe, zotin Murrizi. Unë isha atje. Mamma mia, ç'më panë sytë!

Sykunadhja ia dha të qeshurit.

— Mos more!

— Për zotin, në të gënjej! Nga këndi i rrugës sikur mbinë dy vetë, hynë në kafe, iu drejtuan zotit Murrizi, shqiptuan ca fjalë në gjuhë të tyre dhe gjithë lokalë gjëmoi nga krismat. Togeri u shtri sa gjatë gjerë, ndërsa...

— Ndërsa ju ia mbathët vrapi, kështu?

— Jo. Ne u hodhëm përpara, por qe tepër vonë. Ata qenë zhdukur si t'i kishte përpirë dheu. Kontrolluam gjithandej, po asgjë. Prej tyre asnjë gjurmë.

Sykunadhja i hodhi dorën në sup.

— Ashtu? Tjetërherë të uroj fat më të mirë, — i tha e pastaj shtoi: — Kam dëshirë të ndodhem vetë njëherë përballë tyre. I shtrij përdhe të vdekur e asnjë çap nuk hedh prapa, — dhe ra sérishmi në mendimet e veta, ndërsa eshka e thatë vazhdonte t'i mbante veshët bigë përpjetë, duke u munduar të kapte edhe lëvizjen më të dyshimtë.

Pasi hodhën edhe disa hapa, sykunadhja foli sérishmi:

— I mjeri Xhuzepe! Më vjen keq për ty, qenke bërë pér t'u mëshiruar. Të paskan kallur tmerrin në bark partizanët... ata banditë. — Pastaj befas ndryshoi ton, u bë i rreptë, i egër e kërcëlliu dhëmbët duke gjëmuar me një zë të mybutur: — Dëgjo Xhuzepe, — iu drejtua shokut të vet që tu-

1) Janë të tmerrshëm.

latej si lepur e zemra i rrihte si ndonjë sahat rroskop, — partizanët as që duhen shënuar në regjistrin e të gjallëve. Ata janë ca fantazma dhe fantazmat nuk guxojnë të na afrohen. Nguli mirë në kokë këto fjalë: Bajonetat e Duçes së fashizmit nuk pyesin për partizanët. Ne jemi perandoria që po mbjell kudo kulturën romake. Përpara nesh dridhen kombe të tëra, Xhuzepe, dhe armët tonë janë të pathyeshme. Dhe në është se vranë ndonjë oficer, kjo është luftë, dikush edhe do të vritet, hai kapito?!

— Ho kapito, ho kapito, — i tha tjetri, pa i vënë veshin shokut që fliste ashtu, i ngrehur si kaposhi majë plehut, — veçse ndonjë ditë, në qoftë se befas do të ndodhesh ballë për ballë ndonjë partizani, kujtomë dhe mos thuaj se të përrallisa ashtu kot së koti.

Kurse ushtari tjetër, që deri atëherë kishte heshtur, tha edhe ai me zë të ulët:

— Më kanë thënë se edhe vetë sinjor De Anxhelis, që është goxha kuestor, përparrë të cilët dridhen të gjithë, kur i kujtojnë atentatorët e partizanët, zë i dridhet buza dhe zverdhet si limon.

— Ata i kanë të pakta fjalët, po të vunë në shenjë, aq e pate, të përpiu e zeza, — tha Xhuzepja.

— Fjalë në erë, fjalë në erë, — shtoi tjetri që deshi të mbyllej sa më parë kjo bisedë se i acaronte nervat. — Unë as që i peshoj fare. Ehu, sa kam parë e sa kam dëgjuar unë. Le të vijnë partizanët, le të dalin në shesh dhe kanë për të parë se cili jam unë. I kam rënë pash më pash

1) E more vesh?

Abisinisë, Libisë, Somalisë!... Dhe ja ku jam këtu.
Le ta provojë, kujt ia mban.

Të tre karabinierët bënë një kthesë të fortë.
Po afronte ora që togeri De Anxhelis të zbriste nga
kuestura dhe ata duhej të arrinin aty sa më parë
për të përforuar patrullën përreth kuesturës, kur
tej, në bërryl të rrugës lëvizën ca hije që morën
drejtimin e tyre. Eshka e thatë, Xhuzepja, shtangu.
Vetvetiu ai bëri një lëvizje drejt shokut të vet
dhe u mbështet pas tij.

— Dio mio,¹⁾ — belbëzoi, — i partigiani!

Sykunadhja i dha një të shtyrë me bërryl.

— Mjaft!, — e qortoi ashpër.

Pas disa hapash, dy nga «hijet» u dukën përballë tyre. Karabinierët i panë mirë. Njëri kishte hedhur shpatullave një bërruc të rëndë, ndërsa tjetri, një kapotë ushtarake. Tani nuk kishte asnjë pikë dyshimi. Ata ishin njerëz që lëviznin drejt tyre. Pjepri bulldavec nuk priti më gjatë por lëshoi thirrjen e tij të zakonshme që jehoi në thelli si të rrugicës:

— Ej, ju atje, ndaloni!

Dhe e shkundi fort shokun e vet që kishte më të djathë.

— Kujdes. Tani ke për të parë!, — i tha. — Ua rregulloj unë këtyre tipave që shkelin rregullat e vendosura!

Të panjohurit qëndruan. Njëri nga ata, ai që mbante bërrucin hedhur krahevë, i tha shokut të vet me zë të ulët:

— Edhe këta na duheshin tani.

Tjetri shtrëngoi nofullat.

1) O zot, partizanët!

— Togeri ka pér tē dalë, kurse vonesa do tē na dështojë gjithë aksionin. T'i asgjësojmë këta e pastaj hidhemi në drejtim tē kuesturës.

— E pamundur, — tha ai me bërruc me ton tē prerë. — Nxirre nagantën, po mos qëllo. Duhet t'i çarmatosim pa zhurmë, ndryshe krismat do tē shkaktojnë alarm.

U dëgjua zëri i çjerrë i sykunadhes:

— Ej! Asnjë hap përpara, morët vesh?

Dhe u nisën drejt hijeve, me pushkët në dorë, gati pér tē marrë shenjë. Hijet qëndronin si tē shtangura, sikur kishin lëshuar rrënëtë në tokë. Karabinierët u afroan pranë tyre. Pjepri bulldavec gjëmoi sérishmi, siç e kishte zakon:

— Duart lart! — Po fjala i mbeti në grykë. Përballë tyre ishin drejtuar dy gryka armësh si dy gryka topi. Pjepri bulldavec, me një lëvizje tē shpejtë ngriti pushkën e u bë gati tē qëllonte, kur ndjeu se dikush iu hodh përsipër dhe e pérplasi përtokë, ndërsa eshka e thatë u këput. I treti hodhi armën përtokë:

— Mamma mia!¹⁾, — mundi tē fliste ai.

— Ej, ju!..., — bulldaveci fillon tē llomotiste pa ditur edhe vetë se c'thoshte, duke u përpjekur tē çlirohej nga ato duar, që i shtrëngoheshin rrëth fytit si një darë e hekurt. — Aha... Nuk e kemi kështu, amiko. — Por ishte tepër vonë. Sytë iu errësan dhe, kur erdhi në vete, e pa veten tē çarmatosur e tē lidhur përkrah eshkës së thatë dhe karabinierit tjetër.

Kaluan pak çaste. Andej nga kuestura u dëgjua një breshëri automatiku dhe tē shtëna revol-

1) O nëna ime!

verash. Eshka e thatë dridhej si ta kishin zënë shtatë palë ethe. Bulldaveci mezi merrte frymë. I treti s'bëhej fare i gjallë. Të tre, mbështetur njëri pranë tjetrit, aty në një kanal, rrëzë një avllie të vjetër, ishin kredhur qull në djersë.

— Mamma mia, — belb zonte p rs ri Xhuzepja.

— Ta thashë, miku im. Ata janë djaj të vërtetë!

— Lascia stare¹⁾), — iu përgjigj tjetri, që kapërsonte pështymën me zor ngaqë i ishte tharë gurmazi.

Në rrugë, zhurma sa vinte e shtohej. Dëgjo-heshin edhe zëra:

— «Il tenente De Anxhelis, è morto! Lo hanno uciso i partigiani!»²⁾

Eshka e thatë u ngrit mbi bërryla.

— Il tenente, — foli něper dhëmbë, — paskan vrarë togerin, — po pjepri bulldavec nuk mblidhte dot kryqëzet dhe merrte frymë me zor.

— Në djall të vejë togeri dhe kush e bëri atë!, — tha me zë të mekur i treti. — Thuaj shyqyr që shpëtuam vetë!

1) Mjaft më.

2) Toger Anxheloa vdiq! E vranë partizanët!

PUSI DHE ÇITJANET E HANËMIT

Gjermanët dhe shërbëtorët e tyre të Ballit, vendosur në atë fshat fare pranë qytetit, as që e shkonin nëpër mend se partizanët mund t'i sulmoni aty, në strofkën e tyre, dhe për më tepër ditën. Megjithëkëtë, kjo nuk i pëlgente Halim beut, beut të fshatit dhe ajo lloj shkujdesje e ballistëve, se gjója askush nuk guxonte të afrohej aty, e trempte boll.

— Herr kapiten, — guxoi t'i thoshte komendantit gjerman që ta dëgjonte edhe Kamber beu, i cili ishte njëri prej krerëve më të dëgjuar të «Ballit Kombëtar» dhe miku i tij, atë ditë që i vajtën mysafirë në shtëpi. — Duhet të tregohemi shumë të vëmendshëm. Kam dëgjuar se partizanët kanë filluar të sillen edhe këtyre anëve. I njoh mirë partizanët unë, mbijnë si hije.

— Janë si fara e hidhsit, — ndërhyri e shoqja, Saliko hanëmi, një grua e re, e bëshme, që gjithë ditën e kalonte para pasqyrës duke bërë tualet, për ta zbukuruar ca fytyrën që kishte nisur t'i rrudhosej. — Janë si fara e hidhsit ata, që u shofshin e mos mbifshin kurrë! Na mbyllën brenda e na e kanë bërë gjakun ujë.

Kapiteni gjerman, i shtrirë në kanape krejt i shkujdesur, me këmbën hedhur përmbi këmbë, buzë-qeshi lehtë e, duke i hedhur hanëmit një vështrim shumë kuqtimplotë, foli me një ton të thatë:

— Mos u shqetësoni, zonjë. Edhe ju, zoti Halim, bej rrini i qetë. Atje ku shkel këmba e ushtarit gjerman, askush nuk guxon të afrohet pa lënë më parë kockat e veta.

— Janë marrë të gjitha masat, bej, — foli Kamber beu. — Janë marrë të gjitha masat e nevojshme. Jashtë, gjer në të hyrë të fshatit, kemi nxjerrë roje të përforcuara. Ky fshat tani i shëmbëllen një kalaje!

— Edhe pa roje mund të jemi të qetë, — tha kapiteni gjerman, tek i cili shquhej haptazi ndjenja e krenarisë. — Hija e një ushtari gjerman është më e fuqishme se një batalion i tërë partizan.

— Zoti Herman ka të drejtë, — miratoi në çast Kamber beu, për t'i bërë qejfin gjermanit. — Ushtritë e Rajhut të Tretë janë të pathyeshme. Ato zoterojnë portat e botës.

— Ashtu goftë, — tha Halim beu, megjithëse në zemër ndiente një boshllék të thellë, shenjë kjo e një parandjenje të keqe. — Hallet e mia janë edhe hallet tuaja, zoterinj. Këta bujqit e mi janë tèrbuar fare. Lëre të dhjetën e shtetit, por nuk po japid as të tretën time. Të shumtë janë edhe ata që kanë dalë në mal e janë bashkuar me partizanët. Ka kohë që më ka pushtuar një ndjennjë e fortë pasigurie. Po sikur ndonjë ditë, parpritur e pakujtar, të na vijnë e të na sulmojnë këtu?

— E pamundur bej, — u hodh Kamber beu.

— Gjermanët nuk kanë për të lejuar kurrë një sulm të till. Apo jo, herr Herman?

— Pa dyshim, — u përgjigj Gjermani, pa lëvizur fare nga vendi.

— Le të shpresojmë, — ngushëlloi veten Halim beu. — Ne jemi gati t'ju ndihmojmë me ç'të na vijë përdoresh. Ç'kërkohet nga ne?

— Vetëm disa shërbime të vogla, — e mori fjalën përsëri kapiteni gjerman. — Ju duhet të vëzhangoni, ashtu siç keni vepruar gjer më sot, çdo lëvizje që ndodh rrëth e rrötull dhe do të na njoftoni me ndonjë njeri të sigurtë, kudo që të jemi. A keni ndonjë të tillë?

— Po. Kam një shërbëtor personal, zoti kapiten. Është njeri pa njeri, si u themi ne atyre që janë fillikat i vetëm në këtë botë. Nuk është bukëshkelur si të tjerët, që janë gati të më hanë të gjallë, po t'u bie në dorë. Më është besnik gjer në vdekje, se është rritur me bukën time.

— Fort mirë. Thirreni ta shohim, duhet të njihemi me të.

Halim beu doli në divanhane dhe thirri sa i hëngri zëri:

— Maliq!

Në derë u duk një djalë i ri, i shëndoshë, me trup të lidhur e me pamje shumë të qetë.

— Më thirrët gjë, bej?

— Po. Eja, biri im, eja e njihu me miqtë. Ata kanë nevojë të madhe për ty dhe kanë ardhur posaçërisht për këtë.

Maliqi kapërceu pragun.

Gjermani e pa.

— I mirë, — tha duke buzëqeshur lehtë, — veç i duhet parë puna.

— Nga puna më pyet mua, — u hodh menjëherë Halim beu. — E kam besnik të provuar. Ç't'i ngarkosh, e bën në çast, pa një pa dy.

— Urdhéroni, — tha Maliqi, duke mos ua shqitur sytë mysafirëve të nderuar të Halim beut.

Pikërisht në këtë çast u ndien krismat e para. Saliko hanëm i u ngrit rrëmbimthi dhe bëri një hap për nga dera.

— Qyqja, — tha dhe u pre e tëra. — Ç'të jenë këto pushkë?!

— Partizanët bej!, — u dha në derë gati pa frymë fare qehajai i Halim beut. — Kanë pllakosur partizanët. Na preu e zeza, bej!

Kapiteni gjerman kishte zënë vend pranë pezulit të drifores. Me ta dëgjuar qehajanë, u kthye vringthi nga ai e:

— Mos përhapni panik!, — thirri dhe zbrazi gjithë karikatorin e parabelit që shtrëngonte fort në dorë. — Të gjithë nëpër vende, zotërinj! Asnjë panik! Ruani gjakftohtësinë!

Kamber beu ishte bërë dyllë i verdhë. Halim beut i dridheshin gjunjët, Saliko hanëmi ishte mbështetur në supin e Malikit dhe pëshpëriste:

— Allah, allah!

Aty pranë plasën radhazi ca bomba. Zjarri i armëve sa vinte e dendësohej. Kapiteni gjerman u hodh në prag të derës.

— Në sulm, zotërinj, — thirri dhe çau përpara, — në sulm! Përpara!

— Allah!, — thirri përsëri Saliko hanëmi. — Bëji derman kokës, Halim bej, se na mbylle derën!

Të dy bejlerët s'dinin ç'të bënин.

— Na bëj derman Maliq, bir, — i tha Halim beu shërbëtorit të tij, — në dorën tënde dhe të allahut jemi!

— Na ndihmo, — e luti Kamber beu, që ishte bërë meit fare. — Na ndihmo, pa do të ta shpërblejmë. E mira lan të mirën, bir...

— Të mos humbasim kohë, bej, — tha Maliqi i vendosur dhe iu drejtua Saliko hanëmit: — Sill një palë çitjane, Saliko hanëm dhe jepja shpejt t'i veshë Kamber beu, shpejt, sa nuk kanë ardhur këtu e të na zënë të gjallë.

— Po unë?, — pyeti Halim beu duke u dridhur, ndërsa Saliko hanëmi sillte çitjanet dhe me to vishej Kamber beu, i cili hodhi në kokë shallin e madh e u mbështoll me të si ndonjë plakë e moçme. — Po unë ç'të bëj, more Maliq?

— Hidhu në pus, bej, në pusin e thatë që kemi në postrehë dhe unë do ta mbuloj grykën me driza. Pa, kur të erret vij e të nxjerr.

— Po unë ç'të bëj?, — pyeste Kamber beu i veshur me çitjanet e Saliko hanëmit e dridhej si ndonjë pulë e lagur. — Ku të mbytem kështu? Edhe unë në pus të hidhem?

— Në pus bej, në pus hidhu edhe zotrote, — e këshilloi Maliqi dhe u priu përpara. Pas e ndiqnin të dy bejlerët dhe Saliko hanëmi e tmerruar.

— Kiji kujdes Maliq, kiji kujdes.

— Mos u bëj merak, Saliko hanëm. Mos u bëj merak zotrote, se i rregulloj unë këta.

Lufta ishte ndezur keq. Plumbat fërshëllenin. Maliqi i fshehu në pus të dy bejlerët.

Pas ndonjë ore krismat erdhën duke u rralluuar dhe në oborrin e konakëve të Halim beut

filluan të mblidheshin partizanë e popull bashkë. Dy partizanë sollën të lidhur kapitenin gjerman, i cili pa të rrinte përkrah komisarit të batalionit partizan atë shërbëtorin besnik të Halim beut, njeriun që do të shërbente si ndërlidhës. Gjermani çakarriste sytë dhe Maliqi, sikur ta kishte kuptuar se q'mendonte, i foli:

— Mos u çudit, zotni kapiten, se ne e kemi zakon që të zëmë deshë me këmborë, pa deshë radhë zë sa të duash. Dale, pa do të shohësh, — dhe së bashku me një grup partizanësh u drejtua për nga gryka e pusit. — Dil bej!, — thirri që lart. — Dilni, se partizanët ikën.

Në grykën e pusit u duk një kokë burri. Pastaj u duk edhe një kokë «gruaje» dhe Halim beu me Kamber beun e panë veten pranë gjermanit, që i vështronë me përcëmim.

«I VRARI U ZU. GUXIMTARET IKEN.»

Serxhente Maxala, një alamet shufre e gjatësi vuzhdagë shkoze, mbahej si më i rëndi midis gjithë trimave të komandës së karabinierisë. Nuk dihej mirë se si e qysh kishte arritur gjer në atë shkallë, por thoshin se shkak ishin bërë mustaqet e tij tel, si mustaqe maçoku, që u kallnin datën të tjerëve si dhe këmbët e tij, sepse, sipas atyre që e kishin parë kur merrte vrapin, nuk kishte burrë që ta arrinte, se bëhej erë fare! Po edhe këto mbeteshin vetëm fjalë, sepse kishte disa të tjerë, që vërtetonin me dëshmitarë okularë se, atje ku luftonte serxhente Maxala, gjaku vente gjer në «shalë të kalit», ndaj dhe bashkëluftëtarët e tij e kishin për mburrje të thoshin: «Gjer te serxhente Maxala dhe kthehu prapa, në do që ta shpëtosh lëkurën tënde».

Shkurt, fjalët ishin nga më të ndryshmet dhe të gjitha përmblidheshin në një të vetme: «Trim mbi trimat i pari është serxhente Maxala, prandaj, aty ku komanda e karabinierisë e kishte mëpisk, dërgonte Maxalën, i cili sillte vazhdimisht «lajme nga më të rejt».

E gjithë kjo kurorë lavdie që e rrighthonte e kishte bërë punën e saj, sepse edhe atij vetë i qe mbushur mendja e i qe bërë top se ishte i vetmi trim mbi trimat në të gjithë ordhинë e Duçes dhe se pa të, komanda e karabinierisë nuk vlente asnjë grosh dhe nuk ia dilte dot në krye asnë pune, sado e lehtë që të qe. Vetëmburrja ia kishte rritur ca vlerën dhe ai kishte filluar të mbahej më të lartë e t'i shihte të tjerët me përcnim. Serxhente nga grada, por nga puna e kishte kaluar gradën e majorit dhe këtë nuk e shihte të nevojshtme ta mbante fshehur. Me miqtë e vet të gotës përsërise orë e pa kohë: «Punën e bëj pér kardinal, por paranë e marr pér frat».

Ta merr mendja, pas kësaj fraze ai fshihte lakinë e tij, por ata që i kridhnin bishtin, ia têrhiq-nin edhe ca më tej.

— S'prish punë. Edhe frati bëhet kardinal, — i thoshin, dhe serxhentja fryhej si krimb plehu, tek èndërronte se si mund t'i ngjiste shkallët e hierar-kisë e mund të vihej në një radhë me ata që afronin në radhë.

Kjo shpresë e ngrohte shumë serxhente Maxalën, se ata që e fërkonin ashtu nuk ishin vetëm njerëz të sërës së tij por edhe eprorët dhe, kur flet eprori, ta merr mendja që ai çoç di, çoç ka dëgjuar, se i madhi me të mëdhenjtë rri dhe vetëm fjälë të mëdha dëgjon, por fjala e të madhit dëgjohet si nga të mëdhenjtë ashtu edhe nga të vegjlit.

Serxhente Maxalën e shihte me admirim edhe vetë prifti, i cili nuk ia kursente buzëqeshjet dhe hera-herës i dërgonte nga një plloskë me verë e nga një meshë të ngrohtë. Kjo e çudiste ca njerëzinë, se

si bënte vaki që prifti ta kishte gjetur fjalën me serxhenten; mirëpo ata më të zgjuarit ua bënë këtë gjë të shkoqur e thanë se edhe prifti, si veqil i perrëndisë në tokë, edhe serxhentja, si veqil i mbretit, punonin për të njëjtin qëllim, për të mbajtur në zap njerëzinë që të mos ngrivej kundra perëndisë dhe mbretërisë.

Një natë serxhente Maxalën e thirrën në shtëpinë e komandantit të karabinierisë, i cili po jep te një «suare» për nder të përfundimit të operacionit ndëshkimor kundër çetave partizane të zonës, që u myll duke i lënë partizanët maleve, të «vdisnin nga uria».

Zonjat italiane hargaliseshin. Serxhente Maxala ishte futur në mes tyre dhe tregonte tërë mburreje:

«... Kjo ndodhi para disa ditësh, më të ngrysur të ditës. Unë kthehesha nga një shërbim tepër urgjent dhe tepër sekret, kur ç'të shoh? U gjenda ballë për ballë me dy 'partizanë. Ishin ulur në një shesh dhe ia kishin shtruar kuvendit me një grup fshtarësh.

— Ç'bëni aty, more, — u thashë dhe mbajta këmbët, — propagandë komuniste bëni, ë?

— Po, — ma ktheu njëri nga ata, një harbut që nuk e kisha parë ndonjëherë këtyre anëve. — Eja ta dëgjosh edhe ti, more lumë e përrua, — dhe këputi edhe ca fjalë të tjera, që nuk është mirë t'i përmend këtu përpara zotërisë suaj.

— Unë nuk u tunda nga vendi, nuk hodha asnjë hap drejt tyre dhe as që ma bëri syri tërr fare, po ua ktheva flakë për flakë:

— Ashtu? Atëherë po jua tregoj unë atë pro-



pagandën tuaj, — dhe fët ia bëra automatikut. Ata, me ta parë gjithë atë alamet gryke, u ngritën dhe ia mbathën nga sytë këmbët, po unë nuk i lashë

pa ndëshkuar. Me dy të shtëna automatiku vrava tre vetë, ndërsa fshatarët e tjerë u dorëzuan, mëropo mua më erdhi keq dhe i lashë të lirë. «Io sonno serxhente Maxala,¹⁾ u thashë, dilni edhe një herë sheshit përpara meje dhe keni për të parë.»

Njëra nga zonjushet italiane duartrokiti, një tjetër iu hodh në qafë dhe i pëshpëriti diçka në vesh. Ndërkohë, në derë u dha një karabinier me një radiogram në dorë, që zotëria e tij maxhiore Rafaeli e mori menjëherë, e levoi dhe u pre në fytyrë, ndërsa duart zunë t'i dridheshin.

— Ç'ka ndodhur, zoti Major?, — pyetën përnjëherësh disa zëra.

— Zotërinj!, — tha me zë të mbytur. — Kanë vrarë zotin kuestor, zotin Xhino Rikardo. E kanë vrarë partizanët në Gjinovec.

Të pranishmit shtangën. U bë një rrëmuje e madhe. Nje zonje italiane i ra të fikët. Kjo ishte mikesha e zotit Rikardo, që, sa herë i ikte e shoqja për verim, shkonte e i qante hallin për vetminë e tij të madhe dhe mundohej me ç't'i vinte për t'i mbushur boshllékun e krijuar. Një tjetër u shemb në kolktuk dhe foli me gjysmë zëri: «Një kafe, ju lutem, një kafe të rëndë, se po më pushon zemra. E kishim mik të ngushtë të familjes!

Major Rafaeli e mbledhi veten i pari dhe u mundua të vendoste qetësinë.

— Asgjë, zonja dhe zotërinj, asgjë. Do të marrim menjëherë masat më të rrepta, që na japin mundësitë dhe kompetencat. I partigiani²⁾ duhet ta

1) Unë jam rreshter Maxala.

2) Partizanët.

dinë se ne kemi forca të tillë që mund të bëjnë zap jo vetëm ata, por edhe mijëra të tjera.

Dhe si u hodhi një vështrim të pranishmëve, qëndroi sytë te serxhente Maxala, që ishte bërë gjithë sy e veshë.

— Serxhente, — urdhëroi me tonin e tij të pre-rë. — Serxhente Maxala!

— Komandi sinjor maxhore¹⁾, — u përgjigj ky dhe bëri një hap të vendosur përpara, — sipas urdhrit tuaj, i gatshëm për të shërbyer ku të urdhëroni!

Komandanti i karabinierisë u hodhi përsëri një vështrim të pranishmëve, që qëndronin si të ngrirë dhe me të deshi t'u thoshte: «E shihni? Të tillë trima kam unë, të tillë burra, që e hanë barutin me dhëmbë». Dhe vazhdoi me po atë ton:

— Merr një togë karabinierësh dhe nisu urgjent për në Gjinovec. Të urdhëroj të kapësh të gjithë ata që guxuan e vranë kuestorin tonë të nderuar, fashistin e orëve të para, more vesh?

— Si, sinjor maxhore,²⁾ — u përgjigj serxhentja, pa lëvizur nga qëndrimi i tij gatit!

— Posa të arrini në Gjinovec dhe, me të arrestuar ata që guxuan të kryenin një akt të tillë terrorist, të më dërgoni një radiogram urgjent.

— Si, sinjor maxhore, — u përgjigj përsëri serxhente Maxala.

— Dhe tani, nisu!, — urdhëroi komandanti i karabinierisë.

Serxhente Maxala rrrotulloi takat, u' dha një të tundur mustaqeve, futi mirë kokën midis supe-

1) Urdhëroni zoti major.

2) Si urdhëron, zoti major.

ve dhe u gjend jashtë derës. Të pranishmit, në «suare» dalngadalë filluan ta merrnin veten. Dikush foli tërë mburrje:

— Trim i madh ky serxhentja!

— Tërr nuk ia bën syri!

— Di sinjor Rafaeli c'njerez mban rreth vetes, — u hodh një i tretë, për t'i bërë qejfin të zotit të konakut. — Prite kur t'i zërë e t'i bëjë zap harbutët.

— More, zëre sikur i ka zënë të gjithë, u ka shkuar prangat e i ka vënë përpala si dhentë në shtrungë...

— Lëre, lëre pastaj kur t'i sjellë këtu! Një qytet të tërë ka për të çuditur. Serxhente është vërtet, po...

— Atëherë, ai do të marrë gradën e sottotenentit¹), — tha me mburrje major Rafaeli, — dhe do ta emëroj komandant poste. Më vjen keq ta heq nga vetja, po s'kam ç'bëj.

Fjalët erdhën e u bënë mullar e sikush donte të thoshte mendimin e tij për serxhente Maxalën, për aftësitë dhe të ardhmen e tij të «ndritur» që e priste.

Kishin kaluar nja dy orë që atëherë dhe zonjat e zotérinjtë e nderuar, të dehur nga vera dhe fjalët, as që e kishin vënë re këtë. Ndërkohë, komandanti i karabinierisë vazhdonte ligjëratën e tij:

— Me t'i sjellë këtu, guximtarët do t'i shkoj në litar. Po, po, në litar do t'i shkoj. Haku i shumë të çmueshmit kuestor duhet, marrë pesë për

1) Nëntogerit.

një. Terror zotérinj! Me terror duhen nënshtruar tē panënshtuarit!

— Në mos u marrtë shpirtin vetë serxhentja, pa i sjellë mirë këtu, — u hodh e foli një, që s'përmabahej dot tek shihte forcën e perandorisë, shprehur në fjalët e tē nderuarit major.

— Si? T'i vrasë? E pamundur!

— Me serxhente Maxalén çdo gjë është e mundur.

— Ai i ka tē rrallë shokët.

— Me tē fjalët janë tē pakta.

— Ai me siguri do t'i vrasë, dhe mirë t'uabëjë.

— Le t'i vrasë. Po, po. Në këtë çast që ne bisedojmë, ai i ka vrarë, dhe fort mirë ka bërë që i ka vrarë.

— I lumtë!

— Bravo!

— Hallall i qoftë grada e nëntogerit!

— Ç'të na i sjellë këtu, apo që tē na hapëte-lashe.

— Bëri mirë që i vau.

— Hë, më i lumtë ajo dorë!

— E viva il serxhente Maxala!¹⁾ — thirri njëra nga zonjat italiane.

— E viva il sottotente Maxala!²⁾ — e korrigjoi atë çast majori, që fliste me ton tē thellë oratorik.

Shpërthyen duartrokitjet. U ngrit edhe dollia, por mbeti pa u pirë se përsëri në derë u duk një karabinier.

1) Rroftë rreshter Maxala!

2) Rroftë nëntoger Maxala!

— Një radiogram, zoti major, — tha. — E dërgojnë nga Gjinoveci.

Të gjithë lanë gotat dhe prisnin me ankth. Komandanti i karabinierisë mori radiogramin, e çeli, vuri syzet, rregulloi këmishën, e, tërë pompozitet, filloi të lexonte: «Komandës së karabinierisë, — buzëqeshi dhe i vështroi të gjithë me radhë. Pastaj lexoi më poshtë: — I vrari u zu dhe është në duar të sigurta. Guximtarët u larguan pa lënë gjurmë. Firmosur: Serxhente Maxala.»

Major Rafaelit i ranë gjyslykët. Gjaku i kërceu në fytyrë dhe rrembat erdhën e iu frysë në çast. Nuk u përbajt dot dhe shfreu tërë duf: «Idioti! Unë e dërgova të zinte guximtarët, ndërsa ai më kap të vrarin. Do ta degradoj. Karabinier fare do ta bëj dhe do ta syrgjynos në postkomandën më të largët, që ta hanë qentë. Ai nuk ka pér t'u graduar kurrë! Ai është turpi i perandorisë!» — Dhe u shëmb përdhe i mbytur në djersë. Po as profecia e kërcënimini i ri i major Rafaelit nuk pinë ujë, sepse serxhente Maxala nuk u kthye as atë natë, as nëtët e tjera. Thoshin se e zuri mallkimi i major Rafaelit dhe e hëngrën... jo qentë po ujqit, në një përrua, kù mbeti i vrarë.

MILICËT VRAP E GOMARI VRAP!

Dita ishte më të thyer, kur në lëndinat e staneve u dukën dy ballistë që shoqëronin një grup fshatarësh.

— Lëvizi këmbët ti aty, — iu drejtua njëri nga milicët, një fshatari veshur me një palë shallvare tërë arna, ku edhe qeni nuk kishte ç'të të zhvaste, — lëvizi këmbët, se do na zërë nata këtej e pastaj t'i përshesha trutë!

Fshatari as që e dëgjonte. Ai ecte me hap të qetë, ashtu si dhe shokët e tij. Përpiquej të rikujtonte gjithçka kishte ngjarë:

«... Në fshat, papritur e papandehur kishin plakosur milicët e, si qentë në kërmë, ishin lëshuar shtëpive tërë rrëmujë, ishin shtruar me të ngrënë e me të pirë. Pasdite, komandanti i tyre, një kriminel i regjur, që njihej mirë nga të gjithë, se tri herë që futur në burg për hajdutllék dhe herën e fundit, pasi kishte dalë nga burgu, kishte shkuar drejt e në zyrat e milicës dhe kishte marrë në dorë komandën e «batalionit», dha urdhër: «Të mblidhen burrat e fshatit dhe të dërgohen të gjithë në Selishtë, ku i pret Sali beu së bashku me italianët

për ta prerë shkurt fjalën: O me ne, o me Partinë. Me ne, makarona e oriz plot. Duçja siguron edhe kuti mishi, paçka nëse ka ca llafazanë që kanë përhapur fjalë se ato na qenkan me mish gomari. Ato janë gjepura. Sali beu është gati t'jua provojë të gjithëve se mishi i kotoletave ia kalon edhe brinjës së qengjit të pjekur. Kush kalon në anën e Partisë, do të kalojë në rripin e dyfekut dhe një-qind vuzhdaga shkoze një do t'i numërohen, pa llogaritur pastaj se Italia do t'ju fusë flakën që në fund e gjer në krye».

Milicët, me të marrë urdhrin, vunë përpara burrat, gjithë gjithë katër vetë, se të tjerët, me të marrë vesh ardhjen e tyre, iu ngjitën malit përpjetë. Si i lidhën të katër burrat njërin pas tjetrit, i nxorrën përpara komandantit, i cili përsëri urdhëroi: «Ti nisni për në Selishtë, të shoqëruar me dy trima. Milicët e tjerë të shpërndahen nëpër baza. Sonte do të gdihemi këtu, Kaq».

Trimat kishin vënë përpara fshatarët, tre pleq e ai shallvaregrisuri katër, pak më i ri se të tjerët. Si kapërcyen udhët e fshatit, bënë përpjetë, dolën në lëndinat e stanit ku çunat e fshatit kullosnin bagëtinë».

Kaq i kujtohej, kur njëri nga milicët, ai kuqalashi me fytyrë të çukitur nga lia e me sy tërë rremba gjaku, iu afrua e i dha një të shtyrë me kondak të pushkës.

— Luaji këmbët, or zgjebarak! Mos kérkon të ngrysemi këtej? Hë!

Dhe e shtyu sérishmi. Tjetri, një stërholl, i që i hidhte hapat si lejlek, e nxiti edhe ca shokun e vet:

— Ngopja një qenit, se na rreku në të ecur.

Fshatari vështroi shokët dhe në sytë e tyre lexoi atë zemërim që i vlonë edhe atij në shpirt.

— Nuk ecën burri lidhur, aq fuqi kemi, aq po ecim, — i tha milicit.

Kuqoja, i çukitur nga lia, u corr.

— Mbylle, more i paudhë, mbylle, se ta nxora shpirtin!

Fshatarët vazhdonin ecjen me hapin e tyre të qetë. Përkrah ecnin trimat e milicisë që herë pas here qëronin udhën me vështrimin e tyre.

Poshtë, aty ku lëndina thyhej pak e zbriste si pjerrët gjer në një shtrat përroi të gjerë, për të bërë pastaj këmbë sërishtmi përpjetë, qëndronin dy barinj të vegjël, që ndiqnin me kujdes lëvizjen e grupit të vogël.

— I sheh? Milicët!, — tha ai më i vogli, një topolak, që kishte mbathur një palë opinga llastiku dy herë më të mëdha se këmba e vet.

— Nuk qenkan vetëm, — plotësoi shoku i tij, që mbante hedhur krahëve trastën e bukës ku kishte vënë edhe abetaren. — Paskan vënë përpara pleqtë.

— I paskan lidhur, — tha përsëri topolaku. — Përse vallë?

— I kanë arrestuar!

— Të poshtrit!

Të dy fëmijët e kishin mbërthyer vështrimin te grupi i vogël që lëvizte drejt tyre.

— Ku do t'i cojnë?, — e theu heshtjen topolaku. — Po sikur t'i pushkatojnë?

— E përse t'i pushkatojnë?

— Përse quditesh? Milicë janë, armiq!

Tjetri e vështroi drejt në sy.

— Vërtet. Po sikur t'i pushkatojnë?, — përsë-

riti pyetjen e bërë nga shoku i vet. — Ne nuk duhet t'i lejojmë.

— Më mirë të vdesim! Ç'do të thotë fshati për ne? Ç'do të thonë partizanët kur ta marrin vesh?

Koha nuk priste. Grupi sa vinte e afrohej pranë tyre. Ata morën vendim në çast.

— Shpejt, — tha topolaku, — shpejt. Të vëmë bagëtinë përpëra e t'i shtyjmë drejt tyre dhe t'ia ndezim vrapi. Me të na parë, ata janë të mençur vetë, pastaj.

Dhe ngritën çomaget.

— Y...! Ej, ej... Hë, hë..., — u dëgjuan britmat e tyre, që vinin nga shtrati i përroit, tej, atje poshtë, ku ishin ca blaca të mëdha, që futeshin thellë në korijen gjithë dushqe. — Yyy... ej, ej... hë, hë...!

Milicët qëndruan. Qëndruan edhe fshatarët.

— Ç'janë këta që bërtasin kështu?, — pyeti Kuqoja, i çukitur lie, pa ditur as vetë se kujt ia drejtonte pyetjen, shokut të vet, stërholl e kërcilejlek, apo fshatarëve. — Ç'janë këta që bërtasin kështu?

— Barinjtë e fshatit, — u përgjigj xha Rakipi, njëri nga fshatarët.

— Ca spurdhjeqër do jenë, — nënvizoi kërcilejleku dhe, si u drejtua nga fshatarët, urdhëroi: — Hajde! Lëvizni, se...

Po zërat sa vinin e afroheshin. Pastaj, në krye të lëndinës u duk bagëtia, që rendte sa mundte e ndjekur pas nga dy barinjtë e vegjël të cilët, me çomaget e tyre ngritur përpjetë, vinin pas bagëtisë duke bërtitur:

— Yyy... ej, ej... hë, hë...

Fytyrëçukituri qëndroi.

— Ej, ju atje, — thirri, — pa ejani këtu!

— Aha!, — ia ktheu topolaku, — nuk kemi kohë, jo.

— Ejani këtu more, se jua zbraza zorrët!, — kërcënoi kërcilejleku dhe lëvizi shulin e pushkës.

— Ç'thërrisni ashtu, si të çmendur dhe vraponi sikur keni djallin nga pas?

— Djallin jo, — ia ktheu aty për aty djali me abetare, — po partizanët.

Kërcilejleku e hodhi vështrimin nga fytyréçukituri. Ky nga ana e tij pyeti edhe një herë dhe ndjeu një të therur të fortë në zemër.

— More, more... Ç'thua kështu, more spurdhjak? Çfarë partizanësh?

— Partizanët, zoti komandant, — ia priti menjëherë topolaku, duke ia rritur vlerën milicit. — Dolën që atje poshtë blacës, në korije.

— Te shtegu?

— Si urdhëron!

— Ishin shumë?

— Shumë. Po bëjnë këtej përpjetë duke nxittuar.

Kërcilejleku nuk u përbajt.

— Kthehem, — i tha shokut, por tashmë ishte tepër vonë. Fytyréçukituri i kishte kthyer krahët më përpara e ia kishte marrë vravit.

— Po këta?, — i thirri nga pas kërcilejleku, që po e arrinte me atë vrapin e tij si të langoit, dhe i tregoi me dorë fshatarët e arrestuar.

— Kallu ferrën, — u përgjigj trimi i çukitur nga lia. — Nuk e sheh që po na zënë të gjallë?

— Po komandantit ç't'i themi?

— I themi që na sulmuancë partizanët.

Të dy vraponin. Pas i ndiqnin bagëtia dhe gomari i topolakut që, pasi kishte ngrënë një grusht

miza kali nën bark, pëlliste sa mundte e nuk e ndalte vrapin.

— Milicët vrap e gomari vrap. Kur hynë në fshat, dielli ende nuk ishte varur përtej ullishtave. Të dy e mbajtën frymën drejt e te komandanti, që kapardisej me gotën e rakisë përpara.

— Partizanët, partizanët!, — thërrisin të dy trimat. — Erdhën, na zunë të gjallë! Këmbë, shpëtoni kokën!

Komandanti brofi në këmbë.

— Ku?, — pyeti. — I patë ju?

— I pamë, — flisnin të dy radhë e pa radhë, duke iu marrë fryma. — Janë shumë. Na sulmuani. Ne, një zot e di se si shpëtuam! I bëni derman kokës, zoti komandant!

Ai hodhi pushkën në krah dhe doli në oborr.

— Pelën, — thirri sa mundi. — Pelën shpejt!

Dhe iu hodh asaj pa pritur t'i sillnin shalën.

— Në Selishtë, — urdhëroi, — I bini këtej, nga shtrati i lumbit...

Dhe u derdh poshtë fshatit, i ndjekur nga batalioni.

Lart, në krye të fshatit, gomari pëlliste fort.

Tej, në lëndinë, të dy fëmijët, iu afroan bashkëfshatarëve të tyre, u zgjidhën litarin dhe iu hodhën në qafë.

— Ju lumtë, trima!, — u tha xha Rakipi. — Ju jeni treguar me të vërtetë të zgjuar!

TRIBUNA DHE MIZA E KALIT

Kanë ndodhur shumë ngjarje në fshatin tonë, por ajo që nuk harrohet edhe sot e kësaj dite, ndodhi atëherë kur në fshat pllakosën fashistët, që kishin ndërmarrë një operacion të gjerë kundër partizanëve të zonës sonë.

Tërë mëngjesin, grykat e përrenjve oshëtinë nga krismat e armëve. Luftonin partizanët. Ata i kishin zënë të gjitha shtigjet që të çonin në fshatrat e nuk shkuleshin që andej. Fashistët, që e kishin nisur sulmin pa feksur mirë dita, ishin tërbuar fare ngaqë nuk po hidhnin asnje hap përparrë dhe urdhëruan artilerinë të qëllonte pa pushim. Topat rriniqin faqet e kodrave. Gjylet binin mbi pozicionet partizane, po ata qëndronin aty ngjitur pas shkëmbinjve si binjakë të tyre. Vetëm më të thyer të drekës, partizanët morën urdhër të tertiqeshin drejt malit dhe aty nga pasditja, fashistët hynë në fshat, të lodhur e të rraskapitur.

I pari i tyre, një oficer madhor shtatlartë, me një palë mustaqe të prera hollë mbi buzët e tij të holla si teh brisku, me ca sy të vegjël të shpë-

larë si zalli i pérroit e me mollëzat e faqeve që i kërcenin pérpjjetë, dha urdhër të prerë:

— Të mblidhet i gjithë fshati. Të mblidhen aty te sheshi, të mëdhenj e të vegjël qofshin. Të mblidhen të gjithë, burra e gra, ç'të gjenden e ku të gjenden e të sillen këtu, pérpara meje! Ose ky pull do t'i nënshtrohet perandorisë fashiste, ose unë do t'i djeg, do t'i bëj të gjithë shkrumb e hi.

Fashistët u shpërndanë shtëpi më shtëpi, nxoren fshatarët duke i shtyrë me kondakët e pushkëve, i vunë pérpara e i sollën drejt e në shesh të fshatit.

— Një tribunë, shpejt një tribunë, — urdhëroi sérishmi oficeri fashist. — Unë nuk mund të flas më këta njerëz nga e njëjta radhë. Unë duhet të qëndroj lart e ata duhet të vështrojnë që po-shtë. Kështu ka pér të qenë tërë jetën. Një rregull i tillë nuk mund të prishet kurrë. Ne lart e ata poshtë. Ky është vullneti i atij që sundon. Këta duhet ta kuuptojnë mirë këtë. Kështu ka pér të qenë tërë jetën, — u foli ai oficerëve të vet.

Kryeplaku po rrinte si i shastisur. Një tradhtar, që ishte së bashku me fashistët dhe u shërbente si përkthyes, e tundi pér supesh.

— Hë de, ç'pret, mos kërkon zotrote që urdhri të përsëritet dy herë??!

— Ore, më mjafton vetëm një herë, — dridhej kryeplaku, — po ç'të bëj? Si ta ndërtojmë atë tribunë që kërkon zotëria e tij?

— Ti je kryeplak. Zoti major kërkon të hipë në një tribunë dhe ti duhet të ndërtosh në çast një tribunë të tillë, ndryshe i lan edhe ti gjynahet e tua, more vesh?

Kryeplakut i shkrepit një mendim, nga ato që

rrallë vijnë në çaste të tilla, por që i japid problemit një zgjidhje ideale.

— Po sikur të mbrehim një qerre, ta sjellim këtu dhe zotëria e tij majori të hipë lart në qerre e të flasë që andej? S'prish punë në është qerre, ë? Ai lart e lart do të jetë e ne poshtë e poshtë do të jemi, ja këtu, nën këmbët e tij, ë? Pa pyete njëherë se, s'dihet, mbështetëse na e pranon.

Përkthyesi se çi tha oficerit në gjuhë të tij dhe ky, si u mendua një çast, ia shkrepitë qeshurit me të madhe.

— Shumë mirë, shumë mirë, — përsëiste duke qeshur. — Le ta sjellin qerren, ajo do të jetë një tribunë me të vërtetë origjinale. Kur të kthehem në Itali, do t'ua kallëzoj të gjithëve. Ky do të jetë me të vërtetë një kujtim i bukur nga këto vende të egra.

Kryeplaku nuk u përbajt më. Nuk priti që të njëjtin urdhër t'ia përsërisnin dy herë, mori vrapiçin poshtë, për te konakët e agait dhe pas pak u duk të vinte duke hequr qetë që tërhiqnin pas qerrën.

Kur erdhi në mes të sheshit, e vuri qerren në një mënyrë të tillë, që njëra rrotë u mbështet pas rravit të madh. Qetë qëndruan. Tribuna ishte gati. Oficeri fashist e vështroi atë, i erdhi një herë rreth e qark e pastaj, pasi u mbajt nga rravicat, kapërcuar duke ftuar pas vetes përkthyesin, aganë e fshatit, kryeplakun dhe dy oficerë të tjera, që u ngjeshën fort njëri pas tjetrit.

Fshatarët i vështronin tërë urrejtje, po me zor e përmbanin edhe të qeshurën, tek i shihnin ar- miqtë hipur ashtu, në qerre, tek bëheshin gati për t'u mbajtur fjajm. Kishin parë shumë fshatarët.

Kishin parë e dëgjuar shumë, gjer atë ditë, por, oficer hipur majë qerres, për të folur që andej, as që kishin parë e as që kishin dëgjuar. Ja, ky fashisti e bëri këtë dhe ata nuk do ta harronin kurë se si kapardisej ai majë qerres e se si që andej zuri të fliste me zë të lartë e të çjerrë si zë zhabe, ndërsa ai tradhtari, që i ngjitej pas si bajgë, filloi të përkthente një e për një fjalët e tij.

— Fshatarë, — ulërinte fashisti. — Ushtritë tonë fitimtare kanë ndërmarrë një operacion të gjerë kundër partizanëve. Ne do t'i shuajmë ata kudo që të jenë. Ne do t'i vrasim të gjithë ata që do të strehojnë partizanët. Ne do të djegim të gjitha fshatrat që do të lidhen me partizanët. Ne...

Fshatarët dëgjonin. Dëgjonin burrat edhe grata që u ndodhën aty e që s'kishin mundur të largoheshin së bashku me partizanët drejt maleve. Dëgjonin pleqtë, që sillnin në kujtesën e tyre sa e sa pushtues dhe fundin që i kishte pritur të gjithë. Dëgjonin edhe fëmijët e në kujtesën e tyre përpinqeshin të vizatonin me ngjyrat më të forta fytyrën e këtij fashisti, që ishte dyndur gjer këtyre anëve me hordhitë e tij, për t'u djegur shtëpitë, për t'u vrarë prindërit, véllezërit, motrat. Dëgjonin edhe Shpëtimi me Liken, dy shokë të ngushtë, të cilët, sa herë vinin partizanët në fshat, qëndronin tok me ta e, kur e donte puna, u çonin bukë dhe lajme në mal.

— I poshtri, — i foli Shpëtimi në vesh shokut të tij. — Dëgjoje si flet. Pa shiko si qëndron ngrehur majë qerres, derri!

— E di unë ç'do ai, — u përgjigj me zë të ulët Likja dhe sytë nuk i shqiste nga fashistët që trimëroheshin mbi qerre. — Ata duan t'u futësh

një zegal qeve dhe e shikon ai pastaj se ku i vete kapadaillëku.

— Zegal?

Të dyve u shndriti fytýra.

— Sa mirë u kujtove. Po ku ta gjejmë tani një zégal, se?

— Gjejmë një mizë kali, — pëshpëriti Likja.

— Njëlloj e bëjnë punën, si zegali si miza e kalit.

— Oho!

Të dy e hodhën vështrimin pérreth. Pranë tyre, në një hu, fashistët kishin lidhur pelën e oficerit, një pelë të bardhë, të hazdisur, që shfrynte pa pushim.

— Shpëtimi u ngrit nga vendi. Pas tij u ngrit edhe Likja dhe duke fërkuar për së gjati pelën, shpuri dorën nën bark të saj dhe zuri ca miza që nisën të lëviznin, por ai e mylli shpejt grushtin. Kryeplaku i vuri re tek po afroheshin, po duke mos dashur të ndërpriste fjalën e oficerit të Duçes, i kërcënoi të dy fëmijët me gisht. Ata, duke bërë me shenjë nga pela e oficerit e duke u hequr se s'po kuptonin ç'thoshte kryeplaku, u ulën afër qerres nga ana e qeve dhe u zgjatën në drejtim të kryeplakut.

— Urdhërove gjë zotrote?, — e pyeti Shpëtimi.

— Heshtni, mistrecë!, — i kërcënoi kryeplaku me zë të ulët. — Nuk e dëgjoni se kush po flet? Uluni aty dhe mbani vesh!

— Si urdhëron, zoti kryeplak, si urdhëron, — shpejtoi të përgjigjej Likja. Po ulemi. — Dhe të dy u ulën pranë rravit, afër qeve.

Oficeri fashist vazhdonte të fliste:

— Mjerë ai që do të diktohet se ka lidhje

me partizanët! Fashizmi do të jetë i pamëshirshëm me të gjithë!

Likja vështroi Shpëtimin. Ai i shkeli syrin. Likja e kuptoi, zgjati dorën nën bark të kaut dhe i hapi gishtat. Mizat e kalit u ngjitën pas barkut të kaut. Ishte një ka kuqalash, me ca brirë të mëdhenj, që i ndriste qimja. Kau u drodh. U drodh edhe qerrja. Ata që ishin mbi qerre mezi mundën të kapeshin pas rrapicave për të mos humbur drejt-peshimin. Oficeri fashist i hodhi një vështrim të egër qehajit, që rrinte përpara qeve, me hostenin ngritur përpjetë dhe vazhdoi:

— Ne nuk do të durojmë më që partizanët të na prishin qetësinë. Ata që nuk do të bashkohen me ne, do të jenë armiqtë tanë dhe për armiqtë e tij fashizmi nuk do të ketë mëshirë. Me zjarr dhe me hekur do t'ju nënshtrojmë, po qe se ju do hidhni shqelma...

Miza e kalit i këputi një pickatë kaut kuqalash, i cili u hodh pupthi dhe, duke mos pyetur për qehajanë që rrinte përpara zgjedhës me hosten përpjetë, kërceu e çau tatëpjetë duke tërhequr pas vetes kaun tjetër balash dhe qerren. Ata që ishin lart mbi qerre u shembën mbi njëri-tjetrin, ndërsa oficeri fashist, që nuk po i mbante dot ata që i kishin rënë mbi vete, thërriste me sa zë i hante gurmazi:

— Tribuna... Qerrja... Mbani tribunën, të poshtë... Më vratë, oj!

Fshatarët nuk përbaheshin nga të qeshurit. Ndërkohë, Shpëtimi me Liken, rrëshqitën pa u ndier dhe morën udhën poshtë çaireve.

**III. — Nga periudha e pasçlirimit
të Atdheut**

KUR BËJNE DASMË ARINJTE

Një lajmëtar, si ndonjë maratonist i lashtë, vraponte duke gulçuar tatëpjetë brinjave dhe monopateve. Në të hyrë të fshatit, këmbët nuk po i mbanin më dhë. Gati sa nuk fluturonte. Ata që e vështronin, nuk mund t'i thoshin dot asnjë fjalë se ai u zhdukej nga sytë duke lënë pas një lajm të kobshëm:

— U zhdukën, vëllezër, u zhdukën!

Fshati filloi të shqetësohej. Cilët u zhdukën, pse u zhdukën, kur u zhdukën, ku u zhdukën? Dhe grumbuj-grumbuj zbrisnin teposhtë në drejtim të zyrave nga kishte shkuar lajmëtarë.

Ai, me të arritur në prag të zyrës së përgjegjësit të blegtorisë, thirri sa mundi:

— U zhdukën, o shoku Rrapo, u zhdukën të njëzetat. Derëzezat!

Dhe s'foli më, po u përplas shakull përdhe duke marrë frymë me zor. Kafazi i kraharorit i hidhej përpjetë dhe zemra i punonte si ndonjë piston me fasho të llaskuara, që kërkonte të shpërthente jashtë nga cilindri.

Lajmi ra si bombë. Të gjithë sa qenë mble-dhur në atë zyrë kokë më kokë për të shqyrtuar problemin e zogjve harabela që ishin kënditur në grurë dhe po hartonin masat përkatëse për ngritjen e dordolecëve anë e qark arave, u ra boja e dyllit, gjaku u vajti në fund të këmbëve dhe leqet e gjunjëve zunë t'u dridheshin.

Vetëm përgjegjësi i blektorisë, shoku Rrapo, nuk e dha veten. Ai brofi menjëherë në këmbë, iu afrua lajmëtarit, që mbolli gjëmën, e ngriti me terezi, e kapi pastaj për supesh dhe, si e shkundi lehtë e lehtë, e pyeti:

— Cilët u zhdukën?

Po lajmëtarri nuk jepte shenja se do të vinte shpejt në vete. Atëherë shoku Rrapo e shkundi me sa fuqi pati dhe i thirri fort mu në tytë të veshit:

— Kush u zhduk, more i paudhë? Fol, së na bëre për ujë të ftotë!

Lajmëtarri çeli njërin sy, pastaj edhe tjetrin, hodhi një vështrim rrëth e rrötull dhe, kur pa gjithë ata njerëz që ia kishin ngulur vështrimin në beben e syrit, foli me zë të mekur:

— Bletët, o përgjegjës, bletët. Të njëzet kosheret e bletëve na lanë shëndenë!

Kaq tha dhe përsëri heshti.

Po kësaj radhe e solli shpejt e shpejt në vete zëri i Rrapos, që kumboi thellë si ushëtimi e gjëmimeve në honet e thella.

— Raporto qerrata, se nuk e ha Rrapua vetëm me një fjalë.

Lajmëtarri qerrata u ngrit, mori frymë thellë, u mbështet pas murit duke u lëkundur dhe zuri të tregonte me zë të këputur:

— Vij nga mali, shoku Rrapo. A i mban mend bletët e shkreta atje në atë bokërrimë, ku i kishim vendosur me urdhër të kryesisë? Të lanë shëndenë. Nuk i ke më aty. Kaq di unë. Të tjerat ngaji vetë.



Dhe shtriu duart mbi gjunjët, që ende i dri-dheshin nga të vrapuarit.

— Na lanë shëndenë? Domethënë, pftu! —
dhe i fryu pëllëmbës së dorës.

— Ehë!

Përgjegjësi i blegtorisë nuk e humbi torruan. Mblodhi shpejt e shpejt ata që ishin aty, u shpjegoj nga ana e tij (megjithëse ata i kishin dëgjuar të gjitha) rëndësinë e ngjarjes dhe fatkeqësinë që i kishte pllakosur dhe me ta ngriti një shtab luftarak, pér të drejtuar operacionin pér zbulimin e

bletëve të zhdukura. Pastaj e gjeti të udhës të mbante një fjalim të zjarrtë:

— Shokë. Bletët, siç e dëgjuat edhe vetë, na paskan lënë shëndenë. E kush mund ta mendonte këtë? Ne ishim të sigurtë se atje ato do të rriteshin sipas qejfit të tyre, por ja që nuk ishte e thënë kështu. Për të zbuluar të vërtetën, shokë, gjithçka duhet parë në vend. Unë propozoj të shkojmë atje ku ishin bletët.

Të gjithë e miratuan propozimin e përgjegjësit. Madje, njëri, ai që e hiqte veten si mjeshtër në zbulimin e gjurmëve, u ngrit e tha:

— Ashtu duhet bërë, o shoku Rrapo, veçse gjithçka duhet bërë me mend në kokë. Unë them të nisemi që këtë çast dhe të marrim drejtime të ndryshme. Kështu do t'i zbulojmë më mirë gjurmët dhe do të jemi në gjendje të përcaktojmë drejtimin.

— Ashtu qoftë. I bëre konak fjalës, o Mersin vëllai, — i tha Rrapoja dhe të gjithë u ngritën, dolën jashtë dhe u vargosën drejt bokerrimës, sikush në një drejtim të caktuar.

Pas dy orësh, u gjendën atje. Vendi i ngjante një sheshi beteje. Anë e qark shiheshin gjurmë të thella, po këmbë blete nuk dukej. Bashkë me to, ishte zhdukur edhe mjalti.

Shtabi filloi nga puna. U këqyr vendi i ngjaries. U fiksuan gjurmët. U vunë në përdorim lente zmadhuese, metra e mjete të tjera që duheshin për të mbledhur provat materiale. Kur hetimet morën fund, shtabi u sheshua në jeshillëk dhe zuri të hidhët një varg pikëpyetjesh.

— Ta ketë vjedhur njeri gjithë këtë mjaltë?
— Jo more! Po të qe kështu, do të kishte lënë

zgjojet me gjithë bletë, ndërsa këtu gjithçka është rrumbulloSUR dHE ka bëRË këmbë.

— A thua t'i ketë përfshirë rrëKEJA?

— E pamundur. Do të kishte lënë një bletë sa pëR nishan. Pastaj, rrëketë lënë trragë, ndërsa këtu nuk ka as trragë e as ulluk.

— Po sikur t'u ketë rënë ujku?

— Ujku bie ndër dhen e jo ndër bletë. Ç'do t'u hajë bletëve, thumbin?!

Dikush thirri me sa zë pati:

— E qartë. Mjaltin e kanë ngrënë arinjtë. Po, po. Pse çuditeni? Arinjtë e hanë shumë mjaltin. E kam lexuar nëpër përralla unë. Janë me një okë mend arinjtë. E dinë që mjalti ka veti të mëdha shëruese dhe nuk lënë zgërbonjë pa bëdhur. Unë, që i njoh mirë arinjtë, e kam të qartë tanë. Mjaltin e kanë ngrënë ata. Vetëm një gjë nuk po kuptoJ: Ç'ta kenë dashur vallë gjithë këtë mjaltë?

Shtabi u mblodh sërishmi kokë më kokë. Shtrohej pyetja: Ç'ta donin vallë arinjtë gjithë atë mjaltë?!

Njëri, që ditë e natë mendonte si e si t'i lëngosej përgjegjësit, e kapi rastin dhe:

— E gjeta, — tha, si të ishte vetë Kristofori që zbuloi Amerikën. — Arinjtë e kanë marrë mjaltin, se u duhej pëR dasmë.

Të tjerët nuk po e kuptonin. Ai vazhdoi të thurte legjendën e tij:

— Këtu e ca ditë të shkuara, — tha, — arinjtë kishin dasmë. Martonin arushën gunartë me ariun gunëhirtë. Të gjitha harxhet e dasmës ishin bëRË. Mungonte vetëm mjalti. Arinjtë gjuajtës shkuan në pyll, kërkuan zgavëR më zgavëR, po mjaltë nuk

gjetën. Kjo ishte një fatkeqësi e madhe. Si mund të dilte nuse arusha gunartë, pa lyer buzët me mjaltë? Arinjtë shkuan përsëri në pyll dhe kësaj here, nga një bokërrimë aty pranë, u erdhi era e mjaltit. Për këtë zbulim të madh u njoftuan gjithë arinjtë. Gëzimi qe i papërmabjatur. Ditën e dasmës, të gjithë arinjtë u mblodhën te bokërrima dhe u vërsulën mbi zgjojet. Mjalti mori rrëkenë ndërsa bletët, të lemerisura nga gjëma që i gjeti, morën arratinë, pa lënë adresë. Për këtë qëndrim prej frikacaku dhe për largimin e tyre në panik, kryesia e kooperativës i dënoi haptazi bletët duke i çregjistruar nga librat e llogarisë. Me arinjtë kjo kryesi nuk ka asnje punë. Atyre u lumtë. Gjetën shesh dhe bënë përshtesh. Arusha gunartë dhe ariu gunëhirtë u trashëgofshin!

Të gjithëve u pëlqeu kjo legjendë dhe i shtrënguan dorën mjeshtrit që e shpiku. Në përfundim, hartuan edhe një procesverbal, vunë nën të firmat, dhe, të lehtësuar nga barra e madhe që po u shtypte kockat, morën rrugën e kthimit. Aty në të hyrë të fshatit, njëri nga të shtabit pyeti Rapon:

— Ne, thamë ç'thamë, o përgjegjës, po a do të na e hajë populli këtë?

Përgjegjësi i blektorisë e ngadalësoi hapin, rrudhi vetullat kaleshe dhe foli me zë të rëndë:

— Ta hajë kush të dojë dhe si të dojë.

Dhe hynë në fshat kokën lart, me procesverbalin në xhep dhe legjendën në gojë për t'ua thënë e për t'ua dhënë për të ngrënë atij që të kishte oreks.

Të nésermen, përsëri në zyrat e kryesisë ra si bombë një lajm:

— Bletët janë dukur në lëndinën e Gazelit. Kosheret janë vendosur radhë-radhë si brisqet e berberit. Aty pranë xha Puçja kishte ngritur edhe një kasolle dhe ia kishte marrë një avazi me fyell. Përsëri alarm.

— Bletët? Xha Puçja? Avazi me fyell? I përziet lajmet, i bëtë lesh e li.

— O burra te vendi i ngjarjes, — propozuan.

— Atje, atje në praktikë duhen verifikuar dhe zgjidhur gjërat.

Përgjegjësi i blektorisë nuk po merrte vesh se ç'po bëhej.

Pas gjysmë ore, të gjithë kishin arritur në lëndinë. Xha Puçja u doli përpara, buzëgaz si gjithëherë.

— E bëra mirë, o Rrapo, ë?, — iu drejtua ai përgjegjësit të blektorisë. — Thashë unë: Ç'ne ato bletë atje pa njeri, pa zot, si pelat qëmoti? Po sikur të na i gjejë gjë? Dëmi do na bëhet të gjithëve, po turpi do më mbetet mua. Si do të më thoshte fshati? Ama edhe ti, o Puçe, të rruat që je pensionist dhe mjeshtër i bletëve. I pe atje në bokërrimë dhe i le. Turp! Dhe unë, more bir, nuk kam ndër mend të marr në kurriz turpin e fshatit.

Rrapoja nuk fliste. Ishte ulur mbi një gur dhe kishte zënë kokën me duar. Pak më tej qëndronte thurësi i legjendës dhe përballë, në formë gjysmërrrethi, kapsallitnin sytë anëtarët e shtabit. Xha Puçja s'po merrte vesh gjë.

— Ore?, — pyeti, — përse rrini kështu, sikur t'ju ketë ngrënë gomari bukën nga trasta? Bletët i kemi të shëndosha. Mjaltë do marrim. Ç'doni më?!

Një kooperativist, që kishte dëgjuar legjendën një ditë më parë e që kishte vrapuar këtu, së bashku me të tjerët, i ra me bërryl xha Puçes dhe, si të fliste me vete, i tha:

— Njëzet zgjoj me bletë me mjaltë bashkë, o xha Puçe, u zhdukën pa lënë gjurmë. Thonë se i hëngrën arinjtë. Bënë edhe procesverbal. Po ti ç'thua?

NË MBLEDHJEN E NJË KOMISIONI

Më kishin caktuar në një komision, megjithëse e dinin që unë kurrë nuk i kam pasur qejf komisionet. Një ditë prej ditësh fap ia bënë, më shënuan emrin në një goxha listë dhe unë u gjënda midis anëtarëve të një komisioni. Them të një «komisioni», sepse edhe tani unë nuk e di se ç'komision qe ai, por, ma ha mendja (shpesh më pëlqen t'i marr gjérat me hamendje, se, si i thonë asaj fjalës së urtë: Mendja bën hatanë dhe mendja bën kalanë), gjithmonë duke u nisur nga problemet që u shtruan për shqyrtim, ai duhet të ketë qenë patjetër një komision i ngritur për të drejtuar punën për festën që po afrohej.

Po kjo s'ka rëndësi. I rëndësishëm është fakti që komisioni u ngrit dhe, sipas njofitimit që mora, duhej të paraqitesha në ditën, datën dhe orën e caktuar.

Gjithmonë e kam pasur për parim që orarin ta respektoj me rigorozitet dhe të mos e bëj si ca e ca, që të lënë takim në aksh orë e në aksh vend dhe pastaj, si pa gjë të keq, pasi të kanë lënë të marrësh fresk e të mbash murin një orë të tërë,

vijnë e të thonë duke mbajtur dhëmbët përjashta buzëve: «E di? U takova me çunin e Selimit, të nippin e Selamit, që është dhëndër i Sadikut, ndaj dhe u vonova «nja dy minuta».

Kështu, në ditën, datën dhe orën e caktuar, shkova atje ku më ftonin, domethënë shkova në mbledhjen e komisionit, anëtar i të cilit isha zgjedhur.

Megjithëse ishin mbledhur të gjithë, përsëri na u desh të prisnim pak sepse mungonte kryetari. Megjithëkëtë, unë nuk u mërzita. Praktika më ka vërtetuar se ka edhe kryetarë që vijnë pak si me vonesë në mbledhje dhe kjo, me sa thonë vetë ata, ka një qëllim: Kur vjen kryetari — thonë — anëtarët çohen në këmbë, gjë që nuk mund ta bëjë kryetari, po qe se vijnë vonë anëtarët.

Shkurt, pritëm. Kur kryetari hyri në sallë, ne u ngritëm në këmbë. Ai u ul e na e bëri me dorë dhe ne u ulëm pa zhurmë, nxorëm fletët e shëni-meve dhe mbledhja filloj pa shumë ceremoni, ashtu siç ndodh në mbledhjet e punës, ku formaliteteve nuk u kushtohet asnjë kujdes.

Kryetari e mori fjalën menjëherë dhe, përmirësuellje, e filloj me kërkesën përfalje. Pra, po bënte autokritikë dhe kjo ishte shenjë shumë e mirë.

— Kisha një mbledhje me shumë rëndësi, në një komision shumë të rëndësishëm, prandaj u vonova. Më falni, — tha me ton shumë të prerë.

Ne e falëm dhe ai parashtroi detyrat, që shtroheshin përfundur nga komisioni ynë.

— Komisioni ynë, — tha, — do t'u japë zgjedhje një varg problemeve kyçe. Pika e parë: Ka një propozim nga ana ime që të ngremë një shtë-



pi-muze, aty ku është hapur për herë të parë shkolla e qytetit, meqenëse prej asaj shkolle na kanë mbetur trashëgim disa objekte si regjistra, fotografi e më the të thashë. Ka mendim?

Mendime pati dhe ato rrodhën si pikat e shiut.

— Ato objekte i kemi në muzeun e qytetit. A është e udhës të ngremë një muze duke varfëruar një tjetër?

— Aq më tepër që godina e shkollës së parë nuk ekziston më!

— Atëherë?, — tha kryetari i mërzitur.

— Më mirë të mos e ngremë shtëpinë-muze dhe të përpinqemi të pasurojmë muzeun ekzistues, siç kemi bërë deri sot.

— Ka vërejtje?

— Dakord.

Kryetari kaloi në pikën e dytë: Të pregatisim historikun e qytetit. Ky të jetë gati me rastin e përvjetorit të çlirimtë të qytetit. Ka vërejtje?

— Po, ka, — u dëgjua një zë andej nga fundi i tavolinës. — Përvjetori i qytetit ka një muaj që u festua.

— Atëherë?, — shtrroi pyetjen kryetari. — Ka ndonjë propozim konkret?

— Unë them që këtë pikë ta lëmë për ta realizuuar vitin që vjen, — u bë një propozim konkret.

— Në votë atëherë. Kush është pro?

Për propozimin konkret votoi shumica absolute dhe kjo pikë e programit u la për t'u zbatuar pas një viti, dhe, vetëkuptohet, para përvjetorit të festës. Ndryshe do të lihej përsëri për vitin tjetër.

Pas kësaj u kalua në pikën e tretë.

— Të organizohet një takim i të rinjve të shkollës 12-vjeçare me shokun Raqi, që është edhe veteran i Luftës.

— Me vend.

— Aprovohet?

— Në parim, po. Në praktikë, jo, — e mori fjalën një moshatar i im.

Të gjitha vështrimet u kthyen nga ai dhe atij nuk i mbeti gjë tjetër veçse të shpjegonte.

— Shoku Raqi nuk ndihet mirë, — tha ai. — Ka ditë që nuk del as në klubin e veteranëve, se pse plaka i ka vënë jaki në kryqëze.

— A mund ta zëvendësojmë?

— Propozoj që më parë ta mendojmë me vete kandidaturën që do të zëvendësojë shokun Raqi në këtë takim, dhe në mbledhjen e ardhme të komisionit shokët të paraqisin kandidaturat, — foli këshilltari kryesor i kryetarit.

Propozimi u miratua, pas disa buzëqeshjesh dhe nënqeshjesh. Kryetari u hodhi një vështrim të pranishmëve.

— Atëherë?, — pyeti. — Çfarë na mbetet për të bërë?

— Të përcaktojmë datën e mbledhjes së ardhme, — tha këshilltari kryesor.

— Tjetër?

— Edhe temën.

— E drejtë.

Kryetari shflettoi një kalendar xhepi nga ai lloj që mbajnë ata që drejtojnë shumë komisione, duke vërtetuar kështu në parim dhe në praktikë se ka edhe njerëz që mbajnë jo dy, por edhe më shumë se dy shalqinj nën sqetull.

— Ta caktojmë kur të gjej unë një ditë të

përshtatshme? (Në gjuhën e atyre që njohin praktikën e mbledhjeve të komisioneve të tilla, kjo donte të thoshte: E lëmë kur të më bëhet mbarëmua).

— Dakord, — qe përgjigja e të gjithëve.

— Po temën?

— Ta shohim më vonë.

— Dakord edhe pér këtë?

— Dakord, — u dëgjuan disa zëra.

Kryetari foli me solemnitet:

— Mbledhja e komisionit përfundoi. Mirë u pafshim!

— Mirë u pafshim!

Dhe u shpërndamë sikush në punën tonë, përtu mbledhur sërishmi kur të bënte emër kryetari. Kaq gjer këtu.

Dy ditë më vonë, na thirrën sërishimi, po kësaj radhe kryetarin nuk e pritëm. Ai na priti të gjithë dhe u shtrua si klloçka mbi vezët.

Qëndruam gjatë në këtë mbledhje dhe, kur mbaruam punë, kryetari foli duke buzëqeshur:

— Nuk mbahen shumë kunguj nën sqetull, vëlla, jo.

ST. LITEN ësë gjithashtu që shifra ka varet nga kultura
ëp. Shqipëri ësë më i madhi se s'ndryshoi përgjithësisht
burimi i tretë që është i lartë i përgjithësisht
illose shifra e lartë shumë i madhi që është i lartë
njëzë i lartë i përgjithësisht. Nëse këtia është
njëzë i lartë i përgjithësisht, atëherë është i lartë
njëzë i lartë i përgjithësisht.

JU RROFSHIN STALLAT MODERNE!

Kur nisën të ndërtoheshin stallat e reja, për
të cilat, sipas projekteve, do të shpenzoheshin go-
xha para, fjalët e mira filluan të buronin si ujet
e burimit dhe, në të tilla raste, ka gjithashtu
rëndësi edhe se nga ç'drejtëm vijnë këto fjalë. Pra-
ndaj edhe njerëzit mbanin vesh.

— Stallat që po ndërtohen janë nga më modernet.
Lopëve do t'u bëjë rehat shpirti, — thoshin
specialistët andej nga rrëthi dhe dihet se lëvdatat
nga rrëthi, për inerci, shtojnë edhe lëvdatat në
bazë.

— Tani po, keni për të parë, — thoshin në
kooperativë. — Lopët do ta hedhin hallin. Këto
nuk janë stalla por pallate, dhe në pallate ju e
dini se si jetohet.

Kështu kalonin ditët, javët dhe muajt. Stallat
ngriheshin lart, dhe më lart se ato ngriheshin
fjalët e mira.

Së fundi erdhi edhe dita që shënoi përfundimin
e ndërtimit të stallave. Nuk dihet në u
mbajtën fjalime të gjata a të shkurtra e të ngje-
shura fort. Nuk dihet edhe nëse pati apo jo ndo-

një të deleguar si edhe përshëndetje të rastit. Të gjitha këto nuk dihen, se ka kaluar ca kohë që atëherë, veç një gjë dihet dhe mbahet mend fort mirë nga të gjithë edhe sot e kësaj dite: Lopët u sollën aty me saltanete të mëdha dhe secili që i pa, tha: «Këto lopë i kanë hak këto stalla. Paçin edhe të ngrënët si të rënët».

Po ja që ky urim solli të prapën dhe jo të mbarën. Sikur ndonjë t'u zinte besë bestytnive, do të thoshte menjëherë se lopët i hëngri syri i keq, por ja që një gjykim i tillë është i papranueshëm shkencërisht e prandaj dhe kjo prapësi, që i gjeti të mjerat lopë, shkencërisht duhej parë.

Dhe raportin e parë «shkencor» e dha zyra e planit e kooperativës bujqësore: «Plani i prodhimit



të qumështit të lopëve, — thuhej në këtë raport, — gjatë këtij viti mbeti i parealizuar. Keq vërtet, po kjo nuk na shqetëson edhe aq shumë se, me sa dimë ne, ka edhe më keq se ne. Kësaj i thonë shyqyr me kaq. Ja, këtë të keqe ka ky i uruar qumësht. Vetë është i bardhë, po bojën ta nxin kur të duash..»

Raportin e dytë e dërgoi zyra e llogarisë: «Afërsisht — thoshin llogaritarët, — sivjet sektori i lopëve del me disa qindra mijëra lekë humbje, po kjo nuk duhet të na dëshpérojë se, në fund të fundit, qari dhe zarari, motër e vëlla janë. Kështu e ka bujqësia. Këtu mbulohen të gjitha. Dhe atë që s'e mbulojmë dot ne, e mbulon koha. Kështu e kanë këto punë».

Edhe sektorët jepnin raportet e tyre, por menjëse sektori i parë ishte më i «dalluari» në këtë drejtim, atij i takonte edhe e drejta për të raportuar i pari. Dhe nga sektori i parë, raportonin: «Nga pesë mijë e dyqind kuintalë që ishte plani vjetor i prodhimit të qumështit të lopëve, realizuam vetëm tremijë kuintalë. Kaq patëm dhe kaq dhamë. Edhe lopëve, kaq u dhamë, kaq na dhanë. Pikë».

Në këtë pikë raporti hapte një parantezë dhe sqaronte: «U dhamë degë të thata dhe ato e thanë gjirin. Kjo tharje e gjinjve na thau edhe planin.»

Kaç thoshin raportet, ndërsa në kryesinë e kooperativës edhe mund të shtonin: «Tri herë e kemi shqyrtuar këtë problem, po bosh hesapi. Ke parë kështu ti? Siç duket, këto lopët tonë duhet të kenë qëlluar të prapa, ndaj dhe na e kanë sjellë shpirtin gjer këtu në majë të hundës. Mirë thonë të moçmit: «Gjënë e mirë nuk e nxjerr njeri nga

shtëpia.» Kusuri ynë thuaj. Apo nuk janë edhe barkpangopura, të babëzitura fare. Gjetëm belanë me to. Këto të uruara lopë e paskan me të dhënë e jo me të thënë. Duhen marrë masa ndaj tyre.»

Ndërkojë lopët laramane bridhnin arë më arë për të ngrënë «ç't'u zinte dhëmbi». Ato pëllisnin gjithë ditën e gjithë natën. Kérkonin të hanin, po ç'të hanin? Kashtë apo degë misri të thata?

Këto ishin njoftimet e marra nëpërmjet raporteve dhe të dhënave të tjera dhe të gjitha këto mjaftonin, që njerëzit të thoshin: «Të mjerat lopë. Jetojnë në pallat, po me zorrë thatë.»

PËR DERRAT, THE?

Përgjegjësi i sektorit të blegtorisë, me ta marrë vesh se isha gazetar, tha se i donte shumë gazetarët dhe më priti menjëherë me përzomërsi. Siç merret me mend, biseda jonë u zhvillua në zyrën e tij, e cila ishte një dhomë aneks në njërën prej stallave, mobiluar shumë thjesht: Një shtrat barinjsh, një tavolinë dhe tri karrige. Pasi u ul vetë i pari, më bëri shenjë me dorë, në adresë të karriages dhe më foli buzëgaz:

— Urdhéroni! Do kthyer një gur nga e mbara që e gjetët udhën, po sidoqoftë, erdhët dhe... mirë se na erdhët!

Unë buzëqesha me gjithë zemër dhe kritikën që më bëri e pranova gjithashtu buzëgaz.

— Gazeta jonë, — i thashë, duke nxjerrë aty për aty bllokun e shënimeve, — dëshiron t'u trajtë lexuesve të saj se si punoni ju në sektorin e blegtorisë. Ne jemi njojur me disa nga sukseset tuaja, por disa gjëra nuk i dimë me hollësi. Ja, fjalë vjen, si punoni ju për shtimin e mishit dhe...

Atë që nuk e dija unë me hollësi, e dinte përgjegjësi, që e quajti të udhës t'i binte shkurt kësaj pyetje jo dhe aq të mençur.

— Aha, — foli shpejt e shpejt, — te ne ka mish me bollëk, po të dëshironi vemi në mensë që të bindeni.

Mirëpo unë vazhdova në timen. Kisha dëgjuar se në kooperativën bujqësore «Fitorja» blegtoriaj e kishin të mbarë. Në gjithë rrëthim ata përmendeshin për rendimentet e larta të qumështit që merrnin nga lopët. Mirëpo unë dija edhe që kishin goxha kohë që kishin rënë në hall me derrat. Këtu sikur nuk u ecte. Ca donin e thoshin se shkaku duhej kërkuar në mbeturinat e bestytnive fetare. Të tjerë ishin të mendimit se derrat nuk e honepsnin dot klimën e fshatit dhe në mënyrë të veçantë regjimin stallor kur bëheshin dembelë e, nga ky shkak, shfaqnin shenja të theksuara nervozizmi, gjë që ndikonte për keq në shëndetin dhe mbarështimin e tyre. Ca të tjerë ngulnin këmbë e thoshin se shkaktarët ishin vetë barinjtë. Ata nuk donin të shkonin me derra, sepse mbeteshin pa martuar. Kështu pra mendimet ishin mjaft të kundërtë dhe kjo nuk më jepte mundësinë për të arritur në një përfundim të saktë. Në rrëthana të tillë, isha i detyruar të pyesja:

— Po ne e kemi fjalën për shtimin e derrave?,
— i thashë troç.

Ai bëri sikur nuk dëgjoi. Unë vazhdova:

— Për shtimin e mishit të derrit, pyeta.
Shameti — kështu quhej përgjegjësi i blegtorisë — zgjati pak kryet.
— Të derrit, the?
— Si urdhëron. Të derrit.
— Aha, domethënë të derrit..., — dhe u mbështet në karrige. — Të derrit, ë?, — dhe tundi kryet. — Të derrit, the, ë?, — dhe mblođhi

supet duke folur me zë, si të fliste me vete. — E ç'mund të themi ne? Natyrisht, mund edhe të themi... , — ... dhe e uli zërin e tij të ngrohtë. — Dëgjo, — më këshilloi, — si gazetar i ri që je, a nuk do të jetë më mirë të shkruani për njerëzit sesa përr derrat?

Unë e miratova me qejf këshillën e tij.

— Pse jo? Edhe në fermën e derrave punojnë njerëz, pra edhe përr ta mund të shkruhet, — tha shë.

Shameti kaloi në propozime konkrete.

— Dëshironi të shkruani për Saliun?

— Kështu quhet rojtari i tufës së derrave?, — e pyeta.

Ai lëvizi dorën me përtesë.

— Kështu, kështu, po ju prapë derrrat!... përse kapeni pikërisht pas derrave, xhanëm?

Unë e ndërpreva.

— E di. Derri derr është, do të thoni ju, apo jo?

Ai s'dinte ç'të thoshte, sepse edhe unë nuk i lashë të nënkuptonte gjësend.

— Jo... Po..., — bërbëliti.

U mundova t'i vija në ndihmë.

— Për shembull, mund të më thoni se si e kryen bariu detyrën e tij...

Shameti ma ktheu shkurt:

— Lëre mos e pyet!

— Po gjendja shëndetësore e derrave, si është?

Mirë besoj.

Ai tundi kryet. Tani po filloja ta kuptoja më shkoqur ngurrimin dhe heshtjen e tij.

— Me çfarë i ushqeni?, — i bëra një pyetje të lehtë duke dashur ta nxirrja nga ajo gjendje.

— Me gojén e tyre, — u përgjigj shkurt Shemeti.

«Horizonti» po qartësohej. Vazhdova të pyesja:

— Po pjellshmëria si është?

— Çka. Çdo dosë, në dy pjellje, brenda një viti ka dhënë mesatarisht gjashtë gica.

— Gjene mirë, — qesha unë.

— Ka edhe më keq, — qeshi edhe Shemeti.

Dukej se ne po e kuptonim njëri-tjetrin.

— Sa të ardhura keni pasur nga derrat?, — vazhdova me pyetjet e mia, ashtu siç e kërkonte profesioni, për të grumbulluar sa më shumë fakte e për të nxjerrë pastaj përfundime sa më të sakta.

— Të ardhura?, — Shemeti më vështroi me habi. — Për të ardhurat më pyete? Lëre më mirë se, po e zumë në gojë këtë kapitull, do të katasdiset kaposhi një thelë.

Atëherë e pashë të udhës të futesha në kaptullin përfundimtar.

— Po për të vegjlit, çfarë kujdes tregoni?, — pyeta.

Shemeti tundi kryet, kësaj radhe sikur deshi të thoshte: «Ama edhe ti! Më plase! Ne nuk po shohim hair nga derrat e mëdhenj e ti kërkon të na ngatërrosh të vegjlit nëpër këmbë. Ik ore, për kokën tënde!» — Dhe, si heshti pak, tha:

— Edhe të vegjëlve do t'ua gjejmë anën. Do t'u japid të hanë sa të shqepen me gëzhuta gruri, se tanë po shijmë. — Unë heshta dhe ai vazhdoi duke marrë zemër: — Ne kemi marrë masa të tillë, që tufën e derrave ta ketë zili një fshat i tërë. Kjo do të ndodhë pak më vonë; ç'më vonë

them dhe unë? Ja, sikur ka ndodhur. Atëherë eja
dhe shkruaj për derrat.

— Për këta të sotmit? — i shkela syrin.

— Jo, për të motmit, — ma ktheu menjëherë.

Shameti zgjati qafën dhe njérën dorë e vendos-i në llapën e veshit, si të qe ndonjë lopatë gjemie. Siç dukej, nuk po i vinte më zëri. Fshati që dukej s'donte kallauz. Heshti për një çast, si për të mble-dhur mendimet e shpërndara, pastaj, duke mos m'i shqitur sytë, më foli shtruar:

— Hakun vëlla, hakun do të na japësh. Kështu qenka në këtë botë. C'jep, merr.

Dhe më hodhi dorën në qafë.

Biseda kishte marrë fund. Ne ishim kuptuar me njëri-tjetrin.

KUR PLEQËRON SHEFI I FIZKULTURËS

Ai qëndronte i mbërthyer në krye të tavolinës që ishte mbushur me një barrë takëme, si përt'i treguar cilitdo që hynte aty se kishte të bënte me një kokë. Dhe meqë ra fjala te koka, ai e kishte bërë zakon që gishtin tregues të mos e drejtonte drejt gjoksit (siç dukej nga frika se mos bënte ndonjë vrimë), por drejt kokës së tij. Dhe, si i binte dy-tri herë me mollëzën e butë, thoshte tërë solemnitet:

— Di kjo kokë se ç'bën, — dhe kjo donte të thoshte: «E ku merrni vesh ju nga drejtimi, more derdimenë! Këtë e di vetëm unë. Pa mua, asgjë nuk mund të bëhet.»

Dhe meqë asgjë nuk mund të bëhej pa kokën e tij, dikush edhe duhej t'i shërbente. Duke kërkuar t'i shërbenin, fluturonte tërë ditën në majat e reve që formoheshin nga avullimi i bulëzave të djersës dhe tymi i duhanit që ngrihej duman. Nga ajo lartësi kaltëroshe, e kishte zor të zbriste në tokë dhe përgjigjej vazhdimisht që aty me zë të lartë se, domosdo, kur je ngjitur në re, duhet të thërrresësh që të të dëgjojnë.

— C'janë këto terrene sportive, kështu, more? Po si i keni lënë kështu në pikë të hallit, more? Të ndreqen, të rregullohen, të bëhen të gjitha një orë e më parë, more!

Dhe si shtrihej atje, majë reve të veta si në një dyshek ajror që i kujtonte plazhin, garat e notit që zhvilloheshin vetëm në formularët dhe pishinën e bukur, që qëndronte si stoli e rrallë, shfrynte gjithë dufin e tij, ashtu siç shfryjnë dushet e stadiumit, që kurrë nuk funksionuan një herë siç duhet.

— Uf, q'dembelë janë këta që kam përreth! E ku mund të punohet me këta, more. E çfarë mund të bësh me këta, more!

Kur qëllonte të zbriste nga retë dhe ngulej në karrige, atëherë fliste si nga maja e karriges dhe ligjérata e tij e kalonte edhe atë të bilbilit që këndonte hijeve ashtu siç flenë hijeve atletët, që mbahen si ajka e qytetit. Në kësi rastesh, ai e fillon dhe e mbaron kështu: «Na besoni, more shokë. U ropëm në punë dhe po na bie lëkura më keq se lëkura e mundësve, të cilëve do t'u bjerë në kampionatin lokal, që do të organizojmë vitin që vjen. Qyteti ynë zien nga aktiviteti sportiv. Ne të thajmë me futbollin, more. Janë burra namuzllinj futbollistët tanë e nuk turpërohen, se kanë nga një varg ciliminj dhe çfarë ciliminjsh, thuaj! na, buçko fare, thuaj! ciliminj sportistësh, or tungjatjeta! Ata janë shpresa jonë. Sa të rriten ata dhe keni për të parë po nuk e bënë fora në kategori. Kampionë do të dalim, për ç'besoni, kampionë po të them dhe vëri vëth këto fjalët e mia se janë fjalë me mend këto e jo dosido, more. Apo nuk kemi atletë! Qyteti ynë është i dalluar për

njerëz që bredhin me vrap. Kot që nuk na thonë këmbëshpejtë, more, po nejse, unë nuk merrem me të ngjiturit dhe të shqiturit e nofkave. Ka të tjerë që merren me këtë punë. Janë të ngeshmit, ata; ndërsa unë jam i mbytur gjer në grykë me punë. Jam shef unë, more, dhe si i tillë di ç'them e di ç'bëj».

Këtu ai kalonte në ekstazë. Të gjitha sa thoshte, i dukej sikur ishin bërë dhe ç'është bërë nuk ka nevojë për komente. Kjo ia rrit «vlerën». Domsdo, vlera e tij nuk matet me kandar të farmacisë se nuk është ilaç, po edhe fare pa këtë, ajo duket sheshit, del në evidencë, siç i thonë ca që i kanë për qejf fjalët e huajtura. Dhe kur nxirrte në shesh vlerat e tij ai i jepte ato pa u kursyer.

— Shoku shef, — vijnë e i thonë, — qendrat e punës nuk i lejojnë volejbollistët të stërviten. Ju lutemi ndërhyjni.

Ai: — Unë të merrem me këtë punë, more? Turp, turp ju them. Mua më shqetësoni me këto vogëlsira? Shefi është për gjërat me peshë një ton e lart, more.

— Po me bazën materiale të çiklistëve ç'të bëjmë? Po afrohet kampionati.

— Rregullojeni vetë këtë punë. Ohu, sa kampionate janë! Shefi i fizkulturës nuk është shefi i kampionateve.

Përsëri vijnë e i thonë, po kësaj radhe jo duke qëndruar më këmbë ashtu siç e kërkojnë rregullat e zyrës, por te veshi (se prandaj i kemi veshët, për të dëgjuar edhe pëshpëritjet, që nuk duhet t'i dëgjojnë të tjerët).

— Si do të bëjmë me djalin e shokut X. Traineri i basketbollit nuk e fut në pesëshen e parë.

Ai përfytyron trainerin, skuadrën e basketbollit, stadiumin e lojërave me dorë dhe shokun X ulur në tribunë, që pret të shohë djalin.

Dhe ngrihet, mban fort karrigen dhe thërret: «Djali i shokut X, do të luajë. Ky është urdhër i shefit.»

Dhe, duke u mbajtur pas tavolinës, ulet duke pëshpëritur: «C'trainer hajvan. Nuk e ka konceptin e shokut.»

Ndërkokë hapen edhe ca fjalë dhe fjalët janë si puna e erës, që merr dhenë dhe nuk qëndron asgjékundi.

— Thonë se do të kërkohet një shok për të shoqëruar skuadrën X, që do të dalë në turne jashtë shtetit.

Atij i shkëlqejnë sytë si të kunadhes.

— Një shok për jashtë shtetit?, —dhe rrudh sytë duke qeshur nën buzë. C'duhet një shok, kur ja tek jam unë, një goxha shef! Unë jam i prerë me gëershërë edhe për brenda edhe për jashtë, more.

Kështu shefi ynë rrinte dhe pleqéronte që nga maja e karriges, duke u munduar të mbahej fort pas saj e duke éndërruar për një udhëtim «shoqërues» jashtë shtetit. Mirëpo ndodhi ndryshe. U ngriten sportistët dhe thanë se do të ishte mirë që shefi të bënte një udhëtim jashtë. . . . karriges.

KUR KEMBA I BIE KOKËS

Ka një proverb, që thotë: «Ujku ha qesim».

Thonë se kjo urti është tepër e lashtë, po duke gjykuar njoftimet e fundit, ka shumë mundësi që ajo ta ketë burimin e vet edhe në kohët më të reja, sepse pikërisht në këtë kohë, zë fill edhe urtësia tjetër: «Secili ka rriskun e vet». Duket, se që këtej do të jenë nisur edhe në kooperativën tonë bujqësore kur vinin gur në zemër dhe proces-verbalet në dosje sa herë që vinte njoftimi: «Ngorëdhi një dele. Ujku hëngri edhe një sheleg. Sipas urdhërit që dhatë, e therëm një qengj». Në këto raste, në kryesinë e kooperativës, pasi hiqnin nga një pshërëtimë të thellë, mbanin llogaritë përkatëse dhe pëshpërisnin me zë të mekur: «Aq e kishin rriskun. Kështu qe e thënë.»

Dhe, meqenëse e thëna shkoi me të bërën, të bërat nganjëherë bëjnë gjëmat, që nuk i merr as maja e kalemit.

Zanafilla e gjëmave dhe e bëmave niste kështu: «E mo, se ka kooperativa, — thoshte ndokush. — Ti, një sofër bukë ha dhe bën një çanak me thërrime e jo gjithë ato tufa, që, domosdo, do t'u bjerë edhe ngordhja, edhe ujku, edhe... nje-riu.»

Disa të tjerë, që e dëgjonin këtë ligjëratë e flinin mendjen, i vinin mendimit nga një vegje si shtëmbari shtëmbës dhe miratonin:

«Ka déborë këtu te ne. Bën dimér i madh dhe delja nuk e nxjerr dot një ftomë të tillë, megjithëse ka veshur një goxha qyrk mbi vete».

Më pas lindi dhe u zhvillua një tjetër mendim: «Ku ka, s'mbarohet». Merita pér këtë proverbë gjeniale nuk është zbuluar akoma se kujt i përket por, meqenëse *aty ku ka, aty dhe s'mbarohet*, filluan si pa e kuptuar të bënин këmbë herë ndonjë qengj, herë ndonjë rrurrez dhe herë ndonjë dele, që e mbanin frymën drejt e në kasaturen e kasapit. Fjala e urtë thotë: «Gur-gur bëhet mur», ndërsa në kooperativën tonë, kokë-kokë, u kaluan okë e brokë. Dhe kur e kaloi guri masatin, ata që hiqnin nga një pshëritimë të thellë dhe mbanin shëнимë në librat e llogarisë, mblodhën supet.

— More, more, — thanë dhe perënduan vështrimin pér të treguar kështu keqardhjen e tyre. — Kaq shumë qenkan bërë të shkretat? Si është e mundur? Ne vërtet kemi dhënë ca urdhra, po, pse gjer kaq paskan arritur? Çudi dhe kaluar çudisë qenka! Nejse. Mend pér tjetërherë, thuaj pa ç'qe pér të bërë u bë. Fundja, ne jemi të larë, sepse çomaga e parë bie mbi barinjtë, pastaj mbi kryebarinjtë, mbi përgjegjësin e blektorisë, mbi zooveterinerin dhe më the të thashë. Ka rregulla, vëlla, ka rregulla, se, si i thonë: «Nuk jemi të gjithë si këmbët e dhisë».

Po kësaj radhe nuk u eci. Vërtet nuk ishin si këmbët e dhisë, po paguan një e pér një, pér çdo këmbë dhie.

Dhe thonë pastaj se këmba nuk i bie kokës.
Posi!

KETU JAM ZOT UNE...!

(Monologu i një brigadieri)

Unë quhem... e ç'rëndësi ka kjo? Fundja edhe unë kam një emër të rëndomtë, si gjithë të tjerët. Dhe e rëndomta nuk paraqit asnje interes. Ajo që ka rëndësi është fakti që unë jam brigadier në një kooperativë bujqësore, dhe si i tillë duhet të njihem nga të gjithë, si nga ata që kam nën vete ashtu dhe nga ata që kam përmbi vete.

E veçanta ime nuk qëndron varur si këmbora në qafë të shelegut, dhe kjo kryesisht për shkak se unë kam kokën time. Nuk them. Të gjithë kanë kokë dhe dihet se koka kokës nuk i ngjan dhe këtë unë nuk mund ta mohoj, por të gjithë duhet ta pranojnë se si kokën time, që pjell aq shumë, më shumë nga ç'pjell vezë pula e zezë e komshiu, rrallë gjen. Kjo, në fund të fundit, ka të bëjë me karakterin. Unë jam intrasigjent ose, që të merret vesh mirë, e shqiptuar shkronjë për shkronjë, do të thotë: Këtu ku urdhëroj unë, bëhet vetëm si them unë. Të tjerët le të rrabin këmbo-rë, se mua zilka më duken. Po të doni, këtë thënie po jua shkoqis edhe më mirë:

Më vjen, ta zëmë, një urdhër nga kryesia e kooperativës. Në këtë urdhër thuhet: Tetëdhjetë e pesë për qind e krahëve të punës të hidhen në frontin e mbjelljeve sepse jemi prapa. Posi: Ç'pandehni ju, se unë do të tèrhiqem për gjalme? Pse, ç'u bëra unë, ogiq?! Këtë e di unë. Jam unë bari në këtë stan. Mbjelljet presin edhe ca. Kam halle të tjera unë, halle që nuk presin dhe në brigadë të gjithë e dinë që sot java kemi dasmë, e dasmor i mirë është ai që mendon një javë më parë se në dasmë tjetrit do t'i vesh si të ka ardhur e do ta nderosh si të ka nderuar. Ka zakone këtej nga ne dhe burri namuzlli e mban zakonin.

Po do të thotë dikush:

Po mirë, ju kundërshtuat urdhrin, ç'bënë të tjerët? Pse budalla jam unë, more? E ha lala atë kokërr ulliri? Po të kundërshtoja, do të më ngriheshin të gjithë me të kritikuar e do të më shqepnin brinjët, aq sa mos ta mblidhja veten një javë të tërë; kurse kështu, urtë e butë e plot tiganin, askush nuk të vë re. Ata në kryesi le të thérresin sa të duan, unë vazhdoj të mbaj direkun tim. Mua më quajnë «bazë» dhe baza e di vetë hallin e saj.

Mirëpo mund të ketë edhe nga ata që ngulin këmbë e thonë. Kemi centralizëm apo jo?

Pusho more. Atë e di unë. Unë jam centralizmi. Unë nuk bëhem servil për shkak të centralizmit. Ja që jam i tillë. Ç't'i bësh? Më pëlqen më mirë të rri drejt si shkop thane. Kështu e shoh edhe më mirë botën.

Mundet që ndonjëherë të më njoftojnë edhe me fonogram: *Përdorni metodën zinxhir në pligmat dhe mbjelljet. Bëni diskime dhe lesime, që të mos*

humbisni vlagëni. Përdorni sa më shumë plehëra organike.

Aty le të mbahen. Le të dërgojnë fonogramë sa të duan. Vlajë pa vlajë, atë e di unë! Jam unë brigadier e askush tjetër. Na e bënë këtë të uruar vlagë si pikëz vesel! Le pastaj me atë plehun! Aty u mbeti mendja dhe nuk shkulën që andej. Sikur pa pleh organik nuk u bëka asgjë. Po plehun kimik pse e kemi atëherë? Të na rrojë plehu kimik, vellezër. Unë kështu e kam zgjidhur këtë problem. Thoni si të doni, po mendja ime është xhevahir.

A mund t'i thosha këto edhe në mbledhjen e këshillit popullor të fshatit? Ah, jo! Janë çështje të brendshme këto. Pastaj, q'më duhet të mbrehem në atë kular. Di vetë unë si ta dredh patën që të mos i digjet sqepi. Ndryshe, përse jam brigadier? Jam unë zot konaku këtu. E qartë?

Çfarë? Erdhi fonogram? Pa lexoje? Sii? Të paraqitem në mbledhjen e përbashkët të këshillit popullor dhe të kryesisë së kooperativës? Jam në report? Hëm! Bela e re! Duhet të preqatitem për ca minuta autokritikë, pastaj e di vetë. Sa të hedh lumin, pa...

* * *

Monologu i brigadierit përfundoi në mbledhjen e përgjithshme të kooperativistëve. Meqenëse kish te qejf të rrinte drejt si shkop thane, kooperativistët i dhanë një shkop të fortë thane dhe ai ka ditë që i rreh qylykes bashkë me shokët dhe e tejkalon normën.

TE PABESAT

Një hije filloj të rrëshqiste anës gardhit. Ky ishte Beqoja, që punonte si ta sillte reja dhe oreksi i brigadierit të blegtorisë, të cilin e kishte shok. Beqoja qëndroi. Edhe pula lariskë qëndroi. Nëpërmjet fletëve pak të rralluara, Beqoja e pa tek u tulat dhe tek treti diku larg vështrimin e saj gjithë frikë. Beqoja i buzëqeshi. Zgjati lehtas dorën. Deshi ta përkëdhelte, ta kapte, ta pushtonte me krahët e tij të fuqishëm, po ajo i shkau lehtas dhe çau pértej, mes pér mes lëndinës.

Ai shtangu në vend kur e pa se i shpëtoi përsëri nga duart. Zemra i drithërohej.

— Po tani? Përse më largohej, moj e bekuar? Unë asgjë s'të bëj.

Po ajo largohej e largohej dhe tashmë i gjante një pike të vogël, që fundosej në gji të hapësi-riës. Ai u ngrit, shtrëngoi grushtin dhe kërcënoi:

— Dëgjon? Veç mos të kapsha, pa di vetë ç'kam pér të të punuar! Ja, me këto duar!..., — dhe rrahu gjoksin, — pulë harrakate!

— Ej, ej, ule zërin e mos i shaj, se, po të dëgjoi brigadieri, ec e dëgjo fjalët e tij!, — i foli Seloja që kaloi aty pranë.

Ai pshëretiu thellë.

— Eh, more vëlla. E di. Se mos unë po e ndjek me kokën time, thua? Ai më ka dërguar. Po këto nuk janë pula të gjalla, thuaj, po janë prej guri, se janë të pashpirtë. E shohin se si po shkrihem pas tyre dhe e dredhin bishtin si lozonjare. Të shkretin brigadier, ç'ë ka gjetur! Apo nuk ka ogradisur edhe me ata të kryesisë «T'i kemi dhënë të gjitha, — i thonë, — krerët t'i kemi dhënë, koteçat i ke, çaire plot, gëzhuta sa të duash, ç'do më shumë? Tani ne duam vezët. Përse nuk bëjnë vezë ato pulat tuaja, thonë!» Vezë! Një fjalë goje është, po ec e bëje!

— Djall, jo!

— Më plaçin sytë në të gënjej. Në fillim të vittit na u duk se gjithçka po na vinte si jo më mirë. Pulat vinin të mbara dhe brigadieri kishte filluar t'i donte shumë ato. Epo, shyqyr thamë, mirë po rriteni! Rrituni ju, se kemi edhe punë të tjera. Mirëpo ato të pabesa në vend që të na i shpërbujejnë gjithë fjalët e mira, filluan nga nazet.

— Të pacipat!

— Këtu e ca ditë të shkuara, si e pamë që nuk po dilte gjë në shesh, më thirri brigadieri e më tha: «O Beqo. Ti je specialist. Pa kontrolloji njëherë, more aman, se na futën në telashe të paudhat. Qenkan bushtra, ore, për besën që kemi, qenkan bushtra po të them! Të gjitha sa kemi pasur, i kemi derdhur në këmbët e tyre, kurse ato na kanë kthyer krahët dhe as që pyesin për

ne. Çap të lutem, çap e zëre njérën. Provoje, vë-shtroje dhe ec e më thuaj, që t'i bëjmë edhe një herë llogaritë. Do marrim vezë nga këto pula, apo?...

— Po ti?

— Unë, po si unë, që pika nuk më bie! Ia vura syrin njérës, asaj më të shëndoshës, më kërbisht-gjerës, e ndoqa pil më pil dhe, siç e pe, nuk e zura dot. Më shkau si ngjalë. Tani do të vete e do të provoj se mos zë ndonjë tjetër. Ç'të bëj? Këto janë të lanetosura thuaj, e jo matkëza. S'di edhe unë se si do t'i vejë hallit.

— Mirëpo llogaritë, ç'thonë?

— C'pyet. Po t'i biesh kalemit poshtë e përpjjetë, kostoja e një kokërr veze po na del me 35 lekë. Ja pra si e kemi hallin. Thuamë tani: A nuk janë të pabesa?

— Të pabesa?

— Po, kush do të pjellë vezë për to, brigadieri?!

— Gabim e kanë, — tha Seloja duke qeshur. Beqoja ngriti kryet si i lehtesar nga një barrë e rëndë.

— Ja këtu ta kam fjalën, — tha dhe u largua në drejtim të pulave, pa ditur edhe vetë ç'të bënte: të vazhdonte të ndiqte pulat e tjera apo të kthehej të brigadieri.

Ndërkohë, përballë po vinte kryetari dhe dy-tre shokë të tjerë.

— E, more Beqo!, — e pyeti duke qeshur, — ç'thonë?

Beqoja mblođhi supet.

— Ç'të themi, o kryetar. Edhe unë vetë s'di më ç'them e ç'duhet të thonë ato.

Kryetari i rrahu shpatullat.

— Kanë thënë, Beqo, kanë thënë, po ju s'u keni vënë veshin. Si i keni lënë, ashtu ju kanë lënë.

Beqoja heshti.

Pak më tej, brigadieri vinte drejt tyre, i ndje-kur nga një tufë pulash, që i vinin anës duke kakarisur e duke pritur që t'i vinte re.

...mëmëri o mërtitësivej. Sipas sëllav mëmërit
shumë edhe sëllom niftej emrët e vërtetët që
vihet e tash e t' përvendos që përdorët e
këtij koha. Në këtij vëllanë është edhe vërtetë
që përdorët që është vërtetët që
vihet e tash e t' përvendos që përdorët e
këtij koha.

SULOJA MARTON VELLANË

Dasma bëhej në konakët e Sulos, përgjegjësit
të sektorit, që martonte vëllanë. Miqtë po e nde-
ronin siç ia donte sëra, prandaj dhe ai ua bënte
qe jfin të gjithëve, sepse nuk ishte vetëm zot dasme
po edhe përgjegjës i sektorit më të dalluar të koo-
perativës.

Dy oda u mbushën plot me dasmorë, që ndiq-
nin dollinë herë me ojli dhe herë rrëthshe.

— Të na trashëgohet. Gëzofsh edhe më të tje-
rët, o i zoti i konakut!

Dasmorët këndonin:

Dasmë bën Sulo Seferi,

Dasmë bën e mishra theri.

I zoti i dasmës ishte njeri i dëgjuar. Kishte
ngrënë në aq sofa dhe të gjithë duhej të hanin
në sofër të tij. Dera e tij ishte e çelur gjithmonë për
miqtë, e jo sot, që bënte dasmë e martonte vëllanë.
Sa më shumë të ftuar, aq më shumë gaz e miqësi
ka konaku.

Hidhnin valle miqtë, zhvatnin thela e rrëkëllenin gota rakie të zier me gjethe molle. Edhe gratë nuk mbeteshin pas burrave. Tri defe me radhë i shqyen ato dhe nuk pushonin së kënduari. Njëra prej tyre, që andej nga përtejasi, ia nisi një këngë me zë të hollë:

*Hidhe vallen shtruar-o,
Burazeri i motrës-o.*

Këtej, burrat vazhdonin këngën:


*Dhëndëro, xhufka bërshime,
kujt ia bën këto gëzime?*

Shkurt, u tund gjithë shtëpia. Katër sofra burra dhe tetë sofra gra u shtruau dhe u ngritën atë darkë. Dhe kur Sulos erdhën e çoç i pëshpëritën në vesh, ai, me tërë autoritetin e tij zyrtar, urdhëroi:

— Të theret një ka nga të kooperativës dhe komisioni le ta çmojë sa të dojë. Një herë e martoj vëllanë dhe nuk turpërohem unë.

Aty nga mesi i ditës së hënë, dasmorët u matën të iknin, po Suloja i mbajti për të pritur krushqit, që do të vinin për të darovitur nusen. Atëherë të kishe sy dhe të shihje! U përzien dy palë krushq dhe secila përpinqej t'ia kalonte palës tjetër në këngë e në valle. Sulon nuk e mbante vendi nga gëzimi. Dera nuk po i turpërohej dhe zakonet po hiqeshin si në kohë të zemanit.

Së fundi krushqit ikën dhe pas tyre nga shtëpia e përgjegjësit të sektorit u larguan edhe dasmorët e fshatit. Ai i përçolli të gjithë gjer te le-



sa. I fundit u largua Miti, një kooperativist, që kishte ardhur atë ditë për të bërë një vizitë, sa për të hequr një urim.

— E tunde, o përgjegjës!, — i tha ky. — Kjo dasma jote nuk ka për t'u harruar. Një sektor të tërë le pa punë.

Dhe u largua duke e lénë Sulon aty, në prag
të lesës, tek e vështronë pa ditur ç'të thoshte.

Disa ditë më vonë, ai tha ç'kishte pér të thënë, po kësaj here nuk foli si përgjegjës. Edhe si zot dasme nuk foli. Po i kërkonte llogari organiza-ta e Frontit Demokratik e fshatit e ai, si anëtar i saj, bënte autokritikë.

Dikush, që ishte ulur pranë tij, e shpoi:

— Një herë martohet vëllai, o Sulo, ë?

Ai ktheu kryet.

— Edhe autokritikë e tillë një herë bëhet. Dy herë s'ka lezet.

«REGULLORJA»

Kishte kohë që brigadier Llambi mendohej si të rriste namin e vet, dhe këtë donte ta bënte jo ashtu si gjithë të tjerët, duke e nxjerrë brigadën në pararojë. Kjo s'ishte gjë që bëhej, sepse nuk paraqiste asgjë të veçantë, që ta dallonte mirë e bukur nga të tjerët.

Po pse gjendej lehtë e veçanta që kërkonte ai? Rrihte e rrihte mendjen me ditë të tëra, madje edhe me netë, por jo që jo. Në këtë zavall e gjeti një ditë Loli, një mesoburrë, nga ata me mend e të zemanit. Loli herë i bëhej hije dhe herë i fshihej nën hije, ashtu si t'ia donte interesit.

— Paske rënë në të thella, o brigadier vëllai, — i tha me zë të butë, tamam si t'i lutej. — Mos kështu, pér kokën tënde, mos kështu se nuk i dihet. Një kokërr gruri është e shkreta. Aq e ka njeriu. Mos, pér kokën tënde, se do na lësh jetimë. Ç'tretesh kaq në mëndime, sikur sosën të tjerët. Ohu! Ka plot këtu që duhet të vrashin mendjen se po u trashen tulet e bashkë me to edhe trutë, — dhe shtoi si pa të keq: — Le që ata s'kanë tru fare se, po të kishin, çoc do të kishin nxjerrë në krye, ashtu siç ke nxjerrë ti.

Llambit i erdhën mirë këto fjalë se ia gjetën midenë siç e donte vetë. Mirëpo, që të tregohej si zot i vërtetë i kuvendit, ia preu ligjëratën në mes, me një lëvizje të ngathët të dorës.

— Heu! Ç'hata qenka kjo kështu?, — Çakarriti sytë Loli dhe zgjati kryet për ta dëgjuar më mirë kryehallin e brigadierit të tij.

Llambi, që e dinte se ç'vlerë kishte Loli për të, e pa të udhës që t'i shpjegonte më shkoqur se ku i dhimbte dhëmballa.

— Jo hata, more xhan, jo hata, po kryehall, si ajo kryefjala që ka çdo fjali, ja ashtu siç na thonë në shkollën e natës.

Loli, që përsëri s'po e merrte vesh se ku i rrithë brigadierit, i rrahu shpatullat atij dhe fytyra e thatimitë i mori një pamje të qeshur.

— Ama për këtë më qenke sëkëlldisur aq shumë? Më je ngrysur e më je bërë në këtë derexhe, si të të ketë ngrënë derri brumët? Ik ore tutje, ik ore tutje e mos i bjer pas kryefjalës.

— Jo kryefjalës, po kryehallit, — e ndreqi aty për aty Llambi dhe shtoi: — Pse, gjë e vogël të duket ty?

Loli ia priti flakë për flakë:

— Në mos e vogël, edhe aq e madhe sa thua ti nuk më duket.

— Si ore s'të duket, — u nxeh Llambi. — Gjë e vogël të duket ty, të bësh diçka që të të dalë namë përtej kufijve të brigadës, përtej kufijve të kooperativës, demek, përtej kufijve të nahies, desha të them?

— Për ty nuk ka asgjë të pamundur, — foli Loli dhe e drejtoi trupin si vuzhgadë shkoze. — Si ti s'ka të dytë në tërë kooperativën. Ama, ç'them

dhe unë! Në tërë krahinën thuaj, moj gojë, që plaç!, — shtoi ai.

Llambi u krekos edhe një herë nga shtëllunga e lëvdatës, ndërsa Loli nisi t'i sqaronë brigadierit një e për një se ç'mund të bënte për shembull për t'u bërë i dëgjuar, për t'u bërë i tillë, që t'i shkonte edhe fjala edhe vula, domethënë i tillë, që gurin dhe arrën të mos ia hiqte dot askush nga dora.

— Dëgjomë këtu, o brigadier vëllai, — i tha, — dëgjomë dhe, për kokën tënde, po nuk bëre këshfu si të them. Ti e di. Unë të dua të mirën. Në do që të bëhesh me të vërtetë i njojur, aq i njojur sa Ligor Berberi në vaht të tij, që të shkulte dhëmballë e nofull bashkë e ti nuk bëje dot «oi» nga frika se mos të fluturonte edhe dhëmballa tjetër, duhet të nxjerrësh një rregullore, një rregullore të brendshme ta kam fjalën, një rregullore që të mbajë firmën dhe vulën tënde, një rregullore të tillë që, edhe dhenë sikur të rrahësh më të katër anët, të mos ia gjesh shoqen. Kështu, t'u bëftë Loli ty, do të njihet i pari dhe i pasmi, se, që ta marrësh vesh ti, këtu është gjithë e keqja. Epo, nuk jemi si këmbët e dhisë, të shkretën!

Llambi kërceu përpjetë nga gjëzimi.

— Të paça, o Loli, të paça me jetë. Ja, kjo është e veçanta që e kërkoj ditë e natë. E gjete dhe ta paça borxh gjer në shtatë breza. Hajt ti, hajt, se di unë se si ta shpërblej. Hajt, sot shko në shtëpi dhe bëj kokrrën e qejfit se e more ditën e punës. Hallall e paç. E ke nxjerrë me djersën e ballit.

Dhe brigadier Llambi, ashtu siç e porositi Loli, që, siç thamë, herë i bënte hije dhe herë i fshihej

nën hije, filloi të vriste mendjen për «rregulloren» e tij, të brigadës së Llambit, rregullore që do ta bënte të njojur e do ta ngrinte mbi gjithë brigadierët e tjerë.

Të nesërmen, pa zbardhur mirë, u ngrit nga shtrati gjithë humor, ia nisi një këngë shtruar-shtruar, spërkati sytë me dy gisht ujë dhe mori një copë karton të bardhë, ku qysh në mbrëmje kishte shkruar pikat e rregullores dhe e vendosi në qendër të brigadës, te tabela e emulacionit socialist. Kur kooperativistët erdhën për të filluar punën, u zuri syri rregulloren e brigadierit.

— Po kjo kështu? — pyeti dikush. — Kush ta ketë bërë këtë? — Po kur panë emrin dhe firmën e brigadierit nën të, u grumbulluan të gjithë e sikush donte ta lexonte sa më parë.

Kjo mënyrë leximi shkaktoi zhurmë. Brigadier Llambi nuk mund të lejonte që në brigadën e tij të bëheshin një, bisht e sqepar bashkë. Prandaj u ngrit, doli nga zyra dhe, me vetullat mbërthyer si çark harabeli, iu drejtua atyre gjithë seriozitet:

— Pushoni more. Përse shtyheni ashtu, sikur nuk keni lexuar asnjëherë dy gërma bashkë. Mos jeni në hyrje të cirkut vallë, apo mos po shihni majmunin duke luajtur në tel si pehlivani në kohë të tij? Hajde, hapuni. Më lëshoni udhë! Po jua lexoj vetë pikë për pikë dhe vini veshin mirë. Dhe ja ku po jua them: Mjerë ai që nuk e zbaton rregulloren time ashtu siç dua unë dhe më mjerë ata, që do marrin mendjen nëpër këmbë e do ta ngrenë këtë problem në ndonjë mbledhje, se, siç i thonë, ka Çësua biçak dhe biçaku i Çeços, që ta merrni vesh mirë ju, e dini se si pret e të sakin ton.

Dhe brigadier Llambi, pasi vuri syzet, u afroa
pranë rregullores së vet, e ngriti pakëz zërin dhe
filloj të lexonte me zë të lartë atë që kishte shkruar
dhe nënshkruar me një firmë të zgjatur e me kë-
rrabëz.

«Unë, brigadier Llambi, me dëshirën dhe vull-
netin tim, urdhëroj: që të gjithë sa janë nën mua, të
mëdhenj a të vegjël qofshin këta, të zbatojnë një e
për një këtë rregullore, të veçantë për nga karakteri
i problemeve që trajton.

1. Asnjë të mos fusë hundët në punët e drejtimit
të brigadës. Kështu, gjithsecili ka mundësi ta shpëto-
jë hundën e vet nga ndonjë infekzion i mundshëm.
Kjo brigadë e ka një kokë. E ç'ju duhet, ta zëmë, të
dini nëse kjo kokë ka plan pune apo jo? Ore, ç'ju
duhet se ku shkoj e ku nuk shkoj, nëse kontrolloj ose
nuk kontrolloj se ku punojnë kooperativistët? I them
këto, se kam dëgjuar poshtë e përpjetë ca fjalë. Hiqni
dorë nga këto budallallëqe. Kontrolli jam unë, përde-
risa jam brigadieri juaj... Mos u bëni si këmbët që
duan të ngrihen e t'i bien kokës, se është koka që bën
zap këmbët, dhe koka këtu jam unë.

2. Ka disa që hidhen si gjeli majë plehut dhe
herë pas here bëjnë disa propozime që i hapin bri-
gadës shumë yçkëla. Rrini rehat, për kokën tuaj, e
mos na hapni avaze. Mos na ngacmoni, se gomarit,
po e ngacmove, do t'i durosh edhe shqelmat. Mjaft
i kemi gjithë këto që kemi mbi krye e mos na shpifni
halle të tjera. Pra, këto që kemi mund t'i kritikoni
sa të doni e sa t'ju mbajë xhani.

3. Ka një kërkësë nga dikush që të zihen kumbu-
llat e të bëhen raki. E kam fjalën për kumbullat e ko-
operativës dhe jo për ato që keni nëpër oborret tuaja.
Jo, ky është propozim me mend dhe aprovohet me-

njëherë. Bëjini, more, q'të doni, se askush nuk jua ka ndaluar dorën. Ne s'kemi nge të merremi me zierje rakinë, se jemi të zënë me punëra më të mëdha. Pastaj, s'ka as lezet që goxha kooperativë të merret me rakinë e më the të thashë. Kështu, po ju jap mundësinë të vetëveproni. Merruni me punë. Zieni raki dhe pini raki sa të mundni, o burra, se rakia rekomanohet kundra arteriosklerozës dhe sidomos rakia e kumbullës. Pini, o burra, se mall kooperative është dhe kooperativa është jona, është juaja. Këtë lejë jua jap unë, brigadier Llambi, brigadieri juaj (që s'e keni hak more qerratallarë!).

4. Të gjitha sa kam thënë e kam shkruar më lart, hyjnë në fuqi menjëherë e pa asnje ndryshim.

Dhe, si kapërceu pështymën, që i qe mbledhur si lëmsh në grykë, u hodhi një vështrim të gjithëve sa qenë aty, si për t'i pyetur: E, a keni për të thënë gjë? Flisni, flisni, se ja ku jam unë».

Kooperativistët qëndronin të palëvizur përparrë rregullores. Llambi nuk duroi më dhe pyeti:

— Hë, mor de, flisni! Ç'thoni?

Dikush foli. Llambi e vështroi. Hëm, ishte ai çuni i Lekes, ai bizdërriqi që nuk kishte hequr akoma pelenat. Ai firaun ia kishte sjellë edhe disa herë të tjera në majë të hundës, duke dalë si bishti përparrë sqeparit.

— Edhe kemi, o brigadier, — i tha, — edhe kemi dhe, në do ta dish mirë, të gjitha do të t'i themi në mbledhje. Harrove? E kemi lënë për sot mbledhjen e brigadës.

Llambi, i futur thellë në mendimet e tij për të gjetur të veçantën, kishte harruar me të vërtetë se atë ditë do të mblidhej brigada për të shqyrtaur qëndrimin e brigadierit ndaj problemeve që

shqetësonin brigadën. Ai u hodhi një sy të prani-shmëve dhe kërkoi të gjente midis tyre Lolin. Ai ishte andej nga fundi dhe i shkeli syrin. Kjo i dha zemër brigadierit, që e mblohdhi veten menjëherë nga kjo goditje e menjëhershme e atij spurdhjakuat të Lekes.

— Ashtu, ë?, — foli si me vete. — Në mble-dhje, ë?

U afroa furtuna, një furtunë me shi të rrëm-byer që e bëri xurxull brigadierin, të cilit filloi t'i merrej gjuha.

— E dini... Unë... Unë... si të them...

Kooperativistët kësaj radhe ia prenë shkurt. Mjaft e kishin duruar. Ena qe mbushur plot.

— Thuaj si të duash, o brigadier, — i thanë, — po ka ardhur koha që të themi se, kështu si drejton ti, nuk ecet më tej. Më mirë të na drejtë shoqja Fatime. Ajo edhe punonjëse e dalluar është, edhe shkollën e mesme bujqësore e mbaroi, edhe zotësi ka, edhe e dashur me të gjithë është...

Llambi çakarriti sytë.

— Fatimja?

— Përse çuditesh?, — kooperativistët flisnin seriozisht. — Edhe gratë janë të afta të drejtojnë. Madje, të na drejtojnë shumë më mirë se ti.

Llambi heshti. Kishte kërkuar të veçantën dhe ja ku gjeti të përgjithshmen. Këtë po e ndiente në gjithë qenien e tij.

TE FALA NGA DJALI

Në fshat e morën vesh të gjithë.

Kamberi i Bushajve është sëmurë nga verdhëza. Dhanë e morën plakat, nuk i bënë dot derman. I dhanë hidhës të zier, lëvozhgë shege të ziera me verë të bardhë, more gjer edhe lëng fhanash i dhanë, po jo që jo. Së fundi, panë ç'panë, e çuan në spital. Tani çuni është atje.

Vërtet kështu kishte ndodhur dhe gojët e mëhallës, ashtu siç e kërkonte forca e zakonit, nuk linin legjendë pa thurur.

Kamberi i Bushajve na qe sëmurur nga verdhëza, qe shtruar në spital dhe fill pas kësaj ngjarje, në drejtorinë e shërbimit shëndetësor kishin thirrur Kristaqin, përgjegjësin që merret me spërkatjet dhe dezinfektimet e ndryshme.

Nejse. Kjo vjen më pas. E para e punës është se Kristaqin e thirri vetë drejtori i drejtorisë së shërbimit shëndetësor dhe e porositi:

— Dëgjo këtu, Kristaq. Do të shkosh një orë e më parë në Martin, te Bushajt dhe do t'i spërkasësh të gjitha dhomat e shtëpisë, me laçkë e me plaçkë. Dezinfektim i përgjithshëm, e kuption? Është rast Botkini.

- Si urdhëron!
— Haja, udhë e mbarë. Ja edhe dokumentet.



J. M.
B.M.

Kristaqi mori dokumentin që i dhanë, i hondhi shpejt e shpejt një sy, kapi në fokus shifrën e tetëmbëdhjetë dhe vetëtimthi mendoi:

«Domethënë i sëmuri qenka tetëmbëdhjetë vjeç. I shkreti. Do hajë ca thumba atje në spital, po qar e ka.»

Dhe si e palosi shkresën, e vuri në xhep të, jekut e u ngrit.

— Zëre sikur erdha, — iu përgjigj eprorit të vet dhe doli nga dera.

Pas ca orësh u gjend në Martin, te Bushajt, duke dezinfektuar. Pasi mbaroi punë, i pari i shtëpisë e ftoi të ulej. Kjo, për Kristaqin, që i maste njerëzit me ç'i jepnin, qe një shenjë e mirë, që donte të thoshte kështu:

«Do të ma shtrojnë me të ngrënë e me të pirë, prandaj mos e kurse mullën, zgjidhe rripin dhe shqepu mirë e mirë. Dëndu gjer në gurmaz.»

Siq e nuhaste Kristaqi, këtu ishte rasti për qelepir dhe, siq thoshte vetë, qelepir edhe një takije me kripë po të mbushën, hidhja barkut, se nuk humbet gjë.

Dhe Kristaqi u sheshua mirë e bukur e, për t'i dhënë sa më shumë rëndësi vetes, e nisi bisedën i pari, ashtu siq ia donte mendja dhe mullëza, duke u shtirë se ishte njeri që dinte më shumë nga c'mendonin të tjerët dhe se «kishte gjë në dorë».

— U lodha vërtet, po mbarova shpejt, ama.

— Të lumshin duart, — ia pati i zoti i shtëpisë, — ditë të bardha paçim!

Kristaqit iu duk se i doli lepuri në shteg tamam nga ky urim.

— Fjalë me vend the! Ku, ore, ku, çfarë ditësh kemi arritur. Një spital i tërë u ngrit në këmbë për të shëruar një fshatar, që këtu e tridhjetë vjet të shkuar nuk e pyeste njeri, pa le ta bënte për tungjatjeta, — tha.

— Ashtu vërtet, ashtu, — pohonte plaku.

— I mora vesh të gjitha, — e ngau fjalën

Kristaqi, — Isha dje në spital. U takova edhe me Kamberin.

— U, t'u bëfsha! Mirë ishte?, — plaka u gjallërua, u çel në ftyrë.

— E pe ti?, — pyeti plaku. — Mirë ishte?

— Si pëllumb. — Kristaqi fliste serbes dhe kishte marrë të përpjetën. — U fjalosa me të një orë të tërë. U kënaqëm të dy.

Pleqtë u panë sy ndër sy.

— Me kë u fjalose?, — pyeti plaka.

— Si me kë? — Kristaqi hodhi njëren këmbë mbi tjetrën. — Me Kamberin. E me kë tjetër?

— Ashtu?

— Ehë. — Kristaqi nuk përmbahej më. — E pse të mos ishte i kënaqur? Doktorët te koka i rrinin. Kur bëra të ngrihesha e i thashë se do të vija këtu, më tha t'ju bëja të fala dhe t'ju thosha se me shëndet është fare mirë. Është, si i themi ne andej nga anët tonë, si kokrra e qiqrës.

— Aman ore, mos u tall!, — plaku i shtëpisë tanë kafshonte cepin e mustaqeve, ngaqë nuk e mbante dot të qeshurën.

— Më placin sytë, të gjitha të sakta i kam, — përgjërohej i entuziazmuar Kristaqi. Hej Kamber, hej. Është djalë e deli djalë ai.

Njëra nga gratë, që sapo kishte ardhur nga puna e ishte ulur pranë burrave, e pyeti:

— I kishte ardhur goja mirë, thua zotrote?

— Bilbil moj, e di kujt i thonë bilbil? Brisk fare po të them.

— E di, të keqen, e di. Bën çudira shkenca. Tetëmbëdhjetë muajsh djali dhe të qaka hallin e kuvendoka si ndonjë i madh!

— Si? — Kristaqi rrotulloi sytë dhe vetëtim-

thi çoi dorën në xhep të jelekut, nxori që andej vërtetimin, i hodhi një sy dhe vetëm tani pa se në vend të tetëmbëdhjetë vjetëve, siç kishte kujtuar, aty shënohej tetëmbëdhjetë muajsh. Iu duk se i ra tavani mbi kokë, por u përmbajt dhe, si për të gjetur një shteg, tha:

— Gjëra që ndodhin xhanëm, gjëra që ndodhin. Ka edhe keqkuptime.

Plaku i Bushajve iu kthye plakës:

— Këto janë çudirat e kësaj bote, plakë. Na stradin efendiu në kohë të tij e bëri patën e pjetur të fluturonte nga furra, kurse ky shoku na e rriti djalin nga tetëmbëdhjetë muajsh në tetëmbëdhjetë vjeç. Na u bë çuni përnuse, plakë. Të paçim të gëzuar, o Kristaq.

Po Kristaqi nuk e dëgjonte më. Ai qe ngritur, kishte mbathur këpucët dhe kishte kapërcyer pragun e shtëpisë.

MIKU I MITIT!

Kiçoja ngjiti ngadalë shkallët e Universitetit, hyri në korridorin e ngushtë të katit të tretë dhe u drejtua te një derë ku pesë a gjashtë studentë ishin grumbulluar kokë më kokë e flisnin me zë të ulët. Koka i qe rënduar nga mendimet. Cili pedagog vallë do ta merrte sot në provim? Ja, kështu është kur nuk ia gjen anën tjetrit. Vjen e gjendesh gafil. Ndryshe është kur e di se me kë ke të bësh. Një fjalë, një shok, një mik, një tutje-tëhu, gjithnjë më tjetër është, di dhe kulla-ndrisesh, ndërsa kështu, urdhëro e përplase kokën! As që i shkon mendja njeriu për ty dhe as që e ha meraku ndonjërin.

Dikush, nga ata që rrinin pranë derës, me ta parë, i ra me bërryl shokut të vet e i foli buzëgaz:

- Po vjen Kiçua, pellazgu.
- Tjetri ia ktheu aty për aty.
- Me siguri, për të dhënë provim ka ardhur.
- Ndërkohë, Kiçoja, u qe afruar pranë.
- E, o djema, — u foli, — gjeografia këtu jepet?

- Këtu.
- Cili pedagog?
- Visar Nuçi.
- Visar Nuçi? Ehë!

Kiçoja mblodhi buzët, bëri dy çape më tej dhe u mbështet në parvaz të drifates. Hodhi vështrimin tej kodrave, ku akaciet ishin veshur gjithë gjelbërim e lule. Mendimet nisën t'i vërtiteshin si re të zymta. «Si tha ai, si tha? Visar Nuçi? E dija unë. Patjetër ndonjë nursëz do të jetë ky Visar Nuçi. Po, po, i tillë është. Kam dëgjuar një thes me fjalë për të. Ta bën tetë me dy ai. Hëm. Ku dreqin u gjend ky sot?? Një tjeter do të qe njëqind herë më i mirë. Le të vinte, fjala vjen, Lekua. Ai po, është burrë për të qenë, po vajti e u nis me shërbim, dhe kur? sot. Sot që unë kam ditën e provimit. Kësaj i thonë e gjeç nga mos e pandehsh. Si tha ai, si tha? Visar Nuçi? Ah, po, po... Visar Nuçi... Ç'e do. Kur nuk ia gjen dot mikun, ç'vlerë ka? Hëm. Visar Nuçi, ë? Dëgjove, or Visar Nuçi! Dëgjova thuaj... Kur nuk ta gjej dot mikun, ç'vlerë kanë të tjerat? Visar Nuçi, ë? Me kë të ketë të bëjë vallë ky Visar Nuçi, ë? Dhe Kiçoja filloj të shtrydhë mendjen e të gjente Nuçërit nga ishin e nga s'ishin, po ke parë kështu ti? Asnjë i njojur me mbiemrin Nuçi nuk i fanepsej. Po hë, or de, s'ka thënë kot ai qëmoti: Kur do, do. Kur s'do, s'do. Përse nuk gjendet një Nuç tanë, një Nuç për në këtë ditë të keqe, si ditët me shi e rrebesch? Miku i mirë për në ditë të vështirë, thonë, po hë, or de, ku ma ke këtë mik të mirë të më zgjidhë litarin që më shtrëngon fytin? Mikun për sot ta dua e jo për ndonjë ditë tjeter.

Befas sytë i lëshuan shkëndija gëzimi. «Si tha ai, si tha? Visar Nuçi? Po fol, more të shkretën, fol, se më ngrive gjakun e më le udhës si deng pa markë. Visar Nuçi. Miti Nuçi. Miti, ore, Miti që është në ndërmarrjen X... në qytetin tonë. Po hë, or t'u mbylltë, se e mbylle për pak gjithë iktiballin tënd. Ja ku u gjend edhe miku, më falni, shoku desha të thosha, se, ç'bëri ashtu e ç'bëri kështu, njëlloj është. Opo e tha mirë ai njëherë e një kohë: Mend dua sa të lidh ushkurët e potureve që të mos më bien rrugëve, pa të tjerat le të jenë fat, se për fat kam nevojë.» E di ti? Po të punojë fati, s'është nevoja të punojë as koka dhe as mendja. Ja, fap Nuçi erdhi e doli atëherë kur s'ma priste mendja. Tani di unë si ta sjell patën, që mishi të piqet dhe helli të mos digjet. Si tha ai, si tha? Visar Nuçi, ë? Tamam, ashtu tha. Dhe Miti Nuçi ynë, është patjetër i vëllai i Visarit. Pa dale, si thashë unë? i vëllai? Jo, s'ma ha mendja të jetë i vëllai, se Miti s'më ka folur kurrë për një vëlla të tillë. Po. E gjeta. Është djali i xhaxhait. Tamam. Para një muaji ai më tha shprehimisht: Kiço. Kur të shkosh në Tiranë, më njofto, të të jap një plaçkë përdjalin e xhaxhait, se do fejohet këto ditë. Y, më të lumtë, o Miti, që m'u kujtovë tani! Y, më të lumtë, o Visar, që po na fejohesh! Të hëngërshim dasmën e të na trashëgohesh ore, se është bela e madhe kjo puna e fejesës. E zgjedh tjetrën e s'di se çfarë të pjell në kusi. Po, nejse. Kjo është punë përtty. Ne të tjerët vetëm gëzimin kemi. Kusuret e tjera i heq ti vetë dhe le t'i heqësh me shëndet, se fundja vetë e zgjodhe e nuk ta dha njeri me zor. Po... këto nuk janë punët e mia. Unë e kam

hallin te provimi. Hë më të lumtë, o Miti, më të lumtë! Kësaj i thonë të gjetur. Pra, janë sak çuna xhaxhallarësh. Fort bukur. T'i kemi që të dy me shëndet. T'i kemi me nder fare. Ama është kushëri i Mitit ai? Aq qe puna. Provimin e kam në xhep. Ohu, kur ta marrë vesh ai se unë jam shoku i ngushtë i Mitit, do ta vërë shpejt e shpejt një notë të mirë dhe unë e kapërcej pragun pa u lagur fare. Kaq duhej. Të tjerat vijnë vetë. O burra Kiço. Përpara!

Dhe ai u drejtua te dera me hap të rëndë. Studentët që ishin aty, i bënë udhë.

— Do hyni?, — e pyeti njëri.

— S'kam q'të pres më tej. Për të dhënë e kam. Më mirë një orë e më parë se jam përrugë.

Kapërceu pragun. Pedagogu Visar Nuçi e priti buzëgaz. Kjo ishte shenjë e mirë. Ndofta këtu vepron televizion. Mundet që edhe atij t'i kishte ardhur ndër mend se pikërisht ky që hyri tanë ishte shoku, e kaluar shokut, i djalit të xhaxhait të tij, Mitit.

Pedagogu vazhdonte buzëqeshjen e tij. Edhe Kiçoja bëri të njëjtën gjë. Kjo e ngrohu mjaft atmosferën. Hodhi edhe dy hapa, i sigurtë tashmë në vetvete se e hodhi lumin, dhe u gjend përrapa katedrës.

— Urdhëroni, — foli pedagogu, — urdhëroni...

Kiçoja nuk dinte nga t'ia niste bisedën, që kishte bluar ndër mend. Instinktivisht zgjati dorën dhe mori biletën.

— Numrin?, — pyeti sérishmi pedagogu.

— 13, — u përgjigj Kiçoja dhe atë çast i shkuar të rrëqethura në trup. Nga u gjend një

numër i tillë? 13! Ptu! Ta marrë dreqi, ta marrë! Si nuk u gjend një numër tjetër, po ky tersi u faneps? Këtu nuk është fjala pér supersticion, po le të binte një numër tjetër se nuk bëhej kiameti!

Sidoqoftë, nuk e humbi toruan. «Hajde, jepi Kiço, — i dha kurajë vetes, — tanë tregoje veten. Numri bëri të tijën dhe ti bëj tënden. Të shohim kush do të dalë më i fortë». Dhe u ul pér t'u preqatitur e pér të pritur radhën.

Pas një ore, ndodhej përballë pedagogut. Tanë ishte pikërisht çasti pér të treguar gjithë aftësinë e tij, gjithë elokuencën e tij.

— Profesor..., — filloi të belbëzonte. — Keni... Keni shumë të fala nga Miti.

Pedagogu e vështroi drejt e në bebe të syrit.

— Nga Miti?

— Si urdhëron. Kur u nisa, më tha t'ju bëja të fala. Do të më jepte edhe një plaçkë, atë që e keni porositur ju, pér fejesën... E ka marrë mali... E ka marrë shumë... — Kiços fillo t'i zgjidhej gjuha. — Më tha, që t'ju them se po ju pret, ju presin të gjithë, ashtu, familjarisht desha të thosha, të vini edhe ju ashtu, familjarisht, me të fejuarën e kishte fjalën...

— Ashtu?, — pedagogu vazhdonte të tregohet shumë dashamirës me të me atë buzëqeshjen e tij të gjiltër.

— Pikërisht kështu. Atij i ka mbetur hatri që nuk keni ardhur. Edhe neve të tjerëve gjithashtu na ka mbetur hatri. Eh, sa bukur është tanë në qytetin tonë. Mbrëmjet... Bar-bufetë... Birra me shishqebap... Me Mitin vetëm nata na ndan.

Pedagogu e kapërceu masën e mirësjelljes që kishte përfytyruar Kiçoja.

— Po si éshtë Miti, — pyeti, — si éshtë me shëndet, ç'bën ai, si ia shpie me punë?

— Si veshka në mes të dhjamit éshtë, — e svaroi Kiçoja. — Mbase ju ka njoftuar edhe vetë. Pardje dha fjalën për të fejuar çupën.

— Jo, nuk e kam marrë vesh. Të trashëgohet.

— Faleminderit. Djali éshtë pér kokë të djalit. Agronom. Jemi njerëz punëtorë ne andej, shoku profesor. Fshatin e duam njëlloj si qytetin.

— Duket.

— Edhe në punë birinxhi ia çon. Pardje i dhanë një fletë lavdërimi përpara kolektivit. U gëzuam të gjithë.

— Sa mirë!

— Nuk e turpëron sojin e tij Miti, jo!

— Duket!

— Edhe ju, keni të drejtë të krenoheni me të. Pedagogu mezi e mbante të qeshurën.

— Ju falem nderit pér komplimentin, — i tha e, duke dashur të hynte në temën e provimit, pyeti:

— Epo... si dukeni, shoku Kiço?

Kiçoja tundi kokën lehtë-lehtë.

— Ja... siç e shihni...

— Ah, po po... E shoh, — pedagogu vazhdoi:

— Mund të fillojmë?

Kiçoja ngriti supet.

— Aha, si të doni. Mund edhe të fillojmë, por unë...

— Po ju dëgjoj.

Pedagogu kryqëzoi duart. Kiçoja nga ana e tij lidhi gishterintë e duarve dhe filloj t'i rrrotullonte së mbarthi dy gishterintë e mëdhenj. Pastaj

tha ca fjalë mbytur, kodra pas bregut. Pedagogu e vështronte. Befas ai e pyeti:

— Shoku Kiço. Vetëm kështu dini t'i rrrotulloni gishterinjtë apo edhe ndryshe?

— Jo, — u përgjigj Kiçoja. — Miti më ka mësuar t'i rrrotulloj edhe nga e kundërtat.

— Cili?

— Miti pra, Miti juaj.

— Ah, po. — Pedagogu e mblodhi veten. — E harrova fare. I di Miti të gjitha këto?

— I di, si nuk i di! Unë dhe ai jemi një.

Pedagogu nuk e zgjati më tej.

— Më jepni librezën, — i tha, — e qartë.

Kiçoja i dha librezën. Pedagogu shkroi aty «diçka», e mbylli atë, u ngrit e ia dha tërë dashamirësi.

— Urdhëroni i dashur, urdhëroni dhe, kur të arrini në shtëpi, i bëni Mitit shumë të fala nga unë, të fala nga të gjithë ne. Edhe ne na ka marrë malli për të. Kur të vijë në Tiranë, le të kthehet këtej. Çupa le t'i trashëgohet. Hajde, mirë u pafshim.

— Mirë u pafshim.

Kiçoja mori fletën ku kishte mbajtur dy-tri shënime, mori edhe librat, doli jashtë, rrëshqiti nëpër korridor, fluturoi nëpër shkallë dhe, kur u gjend në sheshin para Universitetit, i shkoi mendja te libreza. «Burrë i mirë qerratai, për sytë e ballit, goxha burrë ishte! Gjallë Miti. Ja, këta janë burra. Me ta marrë vesh se ke të bësh me tjetrin, se je shok i tij dhe fap, ta vë një notë kaluese. Pa dale, pa dale..., — dhe Kiçoja nuk po u besonte syve të vet. — More ç'ka shkruar ky këtu? Kalueshëm apo pakalueshëm?» — Ndaloj një stu-

dent që kalonte aty pranë duke fërshëllyer. — Djalë, pa lexoje pak këtë të shkruarën këtu. Pakalue-shëm është shkruar, apo më bëjnë sytë?

Tjetri e pa.

— Pakalueshëm, — i tha.

— Ptu! Sojsëzi! Zbardhete edhe dhëmbët, pale! Uroi edhe pér çupën, pale! Tyt more, edepsëz! U hoq si të më donte të mirën dhe nga ana tjetër më vuri hurin. Yh, vulëhumburi i dreqit!

Befas, tërë millefin ia pérplasi Mitit.

— Dëgjove, o Miti Nuçi? Dëgjova thuaj. Të humbtë vula me gjithë kushëri që më ke. Nga vajti dhe m'u faneps në mendje. Po le të më ishte kujtar ndonjë tjetër, ndofta do të qe edhe më mirë. Nga shkaku yt më ra edhe ajo tezë, me atë të flamosur numër trembëdhjetë.

Kështu, ec e fol me vete, arriti në stacionin e trenit, preu biletën e i hipi vagonit. Kur sosi në qytet, e mbajti frymën drejt e në shtëpi të Mitit, i cili sapo ishte ngritur nga gjumi i vapës dhe po lante sytë.

— Ku je, ore, — i thirri që jashtë. — Dil, më të dalshin trutë, dil, se ma bërë gjëmën, ma bëre të pabërën!...

Miti u dha në derë.

— Ç'është, o Kiço?

— Ç'të jetë, o, që mos qofsh! Ai kushërimi yt, ai Visar qeni de, këtej ma kreku mirë e mire bishtin dhe këtej më vuri drunë. Ja, ma ka shkruar në librezë: Pakalueshëm.

Miti çakarriti sytë.

— Nuk të kuptoj. Cili është ky Visar? Kiçojë mezi përmbahej.

— Mos u hiq ashtu, se nuk të ka hije! Vajta të jepja provimin e gjeografisë dhe ai ma dha pas koke...

— Po ç'lidhje kam unë me provimin e gjeografisë dhe me këtë Visar që më thua ti?

— Ke, si nuk ke. Pedagog qe ai, Visar Nuçi, kushërirri yt, djali i xhaxhait tënd, de.

Mitiçoç filloj të kuptonte.

— Pastaj?

— Pastaj më rreku me një mijë fjalë të mira. «Bëji të fala Mitit», — më tha, dhe më dha librezën. Tani ja ku më ke, me një «pakalueshëm» në librezë dhe me të falat e tij. Të rrofshin!

— Të falat e kujt?

— Të atij de, se më plase, të atij kushëritit tënd, atij Visarit.

Miti qeshi me të madhe. I hodhi Kiços dorën në qafë dhe e tërroqi drejt dhomës.

— Po ç'thua kështu, more Kiço vëllai! Po unë atë njeri nuk e njoh fare, more vëlla, nuk e njoh fare! Me sa më kanë thënë, ai është nga qyteti N. dhe unë jam nga bregu i detit. Afér jemi, é?

Kiçojë mbeti si i shtangur.

— Si, si? Pa thuaje edhe një herë!

— Unë, de, unë nuk e njoh fare atë njeri...

Kiçojë u përplas në divan dhe nuk po dëgjonte asgjë.

PASQYRA E LËNDES

I

	Faqe
Vagabondët e qytetit	3
Xhambazët	9
Defteri magjik	14
E di prefekti	20
«Patriotizmi» i kryetarit të bashkisë	25
Pritja	35

II

Kapllan .bej trimi	43
Kapteri, zevendësi dhe xhandar Xhaferi	50
Shpërndarësi i komunikatave	59
«Trimat» e Duçes dhe atentatorët	64
Pusi dhe çitjanet e hanëmit	72
«I vrari u zu, guximtari iku»	78
Milicët vrap e gomari vrap	87
Tribuna dhe miza e kalit	93

III

Kur bëjnë dasmë arinjtë	99
Në mbledhjen e një komisioni	107
Ju rrofshin stallat moderne!	113
Për derrat, the?	117
Kur pleqëron sheï i fizkulturës	122
Kur këmba i bie kokës	126
Këtu jam zot unë...!	128
Të pabesat	131
Suloja marton vëllanë	135
«Rregullorja»	139
Të fala nga djali	146
Miku i Mitit	151